

BISMIL'LAHI'R-RAHMANI'R-RAHIM

RREGULLAT E JETËS MARTESORE

Imam Gazali

Prishtinë 2015

Ihjau Ulumid-din
Ringjallja e diturive fetare
Imam Gazali

Titulli i origjinalit
Kitâbu âdâbi'n-nikâh
Libri 12

Përgatiti dhe përktheu
Is-hak Shala dhe Abdullah B. Ferizi

Me emrin e Allahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit.

PARATHËNIE

Falënderimi (hamd) i takon vetëm Allahut. Shtizat e imagjinatës nuk mund të gjejnë mangësi në veprat e Tij të mrekullueshme. Karshi veprave të Tij mendjet ndalen; detyrohen të tërhiqen në habitje dhe hutim. Nimetet, bamirësia dhe dhuratat e Tij mbërrijnë njëra pas tjetrës për të gjitha botët, deshëm apo s'deshëm.

Është Allahu Ai që, duke krijuar njerëzit nga sperma, krijoi mes tyre afërsi dhe farefisni, me krijimin e ndjenjës së epshit i detyroi në martesë për jetësimin e breznive, pastaj mes tyre i dha rëndësi farefisnisë, dhe për këtë e bëri zinënë haram. Lëshimin në zinë e cilësoi si krim të turpshëm dhe si veprim të pamend. Në anën tjetër, lejoi martesën dhe inkurajoi në të, si një akt i lejueshëm dhe i lavdërueshëm.

Ai derdhi mbi njerëzit një det të tërë të përcaktimit hyjnor në formë të dobisë dhe dëmit, të mirës dhe të keqes, lehtësimit dhe vështirësisë, si paralajmërim. Ai përcakton vdekjen për t'ia rrënuar njeriut madhështinë dhe për t'ia thyer fuqinë, e më pas me derdhjen e farës së spermës në arën e mitrës krijon brezat e ri, për të mbushur boshllëkun që sjell vdekja. Allah Teala është pa të meta.

Salavate të panumërta e të pafund dhe selame të shumta qofshin mbi Muhammedin s.a.v.s., që u dërgua të paralajmërojë dhe të na gëzojë, familjes dhe as'habëve të tij.

Ta dish se kurorëzimi është ndihmesë për të ruajtur fenë. Pra, jeta martesore është mbështetje besimit (iman), poshtërim i shejtanit, kala e fortë kundër armiqve të Allahut dhe shkaktar i numrit me të cilin do të krenohet Resulallahu s.a.v.s., karshi pejgamberëve të tjerë. Prandaj është jashtëzakonisht e nevojshme të shqyrtohen arsyet për të, t'i mësohen sunnetet dhe rregullat e sjelljes në përputhje me sunnetin, t'i sqarohen qëllimet dhe nevojat, dhe të zbërthehen çështjet në të, si ato të rëndësishmet ashtu edhe ato marginale. Rregullat më të rëndësishme për jetën martesore do të prezantohen në tre kapituj:

- 1) Mbi inkurajimin në martesë dhe largimin nga ajo;
- 2) Mbi rregullat e marrëveshjes për martesë, palët në të dhe kushtet e martesës; dhe
- 3) Mbi rregullat e përshtatjes ndaj sunnetit mes burrit dhe gruas, kushtet për vazhdimin e kurorës dhe detyrat që iu takojnë.

Kapitulli i Parë

MBI INKURAJIMIN NË MARTESE DHE LARGIMIN NGA AJO

Ta dish se dijetarët janë në mosmarrëveshje lidhur me vlerat e larta (fazilet) të martesës. Disa martesën e kanë madhëruar së tepërmi, duke e konsideruar si më të rëndësishëm se përkushtimi në ibadete ndaj Allahut Teala. Të tjerët ia pranojnë vlerat e larta, por përderisa epshi nuk detyron në marrëdhënie, i japin përparësi përkushtimit në ibadete. Disa mendojnë se në kohët tona është më mirë të evitohet martesë, ani pse më herët ajo kishte vlerën e vet, kur fitimet ishin hallall, dhe morali i femrës në nivel. Të vërtetën do ta zbulojmë vetëm nëse së pari paraqesim transmetimet të cilat flasin për inkurajimin dhe largimin nga martesë, e më pas të shpjegojmë përfitimet dhe mangësitë e saj, me çka do të kuptohet vlera e martesës, por edhe vlerat e largimit nga ajo, për ata që kanë këto shqetësime.

INKURAJIMI NË MARTESE

Për këtë flasin ajetet Kur'anore në vazhdim. Përmes urdhrit:

“I martoni të pamartuarit dhe të pamartuarat ndër ju..”24-Nur: 32

dhe përmes ndalesës së pengimit të martesës:

“...mos i pengoni ato që të martohen përsëri me burrat e tyre...”2-Bekare: 232

Duke i lavdëruar Pejgamberët dhe martesat e tyre, Allah Teala ka treguar:

“Edhe para teje Ne kemi sjellë të dërguar, të cilëve u kemi dhënë gra dhe pasardhës..”.13-Rad: 38

Allah Teala i lavdëron miqtë e Tij që dëshirojnë të martohen:

“Edha ata që thonë: ‘O Rabbi ynë, na bën që të jemi të gëzuar me (punën) e grave tona dhe pasardhësve tonë.” 25-Furkanë: 74

Thuhet se Allah Teala në Kur’ani Kerim ka përmendur vetëm pejgamberët e Tij të martuar, dhe që edhe Jahja a.s., ka qenë i martuar, por nuk ka pasur marrëdhënie. Disa thonë që ai është martuar për t’iu përshtatur sunnetit dhe për të ndaluar shikimet nga femrat e huaja. Edhe Isa a.s., do të martohet kur të zbres në Tokë, dhe do të ketë fëmijë.

Për martesë flasin edhe hadithet në vijim:

“Lidhja martesore është sunneti im, e kush largohet nga sunneti im është larguar nga unë.”¹

“Martohuni dhe shumohuni, sepse në Ditën e Gjykimit do të krenohem me ju, bile edhe me fëmijët tuaj të vdekur para lindjes, mbi bashkësitë tjera.”²

¹ Ebu Ja’la në veprën e tij ‘**Mesnud**’, nga Ibn Abbasi r.a. me zinxhir të mirë të transmetuesve.

² Ebu Bekr ibn Merdevejh në Tefsirin e tij, në transmetim të Ibn Omerit r.a., pa fjalët: *...bile edhe me fëmijën e paralindur*. Me këtë shtesë e përmend Bejheki në ‘**Marifet**’.

“Kush largohet nga sunneti im nuk është i imi, e martesë është sunnet i imi, prandaj kush më do le t’i përshtatet sunnetit tim.”³

“Kush nuk martohet për shkak të frikës nga skamja, nuk është i joni!”⁴

Ky hadith e qorton arsyen që paraqitet për mos-martesë, e jo vet mos-martesën.

“Kush i plotëson kushtet, le të martohet.”⁵

“Ai nga ju që është i aftë për martesë, le të martohet, sepse kjo është më e mirë për ndalimin e shikimeve dhe ruajtjen e organit gjenital, e ai që nuk është në gjendje për martesë, le të agjërojë, sepse agjërimi ka një veçori që e thyen epshin.”⁶

Ky hadith e inkurajon martesën, për të parandaluar veten dhe syrin nga harami. Kjo tregon se arsyeja për inkurajim të martesës është frika nga keqpërdorimi i syrit dhe organit gjenital.

Resulallahu s.a.v.s., thotë:

“Kur t’ju vijë dikush me fe, e në të cilën keni besim, martohuni me të. E nëse nuk e bëni këtë, në Tokë do të mbretërojë intriga dhe një kaos i madh.”⁷

³ Pjesën e parë e transmeton Buhari dhe Muslim nga Enesi r.a., e vazhdimi është përmendet në hadithet e mëhershme.

⁴ Transmeton Ibn Maxhe, nga Ajsha r.a..

⁵ Transmeton Ibn Maxhe, nga Ajsha r.a., me zinxhir të dobët të transmetuesve.

⁶ Buhariu dhe Muslimi nga Ibn Mesud r.a..

⁷ Transmeton Tirmidhiu nga Ebu Hurejre r.a..

Edhe kjo është gjithashtu arsye për inkurajimin e martesës; frika që në Tokë mund të shfaqet kaos.

“Kush martohet ose marton tjetrin për hir të Allahut, e fiton miqësinë e Tij.”⁸

“Kush martohet ka ruajtur gjysmën e fesë së vet, e për gjysmën tjetër le t’i përshtatet urdhrave të Allahut!”⁹

Ky hadith tregon vlerën e martesës për ruajtje nga shkatërrimi, sepse në të shumtën e rasteve fenë e njeriut e prishin organi i tij gjenital dhe barku. Me martesë, ai e ruan një anë të fesë.

Resulallahu s.a.v.s., thotë:

“Njeriut i ndërpriten të gjitha veprat (me vdekje), përveç tri gjëra (nuk shkëputen, e njëra prej tyre) prej fëmijës së mirë që i dërgon dua.”¹⁰

Deri te fëmija i mirë arrihet vetëm përmes martesës. Omeri r.a., është martuar disa herë, duke thënë:

- Martohem vetëm për shkak të fëmijëve.

⁸ Transmeton Ahmedi nga Muadh b. Enes r.a..

⁹ Ibn el-Xhevzi, në ‘El-ilel’ nga Enesi r.a., dhe Taberani në ‘Evsat’ me tjetër formulim.

¹⁰ Ngjashëm këtij hadithi transmeton Muslimi nga Ebu Hurejre r.a..

Fjalët e të mëdhenjve të islamit në këtë çështje:

Ibn Abbasi r.a., ka thënë:

“Ibadeti i personit gjen përkryerje vetëm me martesë.”

Duke pranuar martesën si ibadet dhe plotësim të ibadetit, Ibn Abbasi r.a., qëllim të vërtetë ka të shpreh se ibadeti bëhet i vlefshëm me qetësinë e zemrës, e kur vlon epshi - qetësia e zemrës është e mundur vetëm me martesë. Për këtë arsye, kur sklleverit e tij lkrime, Geriba dhe të tjerë u bënë të moshës madhore, Ibn Abbasi r.a., i mbledhi dhe ju tha:

“Nëse doni të martoheni, do t’ju martoj, sepse kur njeriu bën ziná, imani i del nga zemra.”

Ibn Mesudi r.a., ka thënë:

“Sikur edhe të më mbesnin vetëm dhjetë ditë jetë, do të kisha dashur të martohesha, që të mos dal beqar në prani të Allahut Teala.”

Muadh ibn Xhebelit r.a., i kanë vdekur dy gra nga murtaja, nga e cila edhe vet ishte sëmurë, por megjithatë i sëmurë thoshte:

“Më martoni, sepse unë nuk dua të vdes beqar.”

Këto thënie të tyre tregojnë që në martesë ata kanë parë fazilet, jo vetëm për ruajtje nga rreziket e epshit.

Omeri r.a., ka thënë:

"Vetëm dobësia dhe devijimi nga rruga e drejtë e pengojnë njeriun të martohet."

Me këto fjalë, Omeri cekë se feja nuk e pengon martesën, por e pengojnë këto dy veti.

Njëri nga as'habët iu përkushtua shërbimit të Resulallahut s.a.v.s., dhe gjithmonë gjendej pranë tij, në rast se Resulit i nevojitej diçka papritur. Resulallahu s.a.v.s., e pyet:

-Pse nuk martohesh? Martohu.

- *Jam i varfër, nuk kam asgjë, dhe do të ndalja shërbimin ty, thotë as'habi.*

Resulallahu s.a.v.s., hesht, e pas një kohe përsëri e pyet dhe ai përgjigjet njëjtë, e më pas, duke u menduar, thotë me vete: *"Vallahi, ka një urtësi në përsëritjen e Resulallahut s.a.v.s.. Ai e di më mirë çka është më e dobishme për mua në këtë botë dhe në ahiret, dhe çka do të më afrojë Allahut Teala. Nëse më pyet edhe herën e tretë, do të martohem."*

Resulallahu s.a.v.s., e pyet edhe herën e tretë, duke i thënë prapë:

-Pse nuk martohesh?! Martohu."

- *O Resulallah, më marto!", iu përgjigj as'habi.*

Atëherë Resulallahu s.a.v.s., i thotë:

- **Shko te filan familja dhe thuaju që i Dërguari i Allahut ka urdhëruar që të të martojnë me ndonjërien nga vajzat e tyre.** As'habi i thotë:

- *Por, unë nuk kam asgjë!* Resulallahu s.a.v.s., u tha as'habëve të tij:

- Mblidhni dukat për vëllanë tuaj, sa pesha e disa farave të hurmës.”

I mblodhën, e dërguan deri te familja e përmendur, dhe e martuan. Resulallahu i tha: **“Përgatit gosti!”**

E as’habët i sollën një dele dhe përgatitën gostinë.¹¹

Siç mund të bëhet ky insistim i Resulallahut s.a.v.s. dëshmi për vlerën e martesës, është edhe e mundur që te as’habi të ketë ekzistuar nevojë e theksuar për jetë martesore.

Tregohet se një i devotshëm në njërën nga popujt e kaluar, ua kishte kaluar me ibadete të gjithë bashkëkohësve të tij, kështu që Pejgamberit të asaj kohe i tregohet bukuria e ibadeteve të tij, në çka Pejgamberi thotë:

- *Sa njeri i mrekullueshëm do të ishte ai sikur të mos kish braktisur sunnetin.* Besimtari u brengos kur dëgjoi këtë, shkoi te Pejgamberi dhe e pyeti:

- *Cilin sunnet e braktisa?*

- *Sunnetin e martesës,* i tha Pejgamberi.

- *Unë jam i varfër, dhe jetoj nga ndihma e njerëzve. Për këtë arsye nuk po martohem.* Pejgamberi i tha:

- *Do të martoj me vajzën time,* dhe këtë edhe e bëri.

¹¹ Transmeton Ahmed, nga personazhi i këtij rasti, Rebi’e el-Eslemi, në një hadith më të gjatë, me zinxhir të mirë të transmetuesve.

Bishr ibn Haris thoshte: *“Ahmed ibn Hanbel është më i mirë se unë në tri drejtime:*

-Ai kërkon furnizim hallall për vete dhe për familjen, e unë vetëm për vete;

-Ai u martua e unë mbeta beqar;

-Ai është caktuar si imam për njerëzit. E unë jo.

Thonë që Ahmed b. Hanbeli Allahu e mëshiroftë, është martuar ditën e dytë pasi ka vdekur nëna e djalit të tij Abdullahut, duke thënë që nuk i vjen mirë të kalojë natën i pamartuar.

Kur njerëzit i thanë Bishrit që po flitet për mos-martesën e tij, dhe që po e gjykojnë se po e lë anash sunnetin, ai u tha:

-U thoni atyre se ai, për shkak që është i zënë me kryerjen e farzit, këtë sunnet nuk ka mundur ta realizojë.

Kur u pyet me një rast tjetër:

-Pse nuk po martohesh?, Bishr dha këtë përgjigje:

-Nga martesë më ndalon ky ajet:

“Gratë kanë aq të drejta sa kanë edhe detyra...”

2-Bekare: 228

Kjo iu përmend Ahmedit, e ai tha:

-Pak ka të tillë si Bishri!

Transmetohet se dikush e ka parë Bishrin në ëndërr dhe e ka pyetur:

-Çfarë trajtimi të ka bërë Allahu ty? Bishri tha:

-Po, pozita ime në xhennet është e lartë, por nuk i kam arritur nivelet e të martuarve.

Në një transmetim tjetër thuhet:

-Më tha Rabbi im: 'Nuk kisha dëshiruar të më vish beqar. E pyetëm:

-E, çfarë ka ndodhë me Ebu Nasr et-Temar?

Është shtatëdhjetë gradë më lartë se unë.' E pyetëm:

-Si u bë kjo? Kemi menduar se ti je përmbi të.

Bishri tha:

-Për shkak të durimit të vështirësive prej fëmijëve dhe familjes së tij.

Sufjan ibn Ujejne thoshte:

"Të kesh shumë gra nuk është tregues i dashurisë ndaj kësaj bote, sepse Alia r.a., si as'hab i cili më së shumti përmbahej nga kjo botë, i kishte katër gra dhe shtatëmbëdhjetë skllave."

Jeta martesore është sunnet i vjetër dhe princip etik i Pejgamberëve.

Një person i tha Ibrahim b. Ed'hemit, Allahu e mëshiroftë:

- I lumi ti, nuk ke familje, prandaj u je kushtuar ibadeteve! Ibrahim b. Ed'hemi i tha personit:

- Frika jote për familjen është më e vlefshme se të gjitha ato që i bëj unë!

- Çka po të ndalon të martohesh, pra?, e pyeti personi:

-Nuk ndiej nevojë për grua, e nuk do të doja ta poshtëroj asnjërën nga to.

Është thënë që epërsia e të martuarit ndaj beqarit është si epërsia e muxhahidit ndaj atij që nuk shkon në luftë, dhe që reqati i të martuarit vlen sa shtatëdhjetë reqate të beqarit.

LARGIMI NGA MARTESA

Për largim nga martesë, Resulallahu s.a.v.s., thotë:

“Pas dy shekujsh (hixhri), më i miri do të jetë i pamartuari që nuk ka as familje as fëmijë.”¹²

“Do t’ju vijë koha kur burri do ta pësojë për shkak të gruas së tij, prindërve dhe fëmijëve, të cilët do ta qortojnë për varfërinë dhe do të dëshirojnë atë çka nuk është në gjendje ta sigurojë, e do të lëshohet në atë me çka do ta humbë imanin, dhe kështu do ta pësojë.”¹³

Është thënë: *“Familja e vogël është një mënyrë e të jetuarit më komod, e familja e madhe është një nga arsyet e varfërisë”.*

E kanë pyetur Ebu Sulejman ed-Daranin për martesën, dhe ai ka thënë:

“Të përmbahesh nga martesë është më mirë se të durosh familjen, e të durosh familjen është më mirë se të durosh Xhehenemin.”

Ed-Darani gjithashtu ka thënë:

¹² Ebu Ja’la nga Huzejfe r.a, dhe Hattabi në ‘El-Uzle’, nga Huzejf dhe Ebu Umame r.a..

¹³ Hattabi në ‘El-Uzle’ nga Ibn Mesud r.a. në mënyrë të njëjtë, si edhe Bejheki në **“Ez-Zuhd”** nga Ebu Hurejre r.a..

“Në martesë nuk ka kënaqësi dhe qetësi nga ibadeti, ashtu siç ka në beqari.”

E me një rast ka thënë:

“Nuk e njoh asnjë nga shokët tanë i cili, kur është martuar ka mbetur në gradën e njëjtë.”

Gjithashtu, ed-Darani ka thënë:

“Ai që anon kah këto tri gjëra, anon kah dynjallëku:

-Kush kërkon dëmshpërblim material;

-Kush martohet;

-Kush shënon një hadith.”

Hasan Basriu, Allahu e mëshiroftë, thotë:

“Kur Allahu i dëshiron robit të tij të mirën, nuk e angazhon me familja dhe me pasuri.”

Ibn Ebi'l-Havari thotë që një grup ka diskutuar për këtë thënie të Hasan Basriut, dhe arritën në këtë përfundim: Kuptimi i kësaj fjalie nuk është që njeriu nuk duhet të ketë familje dhe pasuri, por që në ibadetin e tij, ato të mos jenë pengesë. Kjo na kujton fjalët e Ebu Sulejman ed-Daranit, i cili thotë:

“Familja dhe pasuria është shkatërrim për ty, nëse të ndalojnë nga ibadetet.”

Në përgjithësi, nga askush nuk transmetohet largim absolut nga jeta martesore, por vetëm se kanë preferuar martesën nën kushte të caktuara, deri sa nxitja në martesë përmendet edhe në mënyrë absolute edhe të kushtëzuar, kështu që të largojmë perden nga kjo me paraqitjen e dobive dhe të dëmeve të martesës.

DOBITË E MARTESËS

Në martesë ka pesë dobi:

- 1.Pasardhësit,
- 2.Qetësimi i epshit
- 3.Udhëheqja e shtëpisë
- 4.Shtimi i numrit të farefisit, dhe
- 5.Lufta me nefsin.

Dobia e parë janë pasardhësit dhe ky është themeli. Kjo është arsyeja pse është themeluar martesë, e qëllimi është vazhdimësia e brezave të rinj, që Toka të mos mbetet pa llojin njerëzor. Epshi është krijuar për të siguruar këtë. Ky epsh, me qëllim që të sigurohen pasardhës, është si kujdestar i atij që nxjerr farën dhe asaj që e pranon, ose si gjuetari i cili përhap drithërat që i pëlqejnë zogut përreth kurthit, për ta zënë atë. Fuqia që nuk ka fillim mund të krijojë pa martesë dhe pa shkaktar, por Ai ka lidhur gjithçka për ndonjë sebeb (shkak) për të shfaqur Urtësinë Hyjnore, për të treguar mrekullitë dhe për të realizuar arsyet e jetesës.

Në lindjen e fëmijës ekzistojnë katër aspekte të afrimit ndaj Allahut. Zaten, edhe kur njeriu është i sigurt nga epshi, këto katër shkaqe janë që inkurajojnë në martesë dhe parandalojnë nga të vdekurit si beqar:

- a. T'i përshtatet kënaqësisë së Allahut për të pasur fëmijë me qëllim të vazhdimit të llojit njerëzor;
- b. Kërkimi i dashurisë së Resulallahut s.a.v.s., përmes rritjes së ummetit, me të cilin ai do të krenohet;
- c. Të gjendet dikush që i bën dua pas vdekjes;
- d. Shpresa për shefat për shkak të vdekjes së fëmijës së mitur, nëse fëmija vdes para prindit.

Aspekti i parë: është më i rafinuari, dhe për këtë masat e gjëra më së paku mendojnë. Për ata të zgjuar që mendojnë rreth finesave të urtësisë dhe mrekullive të Allahut, kjo është edhe vlera më e rëndësishme. Këtë do të shpjegojmë me shembullin e zotërisë, i cili shërbëtorit të tij i dorëzon farën dhe mjetet e bujqësisë dhe ia dorëzon tokën e përshtatshme për bujqësi. Shërbëtori është i aftë për të mbjellë farën, e zotëria ia jepe dhe një ndihmës i cili e stimulon në këtë çështje. Pastaj, nëse shërbëtori e humb këtë aftësi, sigurisht që e hidhëron zotërinë dhe meriton qortimin.

Ngjashëm kësaj, Allah Teala krijoi çiftin – burrë e grua. Në kurriz të mashkullit vendosi spermën dhe përgatiti zbritjen e saj në vezore, si dhe krijoi rrugën e daljes nga këtu. Krijoi edhe mitrën te femra për t'u vendosur sperma dhe çdonjërit i dha epsh dhe dëshirë për veprim.

Pra, këto mjete dhe veprime, me gjuhën e gjendjes, shprehin haptas dëshirën e Krijuesit dhe dijetarët shpjegojnë zëshëm urtësinë dhe sebetet e kësaj. Kjo gjendje do të mjaftonte për sqarim të qëllimit të martesës, edhe po të mos ishte urdhri i Allahut Teala përmes Resulallahut s.a.v.s.:

“Martohuni dhe shumohuni!”

Megjithatë, Allahu ia shpalli këtë gjendje Resulallahut s.a.v.s., dhe Resulallahu s.a.v.s., këtë qartas e urdhëroi. Ata të cilët nuk martohen (pa arsye) duke mos e mbjellë farën, janë sikur ata që e kalbin farën dhe i lënë të pashfrytëzuara ‘mjetet’ e përgatitura, të cilat i ka krijuar Allahu. Ata thyjnë qëllimin e natyrës dhe të

urtësisë së krijimit, të shkruar në këto organe me lapsin e fuqisë e jo të shkronjave dhe zërave, të cilin mund ta kuptojë secili që nga Allahu ka marrë frymëzim hyjnor dhe që kupton hollësitë e njohjes së urtësisë së ezelit. Për këtë arsye, sheriatu fuqishëm e dënon vrasjen e fëmijëve dhe varrosjen e vajzave të gjalla, dhe këto i ka cilësuar si krime të mëdha, sepse ky është pengim i vazhdimësisë së ekzistimit. Brezat nuk shumohen pa femra. Në këtë aludojnë ata që thonë: “Derdhja e spermës jashtë mitrës, është si një lloj i vrasjes së fëmijës.” Ata që martohen synojnë të plotësojnë pëlqimin e Allahut Teala, derisa ai i cili preferon beqarinë, ka preferuar pasivitetin, dhe kjo sjellje nuk i pëlqen Allahut. Allah Teala nga dëshira e Tij urdhëroi të ushqyerit, dhe duke e inkurajuar tha:

“Kush është ai i cili me vullnet i jep Allahut hua...?”

2-Bekare:245

Mund të thuash: “*Dëshira e Allahut për mbijetesën e njerëzve dhe pasardhësve të tyre nënkupton dëshirën e Tij për mos-zhdukjen e njeriut*”. Por, kjo tregon që në mes vdekjes dhe jetës duhet të ketë dallim tek Allah Teala. Të dyja janë me dëshirën e Allahut Teala dhe Allahu është i pavarur nga çdo gjë, d.m.th., të dyja janë të barabarta tek Allahu. Dhe nëse thua: “*Çfarë dallimi bëhet në mes vdekjes dhe jetës, ekzistencës dhe jo-ekzistencës tek Allahu?*”, dije se kjo është një fjali e vërtetë (hak), ngase, e mira-e keqja, dobia-dëmi, dhe çdo gjë që ndodh në gjithësi, lidhet me dëshirën e Allahut dhe nuk është kundër saj. Dashuria me urrejtjen janë të kundërta me njëra tjetrën, por të dyja nuk janë kundër dëshirës së Allahut. Dëshira (irade) është

ndryshe nga pëlqimi (riza). Ka shumë gjëra që dëshirohen por nuk duhen, dhe ka shumë gjëra tjera që dëshirohen, por dhe duhen. Gjynahet edhe pse nuk duhen, janë me dëshirën e Allahut Teala. Allah Teala siç i njuh njerëzit para krijimit, i njuh edhe pas krijimit. Nuk ka ndryshim në diturinë e Tij. Dituria i është nënshtruar të njohurës. Në esencë, dituria hyjnore ka miratuar dëshirat dhe kërkesat e njeriut, qysh në ezel. Kur vjen koha, me dëshirën e Allahut ato nxirren në vepër.

Prandaj, dëshira (irade) dhe pëlqimi (riza) janë të ndara nga njëra-tjetra. Zbatimi i urdhrave të Allahut Teala (itaat) dhe adhurimi (ibadet) janë me dëshirën, dashurinë dhe pëlqimin e Allahut Teala. Edhe mosbesimi (kufër) dhe kundërshtimi janë me dëshirën e Allahut Teala. Por, ato nuk kanë pëlqimin (riza) e Allahut. Ndërsa në këtë ajet thuhet:

“Ai nuk është i kënaqur me mosbesimin e robërve të Vet.” 39-Zumer: 7

Si mundet atëherë që në pikëpamje të dashurisë dhe mos-dashurisë së Allahut, zhdukja e njerëzve të jetë e njëjtë si edhe mbijetesa e tyre? Allah Teala në një hadith kudsî thotë:

“Për asgjë tjetër nuk hezitoj më shumë se sa për të marrë shpirtin e robit Tim mysliman. Ai nuk e do vdekjen, e Unë nuk dua ta dëmtoj, e ai duhet të vdesë.”

¹⁴

Fjalët **“E ai duhet të vdesë...”** tregojnë se kësaj i paraprinë dëshira e Allahut dhe urdhëresa e cila përmendet në Kur’ani Kerim:

¹⁴ Buhari nga Ebu Hurejre r.a.

“Ne e caktojmë vdekjen tuaj...” 56-Vakia:60
dhe:

“Ai ka krijuar jetën dhe vdekjen...” 67-Mulk:2

Nuk ka kundërshti në fjalët e Allahut Teala: **“Ne e caktojmë vdekjen tuaj...”** dhe fjalëve të Tij **“...e Unë nuk dua ta dëmtoj...”**, por për të kuptuar këtë hakikat ashtu siç është, duhet të kuptohet hakikati dhe kuptimi i dëshirës (irade), dashurisë (muhabbet) dhe mos-dashurisë.

Në shikim të parë, duket sikur këto janë kuptime që janë të ngjashme me dëshirën, dashurinë dhe mos-dashurinë e krijesës, por kjo është absurde! Sa ka dallim mes Qenies (Dhat) të Allahut Teala dhe qenies së robërve të Tij, aq ka dallim mes cilësive të Allahut dhe cilësive të krijesave të Tij. Siç nuk munden të jenë të njëjta esenca me simbolin, edhe cilësitë nuk janë të njëjta mes vete.

Të gjitha këto hakikate i përfshin dituria *mukashefe*. Pas kësaj është fshehtësia e kaderit, e cila është e ndaluar të shpallet. Prandaj, e lëmë këtu, dhe të kufizohemi në atë që kemi tërhequr vëmendjen - se ekziston dallim në mes të vendosmërisë për t’u martuar dhe refuzimit të martesës. Mos-martesa i pamundëson pasardhësit, për të cilët Allah Teala ka dhënë të ekzistojnë qysh nga Ademi a.s., nga gjenerata në gjeneratë. Ai që refuzon martesën ndërpret ekzistimin që vazhdon qysh nga Ademi a.s., e deri te ai vet. Ai vdes pa pasardhës! Sikur të ishte epshi nxitja kryesore për martesë, Muadhi nuk do të thoshte, kur u sëmur nga

murtaja: *“Më martoni, se nuk dua të dal i pamartuar në prani Hyjnore.”*

Nëse thua: *“Në atë gjendje Muadhi nuk kishte mundësi për fëmijë, andaj pse dëshiroi të martohet?”*, unë them: Fëmija me marrëdhënie krijohet. Marrëdhënia lind nga epshi. Epshi nuk është në liri të zgjedhjes së njeriut. Në zgjedhje të njeriut është përgatitja e shkaqeve që i kërkon epshi. E kjo është e mundur në çdo kohë. Kush e përgatit këtë shkak, ka paguar borxhin dhe ka vepruar sipas dëshirës, e pjesa tjetër është jashtë fuqisë së tij të zgjedhjes.

Për këtë arsye është e lavdërueshme që edhe ai që është impotent të martohet, sepse zgjimi i epsheve është i fshehur. Bile, është procedurë që në Haxh, tullaci që nuk ka flokë, të kalojë me brisk mbi kokë, si edhe, sikur në kohërat e mëparshme që është bërë *‘remel’* dhe *‘iztiba’* për t’u dukur trim karshi armikut, edhe sot që nuk ka mbetur një shkak i tillë, përsëri është sunnet. Edhe për ata me fytyrë të rrudhur është e lavdërueshme të martohen.

Padyshim, në krahasim me mashkullin e pashëm, gjasat janë më të vogla. Bile edhe mundësitë për plotësimin e dëshirave dhe nevojave të femrës janë më të dobëta. Kjo gjendje mund të sjell përfundime të dëmshme. Pra, kjo është arsye për refuzimin e fuqishëm të martesës, d.m.th. jep shkak për ndërprerjen e breznive.

Aspekti i dytë: martesë është ndjekje e rrugës së Resulallahut s.a.v.s., të cilën ai e ka dashur. Resulallahu

s.a.v.s. e ka shprehur qartë se do të krenohet me numrin e ummetit të tij. Synimi i martesës është fëmija dhe kujdesi ndaj tyre. Për këtë tregojnë veprat dhe fjalët e Omerit r.a., i cili martohej shpesh, dhe thoshte: *“Martohem vetëm për shkak të fëmijëve”*, në këtë fjali ka shenja të qarta për lajmet në të cilat kritikohen gratë shterpe, ndërsa në një hadith, Resulallahu s.a.v.s. ka thënë:

“Fshesa në qoshe të shtëpisë është më e hairit se gruaja që nuk lind!”¹⁵

Gjithashtu:

“Gratë më të mira i keni ato të pëlleshmet!”¹⁶

dhe,

“Zezaken që lind e keni më të mirë se një bukuroshe (të bardhë) që nuk lind!”¹⁷

Kjo tregon qartë që përpjekja për të pasur fëmijë është arsye më e madhe për rëndësinë e martesës se sa fakti që martesë është nevojë për të shuar epshet. Edhe pse gruaja e bukur është më tërheqëse, ndalon shikimet e burrit, dhe ia shuan epshin, që janë mbrojtje të mashkullit, megjithatë, zezakja është lavdëruar.

Aspekti i tretë: përmes martesës - lënia mbrapa e fëmijës, i cili për të do të bëjë dua, siç është cekur në

¹⁵ Ebu Omer et-Tevkani nga Omer b. Hattab r.a.

¹⁶ Bejhëki në transmetim të Ibn Ebi Udeje es-Sadefi.

¹⁷ Ibn Hibban në **‘Ed-Dhuafa’** në transmetim të Behz ibn Hakim, të cilën ai e transmeton nga i ati, e ai nga gjyshi.

transmetimin që të gjitha veprat e njeriut ndërpriten përpos tri, prej të cilave është edhe fëmija i mirë.

Në një transmetim tjetër thuhet:

“Duatë u dhurohen të vdekurve në tabakë nga nuri.”¹⁸

Fjalët e atij që thotë: *“Por ndoshta fëmija nuk do të jetë i mirë”* nuk kanë ndikim, sepse ai është besimtar, e në të shumtën e rasteve fëmijët e besimtarit janë të mirë, sidomos kur prindi është i patundur në edukimin e tij dhe inkurajon fëmijën të jetë i mirë. Sido që të jetë, dua ja e besimtarit për prindërit e tij është e mirë, pa marrë parasysh a është ai i ndershëm apo gjynahqar. Prindërit do të përfitojnë prej duasë së tij dhe veprave të mira, sepse fëmija është fryt i tyre. Por, për kryengritje nuk qortohen, sepse në Kur’ani Kerim është thënë: **“Askush nuk ngarkohet me gjynahet e tjetrit.”**

Për këtë, Allah Teala thotë:

“Ne atyre do t’ua shoqërojmë pasardhësit e tyre dhe asgjë nuk u pakësojmë nga veprat e tyre (prindërve).” 52-Tur: 21

Aspekti i katërt: shefati (ndërrhyrja) e fëmijëve në kiamet. Kur fëmija vdes para prindit, ai fëmijë bëhet shefatxhi për prindërit e vet. Transmetohet nga Resulallahu s.a.v.s., të ketë thënë:

“Fëmija do t’i tërheq prindërit e tij në xhennet!”¹⁹

¹⁸ E kemi shënuar në veprën *‘el-Erbeinel-mesh’hure* në transmetim të Ebu Hudbe nga Enesi r.a.

¹⁹ Ibn Maxhe në transmetim të Alisë r.a., por në të në vend të *‘fëmija’* qëndron *‘fëmija i parakohshëm’* Ibn Maxhe e shënon edhe

Në një transmetim tjetër thuhet:

“Ashtu siç po mbaj unë tani rrobën tënde, edhe fëmija do të kap rrobën e babait të tij.”²⁰

Gjithashtu, Resulallahu s.a.v.s., ka thënë:

Të porsalindurit do t’i thuhet: ‘Hyj në xhennet!’, e ai do të ndalet te dyert e xhennetit, do të jetë plot siklet dhe zemërim, dhe do të thotë: ‘Nuk do të hyj në xhennet pa prindërit e mi!’ E atëherë do të thuhet: ‘Futni prindërit e tij së bashku me të!’²¹

Në një transmetim tjetër thuhet:

Fëmijët do të mblidhen në vendqëndrim kur krijesat do t’i nënshtrohen dhënies së llogarisë, e do t’u thuhet melaïkeve:

‘Dërgoni këta në xhennet!’ Ata do të ndalen atëherë para dyerve të xhennetit, e do t’u thuhet:

‘Mirë se erdhët, perlat e myslimanëve, hyni, për ju nuk ka llogaridhënie’, e ata do të thonë:

‘E ku janë baballarët dhe nënat tona?’ Rojet do t’u thonë:

‘Baballarët dhe nënat tuaja nuk janë si ju, ata kanë gjynahe dhe vepra të këqija, e për to tani japin llogari.’

nga Muadhi r.a., në këtë formë: *“Vërtet fëmija do të tërheq nënën e tij me shiritin e kërthizës kah xhenneti, nëse ajo ka qenë e durueshme me të.”*

²⁰ Muslimi në transmetim të Ebu Hurejres r.a..

²¹ Ibn Hibban në **‘ed-Dhuafa’** në transmetim të Behz ibn Hakim, , si edhe Nesai në transmetim të Ebu Hurejre r.a, ku thuhet: *“...do t’u thuhet: ‘Hyni në xhennet!’ Në këtë ata do të thonë: ‘Deri sa të hyjnë prindërit tanë!’ Atëherë do t’u thuhet: ‘Hyni në xhennet edhe ju edhe prindërit tuaj!’”* Zinxhirin e transmetuesve e ka të mirë.

Atëherë, ata do të qajnë e do të bërtasin para dyerve të xhennetit. Allah Teala edhe pse di për ta, do t'u thotë melaikëve:

‘Çfarë britme është kjo?’ Melaiket thonë:

‘O Rabbi ynë, fëmijët e myslimanëve thonë që do të hynë në xhennet vetëm me prindërit e tyre.’ Atëherë, Allah Teala do të thotë:

‘Dilni mes të mbledhurve dhe merrni për dore prindërit e tyre dhe fusni në xhennet!’²²

Resulallahu s.a.v.s., thotë:

“Kujt i vdesin dy fëmijë, ai është rrethuar (me mbrojtje) nga Xhehenemi.”²³

Gjithashtu, Resulallahu s.a.v.s., ka thënë:

“Kujt i vdesin tre fëmijë të mitur, Allahu ka për ta futur në xhennet për shkak të mirësisë së Tij ndaj fëmijëve të tyre.”

Pyetën: *O Resulallah, e dy?* Edhe dy, u përgjigj Resulallahu s.a.v.s.²⁴

²² Nuk është gjetur burim ku do të mbështetej hadithi.

²³ el-Bezzar dhe Taberani në transmetim të Zuhejr ibn Ebi Alkame, me fjalët në vijim: “*Ka ardhur një grua ensare te Resulallahu s.a.v.s. dhe i ka thënë: ‘O Resulallah, pos këtij, edhe dy fëmijë të tjerë më kanë vdekur,’ në çka ai i ka thënë: ‘Me rrethojë të fortë je rrethuar nga Xhehenemi.’*”. Te Muslimi, në transmetim të Ebu Hurejre r.a., është shkruar që Resulallahu s.a.v.s., gruas që ka thënë: ‘*Tre i kam varrosur!*’ i ka treguar: ‘*Me rrethojë të fortë je mbrojtur nga Xhehenemi.*’

²⁴ Buhariu dhe Muslimi nga Ebu Saidit r.a..

Flitet se një besimtari të devotshëm i ishte ofruar martesë, e ai një kohë të gjatë kishte refuzuar. Një ditë ishte zgjuar nga gjumi duke thënë:

“Më martoni! Më martoni!”. Kur u pyet për këtë, tha:

“Ndoshta Allahu më fal një fëmijë, e më pas ma merr, e më bëhet shefatxhi në ahiret.” E atëherë, kështu u tregoi ëndrrën: “Kam ëndërruar sikur Dita e Kiametit tashmë kishte ardhur, e unë në vend-pritje si të tjerët aq i etur isha, sa që buzët mu qanë. Ne ishim në atë gjendje, kur filluan të arrijnë fëmijët, mbi ta kishte shamia të nurit, e në duar ibrikë të argjendtë dhe gota të arta, duke u futur në mesin e të mbledhurve, u dhanë ujë disave, por tejkaluan shumicën e njerëzve. Unë i zgjata duart kah njëri nga ta dhe e luta:

‘Më jep të pi, edhe unë jam shumë i etur!’, e ai më tha:

‘Ti nuk ke fëmijë në mesin tonë, ne mund t’u japim ujë vetëm prindërve tanë!’ E pyeta:

‘E kush jeni ju?’ Mu përgjigjën:

‘Ne jemi fëmijët e myslimanëve.’”

Në ajetin:

“Gratë tuaja janë “ara” për ju, prandaj iu afroni “arave” tuaja si të doni. Por bëni diçka (të mirë) për veten tuaj.”2-Bekare:223, me **“ Por bëni diçka (të mirë) për veten tuaj”** mendohet në fëmijën shefatxhi në ahiret.

Pra, në këto katër aspekte, është kuptuar se vlerë e martesës janë fëmijët.

Te **dobia e dytë** bëjnë pjesë: mbrojtja nga shejtani me anë të thyerjes së epshit, si edhe ruajtja e shikimit dhe e vetes nga e mos-lejuara, për çka tregojnë fjalët e Resulallahut s.a.v.s.:

“Kush është martuar, e ka mbrojtur gjysmën e fesë së vet, e për gjysmën tjetër le t’i përshtatet urdhrave të Allahut.”

“Martohuni, e kush nuk është në gjendje, le të agjërojë, sepse në agjërim ka një veçori që e thyen epshin.”

Shumica e transmetimeve që i kemi përmendur flasin për këtë kuptim, por ky qëllim është më i ultë se qëllimi i parë, sepse vet epshi nuk është mjet, por shkaktar për lindjen e fëmijës.

Martesa e thyen epshin. Megjithatë, ai i cili i përshtatet urdhrave të Allahut me dëshirën e arritjes së kënaqësisë së Tij, nuk është sikur ai i cili i përshtatet urdhrave duke u munduar të lirohet nga barra e epshit. Epshi dhe fëmija janë të paracaktuar, dhe mes tyre ekziston lidhje. Nëse nuk do të ishte qëllimi për të vazhduar brezin, nuk do të jepej epshi. Nuk mund të thuhet që qëllimi i martesës është kënaqja, e që fëmija është pasojë e domosdoshme e saj, siç është për shembull kryerja e nevojave fiziologjike pasojë e domosdoshme e të ngrënit. Përkundrazi, fëmija është qëllim sipas natyrës dhe urtësisë së Allahut, e epshi vetëm nxit në të.

Betohem në jetën se epshi, përveç arritjes së fëmijës, ka edhe urtësi tjetër. E kjo urtësi është të përkujtohen kënaqësitë në xhennet. Kënaqja që ndjehet gjatë kohës së shprehjes së epshit nuk është e barabartë me asnjë kënaqje tjetër, pa marrë parasysh sa zgjatë. Kjo tërheq mall për kënaqësitë që janë të premtuara në xhennet, sepse malli për kënaqësinë e cila nuk mund të ndjehet është i padobishëm. As impotenti nuk kupton nga marrëdhënia, e as fëmija nuk merr kënaqësi nga pushteti dhe fuqia. Me lajmërimin që në xhennet vazhdimisht do të ketë kënaqësi, në fakt stimulohet nënshtrimi shariatit, si e vetmja mënyrë për të hyrë në xhennet. Shiko fillimisht këtë urtësi të mrekullueshme, pastaj nën këtë urtësi, mëshirën hyjnore për robërit, dhe pastaj mendo edukimin hyjnor dhe shiko si nën një epsh janë bashkuar dy jetët, njëra e dukshme, e tjetra e padukshme. Jeta e dukshme është jeta e njeriut derisa pasardhësit e tij jetojnë, që është në një mënyrë jeta e trupit të tij. Jeta e padukshme është jeta e ahiretit. Kënaqësia që përfundon shumë shpejtë stimulon në kënaqësi të vërtetë, të përhershme, dhe drejton në ibadete me cilat arrihet kjo kënaqësi e përhershme. Në këtë mënyrë, malli për kënaqësinë bën dobi dhe lehtëson kryerjen e ibadeteve që sjellin deri te bereqetet e xhennet. Nuk ka asnjë atom në trupin e njeriut, të dukshëm a të padukshëm, aq më shumë – as në qiell dhe Tokë, e të mos fshihen në të finesat dhe mrekullitë e urtësisë së Allahut e cila i huton mendjet njerëzore. Por, ato i zbulohen vetëm zemrave të pastra, në proporcion me pastërtinë e tyre nga zbulimet dhe gjërat mashtruese të kësaj bote.

Përmbledhje: martesë, në kuptim të shuarjes së epshit është shumë e rëndësishme për besimin e secilit që nuk është impotent, e të tillë janë shumica e njerëzve, sepse kur dominon epshi, e nuk frenohet me forcën e devotshmërisë, ai tërheq në kryerjen e paturpësive, për çka flasin fjalët të cilat Resulallahu s.a.v.s. i përcjellë nga Allah Teala:

“Nëse nuk veproni ashtu, do të bëhet ngatërresë dhe shkatërrim i madh në Tokë.”8- Enfal: 73

Por ata që lidhen plotësisht në devotshmëri, ata nëpërmjet devotshmërisë i ruajnë vetëm gjymtyrët dhe shikimin e tyre nga përgjigja ndaj epshit. Ndërsa ruajtja e zemrës nga joshja dhe vesvesja e shejtanit nuk është vullneti i tij i lirë. Shejtani që e josh me këtë nuk ndalet thuaja kurrë, bile as gjatë kohës së namazit, kështu që nëpër mendje i kalojnë lojëra të tilla seksuale prej të cilave do të turpërohej edhe po ti tregonte para njerëzve më të pamoralshëm.

Allahu e njeh zemrën e personit: çka është gjuha mes njerëzve - tek Allahu është zemra. Prandaj, për muridin që ka hyrë në rrugë të ahiretit, puna më e rëndësishme është zemra. Edhe vazhdimësia në agjërim të shumica e njerëzve nuk e ndërpret këtë vesvese të shejtanit, përpos me dobësimin e trupit dhe me shëndet të trazuar. Për këtë Abbasi r.a. ka thënë: *“Ibadeti i besimtarit (abidit) plotësohet vetëm me martesë. Kjo është një provë dhe pasion gjithëpërfshirës, prej të cilës rrallë kush mund të shpëtojë.”*

Katade thotë që në ajetin e Allahut Teala:

“..mos na ngarko me diçka që nuk mund ta bartim!” 2- Bekare: 286, me *‘diçka që nuk mund ta bartim’* mendohet në epshin e tepërt.

Nga Ikrime dhe Muxhahid transmetohet se kanë thënë për ajetin:

“...njeriu është krijuar si një qenie e pafuqishme...”
4-Nisa:28.

se me *‘pafuqishëm’* mendohet në pasionin e tepërt pas guas, dhe mungesën e durimit ndaj tyre.

Fejadh ibn Nexhah ka thënë: *“Kur njeriut i forcohet organi, i humbin dy të tretat e mendjes.”* Bile, disa kanë thënë: *“...I humb një e treta e fesë.”*

Në *‘Nevadirut-Tefsir’*, nga Ibn Abbas r.a., thuhet se në ajetin:

“...dhe nga sherri i natës, kur kaplon terri...”

113-Felek:3,

me shprehjet *‘gasik’* dhe *‘vekab’*, mendohet kur organi mashkullor forcohet.

Kjo është një provë e madhe. Nganjëherë, kur epshi emocionohet, as mendja e as besimi nuk mundën aq lehtë ta marrin nën kontroll. Së bashku me këtë, siç e treguam më lartë, epshi ka mision për të dy jetët, e njëkohësisht është edhe arma më e fortë e shejtanit kundër njeriut.

Për këtë tregon Resulallahu s.a.v.s.:

“Nuk kam parë në mesin e të mençurve, më të mangët se ju (femrat) në mendje dhe në fe.” Kjo për shkak të epshit të tepruar të femra.²⁵

Resulallahu s.a.v.s. bën dua:

“Allahu im, tek Ti strehohem nga e keqja e dëgjimit tim, shikimit tim, zemrës sime, dhe nga emocionet e epshit tim.”²⁶ Me një dua tjetër:

“Allahu im, të lus të pastrosh zemrën time dhe të mbrosh organin tim.”²⁷

Si munden të tjerët të mos i japin rëndësi asaj për çka edhe vet Resulallahu, s.a.v.s., ka kërkuar strehim!

Një besimtar i devotshëm martohej shpesh, kështu që kurrë nuk ishte pa dy ose tri gra. Disa ia panë për të madhe, në çka ai tha:

- *A i ka ndodh ndonjërit nga ju që të jetë në namaz, e t'i vjen ndonjë mendim epshor?* Thanë:

- *Kjo na ndodh shpesh, e në këtë ai u tha:*

- *Sikur vetëm një herë në jetë të kisha qenë i kënaqur me gjendjen si e juaja, nuk isha martuar, por sa herë të më vjen ndonjë mendim i cili më okupon, unë menjëherë atë e parandaloj dhe në qetësi i kthehem ibadetit. Plot 40 vite nuk më ka shkuar mendja në asgjë që është gjynah.*

²⁵ Muslimi transmeton nga Ibn Omeri r.a., Buhari dhe Muslimi nga Ebu Said r.a.

²⁶ I shënuar më herët në Librin për duatë. (Tirmidhiu dhe Taberani)

²⁷ Bejheki në 'ed-Davat' nga Ummu Seleme r.a..

Një person kritikoi disa sjellje të sufive, e një besimtar e pyeti:

- *Çka iu sheh për të madhe?* Personi tha:
- *Hanë shumë,* e besimtari iu përgjigj:
- *Po të ishe uritur sa ata, edhe ti do të kishe ngrënë sa ata.*

- *Martohen shpesh,* vazhdoi personi, e besimtari i tha:

- *Sikur të ruaje edhe ti shikimin dhe organin siç bëjnë ata, edhe ti do të martoheshe sa ata.*

Xhunejdi Bagdadi ka thënë:

“Marrëdhënia martesore më nevojitet sa edhe ushqimi. Bashkëshortja është, në të vërtetë, ushqim dhe shkaktar i pastërtisë së zemrës.”

Për këtë Resulallahu s.a.v.s. ka urdhëruar që:

“Secilit që shikon një femër, dhe ndjen mall për të, të vrapojë te gruaja e vet.”²⁸

Veprimi i tillë heq vesvesen nga zemra.

Xhabiri r.a., transmeton se Resulallahu s.a.v.s., e kishte parë një grua, e më pas ka hyrë në dhomë te Zejnebja, e ka plotësuar nevojën e vet dhe kur ka dalë,

Resulallahu s.a.v.s., ka thënë:

“Gratë dalin karshi mashkullit si shejtanë. Kur e shikon një grua dhe e dëshiron, menjëherë shko te gruaja jote, se edhe kjo ka atë që ka ajo.”²⁹

²⁸ Ahmedi në transmetim të Ebu Keshes el-Enmari, zinxhiri i transmetuesve është i mirë.

Resulallahu s.a.v.s. gjithashtu ka thënë:

“Mos hyni te ato që nuk i kanë burrat në shtëpi, sepse shejtani sillet nëpër trup si gjaku.”

As’habët e pyetën: *‘Edhe nëpër trupin tënd?!’*

“Edhe nëpër trupin tim, por Allahu më ka ndihmuar rreth tij, dhe shejtani im u bë mysliman.”³⁰

Sufjan ibn Ujejne ka thënë:

“Fjalët: ‘... ai u bë mysliman’ në fakt e ka kuptimin: ‘...dhe kam mirësi nga ai’. Ky është kuptimi i vërtetë, sepse shejtani nuk bëhet mysliman.”

Kështu, transmetohet edhe se Abdullah b. Omeri r.a., i cili ka qenë njëri ndër as’habët më të dijshtëm dhe më të devotshëm, kur ishte duke agjëruar, para se të hante dhe ta falte akshamin, bënte iftar me marrëdhënie martesore, e më pas lahej dhe falej. Krejt kjo me qëllim që zemra të lirohet vetëm për ibadete. Transmetohet se ai kishte marrëdhënie edhe me tri skllave të veta në ramazan para jacisë, e Ibn Abbas ka thënë:

“Më i hairit në këtë ummet është ai që ka më së shumti gra.”

²⁹ Transmetojnë Muslimi dhe Tirmidhiu. Ky është transmetim i Tirmidhiut.

³⁰ Tirmidhi nga Xhabiri r.a.. Te Muslimi, në transmetim të Abdullah ibn Omeri r.a. qëndron teksti si vijon: *“Pas kësaj dite, askush të mos hyjë pa një ose dy persona, te gruaja që nuk e ka burrin në shtëpi.”*

Meqenëse epshi dominon te arabët, martesat e shpeshta te besimtarët e devotshëm në mesin e tyre u bënë të zakonshme. Me qëllim që zemra të gjej qetësi dhe për të parandaluar zinánë, është bërë e lejuar edhe martesa me skllave. Megjithatë, fëmija i lindur është i varur nga nëna, ai bëhet skllav, e kjo në një mënyrë është shkatërrim i fëmijës. Për ata që kanë mundësi për t'u martuar me gra të lira, kjo është haram. Por, bërja e fëmijës skllav është më pak e dëmshme se shkatërrimi i fesë. Sepse kjo është një prishje e limituar e jetës së fëmijës, por në kryerjen e paturpësisë (ziná) është humbja e lumturisë së ahiretit për një kohë të gjatë.

Transmetohet se një ditë u shpërndanë ata që gjendeshin në bisedën fetare (sohbet) e Ibn Abbasi, dhe mbeti vetëm një i ri i cili nuk u largua dhe të cilit Ibn Abbasi i tha:

- *O biri im, a ke ndonjë nevojë?* I riu tha:

- *Po, kam. Dëshiroja t'ju pyes diçka, por turpërohesha nga të tjerët, kurse tani po hezitoj sepse ndjej respekt ndaj jush.* Ibn Abbasi i tha:

- *Dijetari është si prindi, prandaj atë që do t'ia besojë babait tënd, edhe dijetarit duhet t'ia besosh. Tani, pyet çka është derti yt?* Atëherë ai i tha:

- *Unë jam një beqar i ri, nganjëherë frikësohem se do të bëj ziná, prandaj masturboj. A ka gjynah në këtë?* Atëherë Ibn Abbasi e ktheu fytyrën prej tij e më pas tha:

- *Turpërohu! Sa sjellje e shëmtuar. Të martohesh me skllave është më e mirë se kjo, ani pse edhe kjo është më e mirë se zinája.*

Ky tregim është paralajmërim se beqarët hezitojnë në mes të tri të këqijave. Më pak e dëmshme është martesë me skllave, me çka fëmija bie në pozitë të skllavit. Më e keqe se kjo është masturbimi, e edhe më e keqe është zinaja. Për asnjërën nga këto Ibn Abbasi nuk ka thënë që është absolutisht e lejuar, sepse dy të parat janë të rrezikshme, por ato mbrojnë për të mos rënë në rrezik edhe më të madh, siç mbron ngrënia e kafshës së vdekur nga humbja e jetës. Tolerimi i tyre nuk do të thotë se ato janë absolutisht të lejuara. Për të mos mbytur njeriun duke u përhapur infektimi në tërë trupin, lejohet të amputohet dora ose këmba, ani pse kjo nuk është absolutisht e hairit; njëjtë është edhe gjykimi që nga dy të këqija të preferohet më e lehta.

Nga këto janë kuptuar vlera të shumta të martesës. Kjo nuk është gjithëpërfshirëse, por vlen për të shumtën e rasteve. Ka të tillë, epshi i të cilëve është i dobët për shkak të pleqërisë, sëmundjes ose për shkaqe të tjera. Te këta nuk ka epsh të tepërt, por ata kanë synim për të pasur fëmijë, që është e zbatueshme për të gjithë, përveç hadumit, të cilët prapë, janë shumë të rrallë.

Ka edhe natyra të tilla njerëzore ku epshi është posaçërisht i shprehur, prandaj nuk mund ta frenojë një grua. Atëherë është e lavdërueshme që personi i tillë të martohet përnjëherë me më së shumti katër gra. E nëse Allahu i dhuron dashuri dhe mëshirë, dhe zemra i qetësohet me to, është mirë të mbetet me to, e nëse jo, nuk mundet të merr më shumë, por mund t'i ndërrojë. Kështu, Hazreti Alia r.a., pas vdekjes së Hazreti

Fatimasë, u martua në natën e shtatë. Thonë që Hasani, i biri i Hz. Alisë, është martuar me mbi dyqind gra, pa pasur më shumë se katër gra përnjëherë. Në disa raste, ai do të ndahej me të katra përnjëherë, duke i ndërruar me tjera. Resulallahu s.a.v.s. i thoshte Hasanit:

“Ti më ngjanë mua, nga pikëpamja e trupit dhe moralit.”³¹

Gjithashtu thoshte:

“Hasani është prej meje, ndërsa Huseini prej Alisë.”³²

Thuhet se numri i madh i martesave të Hasanit është ngjasim me njërën nga natyrat e Resulallahut s.a.v.s.. Mugire ibn Shu’be ishte i martuar me tetëdhjetë gra. Ka pasur as’habë me nga tri dhe katër gra, e ata që kishin nga dy nuk mund as të numërohen. Ilaçi duhet të jetë i përshtatshëm me sëmundjen. Qëllimi është që të qetësohet shpirti, e kjo duhet të arrihet me numër më të vogël ose më të madh të martesave.

Në dobinë e tretë bëjnë pjesë: pushimi dhe shoqërimi me gruan, shikimi i saj dhe loja me të, për të siguruar qetësinë e zemrës, dhe me këtë të përfordhet ibadeti. Meqë njeriu ka shumë telashe, ai nuk mundet vazhdimisht të bëjë ibadet në qetësi dhe gëzim. Njeriu kështu është i krijuar. Nëse detyrohet në ibadet përkundër dëshirave, ai këmbëngul për të mos i bërë ato. Vetëm nëse në momente të caktuara përkëdhelet me kënaqësi të ndryshme, ai forcohet, dhe me dëshirë

³¹ Buhariu dhe Muslimi nga Bera r.a.

³² Ahmedi, në transmetim të Mikdad ibn Madi Keribit r.a., me zinxhir të mirë të transmetuesve.

kthehet në ibadet. Shoqërimi me gra ofron dëfrim i cili largon mundimin dhe pushon zemrën. Edhe për të devotshmit, dëfrimi me gjëra të lejuara është i pranueshëm. Për këtë Allah Teala thotë:

“...edhe bashkëshorten e tij (Havanë), që të gjente qetësi tek ajo.” 7- Araf: 189

Alia r.a. thotë: *“Pushoni zemrat kohë pas kohe, sepse kur lodhet zemra, verbohet.”*

Në hadith thuhet:

“I mençuri e ndanë kohën në tri pjesë: një pjesë duhet ta kaloj në ibadet, tjetrën në llogari vetes, dhe të tretën me punë personale.”³³

Koha kur merret me punët personale, bëhet ndihmës për kohët tjera. Në kuptim të njëjtë, me një shpjegim tjetër të Resulallahut s.a.v.s., thuhet:

“Njeriu i mençur vepron vetëm për tri gjëra: të sigurohet për ahiret, të sigurojë mjetet e jetesës, dhe për kënaqësi - me kusht që nuk është haram.”³⁴

Resulallahu s.a.v.s. thotë:

“Secili veprues duhet të angazhohet dhe të përpiqet, e secila përpjekje ka nevojë për pushim, prandaj ai që pushon në pajtim me sunnetin tim, është i udhëzuar!”³⁵

³³ Ibn Hibban në transmetim nga Ebu Zerr, r.a. nga një hadith më të gjatë.

³⁴ Ibn Hibban në transmetim nga Ebu Zerr r.a.

³⁵ Ahmedi dhe Taberani në transmetim nga Abdullah Ibn Omer r.a.; kurse Tirmidhiu ngjashëm me këtë në transmetim nga Ebu Hurejre r.a.

Ebu Derda r.a., ka thënë: *“Unë nganjëherë e pushoj nefsën (veten) me argëtim, që më pas të jem më i qëndrueshëm në Hak dhe në hakikat.”*

Në disa transmetime nga Resulallahu s.a.v.s., qëndron të ketë thënë:

“Iu ankova Xhebrailit a.s., në pamundësinë e aktit seksual, e ai më rekomandoi konsumimin e harises (ushqim i gatuar me mish dhe grurë).”³⁶

Nëse kjo është e besueshme, atëherë është e mundur të kuptohet vetëm në pikëpamje të mosekzistimit të kënaqësisë, e jo në kuptim të mosekzistimit të epshit, sepse përgatitja flakëron epshin, e ai që është pa epsh është i privuar nga shumica e këtyre intimiteteve. Resulallahu s.a.v.s., ka thënë:

“Nga bota juaj, tri gjëra i kam të dashura: aromën, gratë, dhe nurin e syrit tim – namazin.”³⁷

Edhe pjesa e tretë (namazi) është një dobi për të pushuar zemra.

Dikush që lodhet me ibadete, e kupton se përpos aspektit të parë dhe të dytë, edhe aspekti i tretë i siguron dobi. Bile, duke ndenjur, biseduar dhe luajtur së bashku me gruan, edhe hadumi merr shije dhe veten e

³⁶ Ibn Adijj në transmetimet nga Huzejf r.a., dhe Ibn Abbas r.a.; Ukajli në transmetimet nga Xhabir ibn Semura; Ibn Hibban në ‘**ed-Dhuafa**’ në transmetim nga Huzejf r.a kurse Ezdi në ‘**ed-Dhuafa**’ nga Ebu Hurejre r.a.

³⁷ Nesa dhe Hakim, i cili mendon se është i besueshëm me kritere të Muslimit në transmetim nga Enesi r.a., me zinxhir të mirë të transmetuesve.

pushon. Në të njëjtën kohë, kur mendohet për t'u martuar, duke marrë parasysh edhe këtë anë, martesës i dhurohet një vlerë (fazilet) shtesë. Por, shumica nuk ka dijeni për këtë qëllim. Në të shumtën e rasteve dominojnë martesat për të pasur pasardhës, dhe për frenimin e epshit. Megjithëkëtë, edhe pse dëfrimi me gratë pushon zemrën, shumica marrin shije duke shikuar ujë të rrjedhshëm dhe gjelbërime. Kjo, ndryshon sipas pikëpamjes dhe rrethanave të personalitetit. Çdokush e pushon veten sipas dëshirës së vet.

Dobia e katërt nga martesë është shpëtimi nga marrja me punë të shtëpisë si zierja, pastrimi, rregullimi i shtrojës dhe përgatitja e gjithçkaje që nevojitet për jetë. Burri, edhe po të ishte pa ndjenjën e epshit, është vështirë të merret me punët e shtëpisë, sepse sikur të ngarkohej me të gjitha këto punë, merr shumë kohë dhe pengon t'i kushtohet diturisë, ibadetit dhe punëve tjera. Gruaja e mirë, e cila rregullisht mirëmban shtëpinë, nga kjo pikëpamje është ndihmesë në fe. Mosplotësimi i këtyre kushteve preokupon dhe i pengon zemrës dhe vështirëson jetën, për çka Ebu Sulejman Darani ka thënë:

“Gruaja e mirë nuk është pasurie kësaj bote, por është lumturi e ahiretit. Sepse me shuarje të epshit të mashkullit dhe me mirëmbajtje të shtëpisë, i siguron atij për të bërë ibadete.”

Muhammed ibn Ka'b el-Kurdhi, për fjalët e Allahut Teala:

“...Rabbi ynë, na jep të mira në këtë botë...”

2-Bekare:201,

ka thënë se në ajet me *'të mirë'*, synohet gruaja e mirë. Kurse Resulallahu s.a.v.s. thotë:

“Secili prej jush le të mundohet për një zemër falënderuese, gjuhë e cila përmend Allahun dhe grua besimtare, të dashur, e cila do ta ndihmojë në punët e ahiretit.”³⁸

Shiko si i ka bashkuar gruan e mirë, dhikrin (përmendjen) dhe falënderimin, deri sa në disa tefsire thuhet që në fjalët e Allahut:

“...do ta bëjmë që të kalojë jetë të bukur...”

16-Nahl:97,

qëllimi me *'jetë të bukur'* është gruaja e mirë, myslimane dhe e hairit.

Omer ibn Hattab r.a., ka thënë:

“Pas imanit, njeriut nuk i është dhënë dhuratë më e madhe se gruaja e hairit. Disa gra janë vërtet pasuri që nuk mund të vlerësohet me asgjë, derisa disa tjera janë si pranga nga të cilat nuk mund të lirohesh.”

Resulallahu s.a.v.s. thotë:

“Jam shpërblyer mbi Ademin me dy tipare: E para, gruaja e tij i ka qenë ndihmesë në gjynah (gabim), e gratë e mia mua më janë ndihmesë në ibadet. Dhe e dyta, shejtani i tij ishte qafir (mohues) kurse i imi është mysliman, dhe urdhëron vetëm të mirën.”³⁹

³⁸ Tirmidhiu, i cili e konsideron të mirë, dhe Ibn Maxhe, i të cilit është edhe ky formulim, në transmetim të ndërprerë.

³⁹ Hatibi në veprën e tij **‘Tarihi Bagdad’**, në transmetim nga Ibn Omeri r.a.. Muslimi transmeton nga Ibn Mesud r.a., në të cilën thuhet: *“Për secilin prej jush është caktuar një xhin përcjellës. E pyetën: Edhe për ty, o i Dërguari i Allahut? Edhe për mua, u përgjigj*

E ka llogaritur këtu një vlerë të lartë (fazilet) ndihmën e gruas në zbatimin e urdhrave të Allahut Teala.

Kjo është gjithashtu një nga dobitë që e kanë kërkuar të devotshmit, e veçanërisht për ata që nuk kanë askënd të kujdeset dhe që do t'ua mirëmbajë shtëpinë. Në këtë rast mjafton një grua, sepse shumë herë, bashkimi i dy grave mund të vështirësojë jetën dhe të komplikojë kujdesin për shtëpinë. Edhe rritja e numrit të farefisit dhe përfitimi i fuqisë hyn në këtë dobi, sepse me qëllim që të mbrohet nga armiku dhe të kryejë ibadetet në qetësi, njeriu ka nevojë për një familje kallaballëk. Poshtërimi e humb qetësinë e njeriut, farefisi dhe familja e madhe e largon poshtërimin. Prandaj është thënë: *“I poshtëruar është ai i cili nuk ka ndihmëtar, deri sa është i shpëtuar ai i cili ka dikë që do të largojë të keqen nga ai, dhe zemra e tij mund t'i kushtohet ibadetit”*.

Dobia e pestë është lufta dhe kontrolli i vetes duke përmbushur detyrën madhore të mbrojtjes së nderit të familjes, kryerjes së obligimeve familjare, bartjes me durim të natyrës së tyre, të gjitha llojeve të shqetësimeve të tyre me përpjekjet për t'u përmirësuar, drejtimin e tyre në rrugë të fesë dhe dhënies rëndësi edukimit të fëmijëve. Të gjitha këto veprime janë shumë të rëndësishme dhe punë më vlera të larta, sepse në to ka nder, mbrojtje, kujdestari, dhe afërsi. Ruajtja dhe veprimi me drejtësi ndaj fëmijëve dhe familjes është

Resulallahu s.a.v.s., - vetëm se mua më ka ndihmuar Allahu kundër tij, prandaj e ka pranuar Islamin, dhe më urdhëron vetëm të mira”.

respektim i të drejtave të tyre. Respektimi i drejtësisë ka vlerë shumë të madhe. Prej kësaj largohet vetëm i papërgjegjshmi. Përndryshe, Resulallahu s.a.v.s. thotë:

“Një ditë udhëheqje me drejtësi, është më e vlefshme (e hairit) se shtatëdhjetë vjet ibadet nafie.”⁴⁰

Pas kësaj ka thënë:

“Dëgjoni me vëmendje, të gjithë ju jeni barinj dhe të gjithë jeni përgjegjës për kopenë tuaj.”⁴¹

Ai i cili është i preokupuar me përmirësimin e vetes dhe të tjerëve, është më i vlefshëm se ai i cili i është dedikuar vetëm përmirësimit të vetes. Ngjashëm kësaj, nuk është i njëjtë ai që duron vështirësitë e të tjerëve dhe ai që për askënd nuk mërzhitet dhe jeton në qetësi. Ai që mundohet për familjen dhe fëmijët është si ai që lufton për rizanë e Allahut. Për këtë Bishri ka thënë: *“Ahmed ibn Hanbel më ka kaluar në tri aspekte: e njëra nga to është që ai kërkon furnizim hallall, për vete dhe për të tjerët.”*

Resulallahu s.a.v.s. thotë:

“Ajo që njeriu e harxhon në familjen e tij, është sadaka. Gjithsesi se njeriu do të shpërblehet edhe për atë kafshatë që i vë në gojë gruas së tij.”⁴²

⁴⁰ Taberani dhe Bejhaki nga Ibn Abbasi r.a..

⁴¹ Buhari dhe Muslim nga Ibn Omeri r.a..

⁴² Buhari dhe Muslim në transmetim të Ibn Mesud r.a., në këtë mënyrë: “Kur njeriu harxhon diçka në familjen e vet duke llogaritur që Allahu do ta shpërblejë për këtë, ajo i është sadaka.” Të dy gjithashtu shënojnë transmetimin nga Sa’d ibn Ebu Vekkas r.a., në

Dikush i tha një dijetari (alimi):

- *A do të marrim sevap për secilën vepër që e bëjmë, si: namazi, agjërimi, haxhi, zeqati etj?* Dijetari i tha:

- *Ti trego për punët e trimit shpirtëror.*

- *Çka janë ato?* e pyeti njeriu.

- *Fitimi hallall dhe ushqimi i familjes, iu përgjigj dijetari.*

Ibn Mubarek i tha bashkëluftëtarëve të tij gjatë luftës:

- *A dini a ka diçka më të vlefshme se kjo që jemi duke bërë?* U përgjigjën që nuk e dinë, e ai u tha:

- *Njeriu i varfër me familje të madhe, i cili natën ngrihet për të parë fëmijët e tij, e atë që është shpaluar, e mbulon. Atë që ai e bën është më e vlefshme se kjo betejë e jona.*

Resulallahu s.a.v.s., thotë:

“Ai i cili namazet i fal mirë, ka pak pasuri, ka familje të madhe, dhe i cili nuk i përgojon myslimanët, do të jetë me mua bashkë në xhennet (si këta dy gishta).”⁴³

“Allahu vërtet e do fukaranë e ndershëm i cili ka familje të madhe.”⁴⁴

Resulallahu s.a.v.s., gjithashtu ka thënë:

të cilën thuhet: “Çka do që harxhon në familjen tënde, e ke sadaka, bile edhe kafshata që e ngrit te goja për bashkëshorten tënde.”

⁴³ Ebu Ja'la në transmetim të Ebu Seid el-Hudri r.a.

⁴⁴ Ibn Maxhe në transmetim të Imran ibn Husejn r.a.

“Kur të shumohen gjynahet e njeriut , Allah Teala (për ta pastruar nga gjynahet) e sprovon me varfëri.”⁴⁵

Njëri nga paraardhësit e ndershëm thotë:

“Ka disa gjynahe që vetëm brenga për të siguruar mjetet e jetesës për familjen mund t’i zhduk.”

Për këtë flet edhe transmetimi nga Resulallahu s.a.v.s., ku thuhet:

“Nga gjynahet ka të tilla që mund t’i zhduk vetëm brenga për sigurimin e jetës për familjen.”⁴⁶

Resulallahu s.a.v.s., ka thënë:

“Kush i ka tri vajza, i mbanë me ushqim dhe veshje e sillet mirë me to, deri sa Allahu nuk i bën të pavarura nga ai, sigurisht që ai e fiton xhennetin, përpos nëse bën një gjynah që nuk falet.”⁴⁷

Ibn Abbas, pasi përmendte këtë hadith, thoshte:

“Vallahi, kjo është një nga hadithet që të bën të mendosh.”

Transmetohet se njëri nga të devotshmit sillej mirë me gruan e tij deri në vdekjen e saj, pas të cilës iu ofrua martesë, të cilën ai e refuzoi duke e përcjellë me fjalët:

⁴⁵ Ahmedi në transmetim të Aishes r.a.

⁴⁶ Taberani në **‘Evsat’**, Ebu Nuajm në **‘Hilje’** dhe Hatib në **‘Telhis’** nga Ebu Hurejre r.a..

⁴⁷ Haraiti në **‘Mekarimul-Ahlak’** në transmetim të Ibn Abbasit r.a.. edhe Ebu Davudi dhe Tirmidhiu në transmetim të Ebu Seid r.a.: ***“Kush i ushqen tri vajza, i rrit dhe i marton dhe sillet mirë me to, i takon xhenneti.”***

“Jo. Vetmia është më e mirë për mua. Koncentrohem më mirë dhe arrij qetësinë.”

Pas kësaj, tregohet të ketë thënë:

“Kam ëndërruar një javë pas vdekjes së bashkëshortes sikur u hapën dyert e qiellit dhe sikur njerëzit duke fluturuar në ajër zbritnin në tokë dhe duke kaluar pranë meje thoshin: ‘Ja, ky është ai njeriu i keq’. U frikësova nga kjo, deri sa nuk kaloi pranë meje i fundit nga ta, që ishte një djalë i ri. Atë e pyeta: ‘Për kë e kanë fjalën?’ I riu më tha: ‘Je ti, sepse veprat tua i kemi shënuar në mesin e veprave të luftëtarëve në rrugën e Allahut, por para një jave na është urdhëruar t’i vendosim në mesin e veprave të atyre që mungojnë nga fushëbeteja, e nuk e dimë çfarë ke bërë.’ Kur u zgjova, thashë: ‘Më marton!’”, dhe gjithmonë kishte dy ose tri gra.

Në tregimet e Pejgamberëve a.s. thuhet se Junusit a.s. i erdhën mysafirë disa njerëz. Derisa Junusi a.s., u sillte atyre ushqim duke hyrë dhe dalë nga kuzhina, gruaja vazhdimisht e shqetësonte, e ai vetëm heshtte, kështu që mysafirët u habitën nga kjo, e ai u tha: *“Mos u habitni! E kam lutur Allahun Teala me fjalët:*

-‘O Rabbi im, me çka do të më mundosh në ahiret ma shpejto në këtë botë.’ Ai më tha:

-Mundim do ta kesh vajzën e filanit, kështu që martohu me të!’ Unë jam martuar me të dhe durueshëm i qëndroja saj që e shihni se bën.”

Në të qëndruarit me durim të asaj që u cek më lartë qëndron edukimi i vetes (nefsit), thyerja e zemërimit dhe përmirësimi i moralit. Tek ai që izolohet

ose shoqërohet me besimtarët e devotshëm nuk bëhet e qartë fytyra e brendshme, sepse atij nuk i dalin në shesh sëmundja e zemrës dhe mangësitë e brendshme; ato i mbesin të fshehta.

Prandaj është obligim për atë që shkon rrugës së ahiretit, që me gjëra të cilat njeriun e shtyjnë në lëvizje, që e bëjnë të zemërohet dhe me mjete të ngjashme, ta testojë veten, që të jetë me shprehi të mira; me mësimin e durimit në këto mërzitje dhe vështirësi, të pastrojë të brendshmen prej cilësive të këqija. Në radhë të parë, durimi ndaj familjes, vetëkontrolli i instinkteve dhe përpjekja, angazhimi për sigurimin e mjeteve të jetesës së tyre, janë një ibadet i veçantë.

Kjo është gjithashtu një nga dobritë e martesës, por prej kësaj mund të përfitojnë vetëm dy lloje njerëzish:

1) Personi që ka për qëllim luftën kundër epsheve dhe zbukurimin e ahlakut (moralit), sepse ky person është në fillim të udhëtimit shpirtëror dhe është shumë reale që ai këtë ta sheh si mënyrë të luftës kundër epshit dhe kështu të edukoj veten;

2) Besimtari i cili ende nuk udhëton nëpër brendësinë e tij, e as që i kthehet mendimeve, apo zemrës, por gjithçka reduktohet në lëvizje trupore - në namaz, haxh etj. Aktiviteti i tij rreth familjes dhe fëmijëve me furnizim të ndershëm për ta dhe edukimin e tyre i është më i vlefshëm se ibadeti nafie, sepse nga ibadetet nafie përfiton vetëm ai, e të mirat e tyre nuk kalojnë te të tjerët. Nga kjo pikëpamje, ky njeri është i hairit. Por, ai që është nga krijimi me ahlak të bukur ose që ka zbukuruar ahlakun me anë të luftës siç u tregua më lartë, që vazhdon në rrugëtim shpirtëror dhe

mendjen e zemrën i ka në lëvizje nëpër dituritë e zbulimit të fshehtësisë, nuk ka nevojë të martohet për këtë qëllim. Sepse vetëkontrolli i dëshirave nuk lë nevojë për martesë. Nga veprimet e një personi të tillë, përfitojnë të mira më shumë njerëz, dhe dobia është më e përgjithshme, se sa nga furnizimi për familje.

Këto janë dobitë e martesës nga pikëpamja fetare dhe shkaqet pse është thënë që martesë ka vlerë e rëndësishme.

DËMET E MARTESËS

Ekzistojnë tri dëme të martesës.

Dëmi i parë i martesës, e njëherazi edhe dëmi më i madh është pamundësia e fitimit hallall. Kjo nuk është një gjë e lehtë për secilin, sidomos në këto kohë (Hixhri 495), kur mënyra e jetesës është trazuar, kështu që për të siguruar mjetet e jetesës për familjen është bërë detyrim për kërkim të fitimit më të madh, dhe për këtë njeriu detyrohet të hyjë në mashtrim. Fiton haram, fëmijët i ushqen me haram, në çka është shkatërrimi i tij dhe i fëmijëve të tij. Kurse personi i pamartuar nuk hyn në këto punë, sepse për veten kujdeset më lehtë. E i martuari, në të shumtën e rasteve lëshohet në punë jolegale, duke dashur të realizojë dëshirat e gruas, sakrifikon ahiretin për dynjallëk.

Në transmetim thuhet:

“Njeriu do të ndalohet para peshores në ditën e kiametit, e veprat e mira do t’i ketë si kodër, dhe do të

pyetët për atë se sa është kujdesur për familjen e vet dhe si i ka kryer obligimet ndaj saj, për pasurinë e tij; si e fitoi dhe në çka e harxhoi, deri sa në këto kërkime të futen të gjitha veprat e tij, dhe nuk i mbetet asnjë vepër e mirë, pas së cilës melaiket do të shprehen: *‘Ky është ai të cilit familja në dynjallëk ia hëngri veprat e tij të mira dhe i cili sot ngelet peng.’*⁴⁸

Thonë se në Ditën e Gjykimit, për njeriun së pari do të jenë kundërshtarë familja dhe fëmijët e tij, do ta ndalin para Allahut Teala dhe do të thonë:

- *Rabbi jonë, merr nga ai të drejtën tonë, ne nuk kemi ditur, na ka ushqyer me haram.*

Pastaj duke marrë të drejtat e tyre prej tij, do t’ua dorëzojë ato atyre.

Dikush nga paraardhësit e ndershëm thotë:

- *Kur Allahu i do robit të tij të keqen, i jep në këtë botë dhëmballë që kafshojnë, d.m.th. një këso familje.*

Resulallahu s.a.v.s. thotë:

“Askush nuk do të takohet me Allahun Teala me gjynah më të madh, se sa ai që ka lënë familjen e vet të paditur.”⁴⁹

Kjo është një sëmundje e përgjithshme, dhe të paktë janë ata që janë të shpëtuar nga kjo, përpos atij që ka trashëgimi ose fitim hallall e cila i mjafton atij dhe familjes së tij, dhe ai nuk kërkon më shumë. Vetëm të

⁴⁸ Nuk është gjetur burimi i hadithit.

⁴⁹ E përmend autori i **‘el-Firdevs’** në transmetim nga Ebu Seid r.a.

tillët i shpëtojnë kësaj sëmundje. Shpëton edhe ai i cili është i aftë të fitojë më shumë me art, apo me gjueti, ose ka një punë që nuk është në lidhje me pushtet-mbajtësit, ose është në gjendje të punojë me të ndershmit, fitimi i të cilëve është hallall.

Ibn Salim ka thënë, pasi është pyetur për martesën: *“Në këto kohërat tona martesë është më e mirë për atë të cilin e ka kapluar epsh i madh sikur gomari kur sheh gomaricën e nuk mund të ndahet nga ajo as me dajak, sepse i tilli nuk mund të përmbahet, megjithatë, nëse mund të kontrollohet, më mirë është të mos martohet.”*

Dëmi i dytë i martesës është pamundësia e kryerjes së obligimeve ndaj gruas, durimi temperamentit dhe shqetësimeve të saj. Kjo mangësi është e një vëllimi më të ngushtë se e para, sepse nevojitet më pak aftësi për ta përmbushur, se sa në rastin e parë. Të pasurit marrëdhënie të mirë me gruan dhe kryerja e obligimeve ndaj tyre është më e lehtë se sa të gjendet fitimi hallall, por në këtë ka rrezik, sepse ai është bari dhe është përgjegjës për kopenë e vet. Resulallahu s.a.v.s. thotë:

“Njeriu ka mjaft gjynahe nëse shpërfill ata për të cilët kujdeset.”⁵⁰

Transmetohet se ai që ik nga familja e tij është në shkallën e skllavit të ikur të cilit nuk i pranohet namazi as agjërimi deri sa nuk kthehet te zotëria.

⁵⁰ Ebu Davud dhe Nesai nga Abdullah bin Amarit. Te Muslimi shënohet me formulim tjetër.

Kush nuk i kryen obligimet ndaj tyre, edhe nëse është me ta, është në shkallë me atë që ka ikur. Allah Teala thotë:

“...Ruani veten dhe familjet tuaja nga zjarri...”

66 -Tahrim:6

Na ka urdhëruar t'i ruajmë nga zjarri, siç e ruajmë edhe veten. Njeriu nganjëherë nuk është në gjendje ta ruajë veten, e kur të martohet, atëherë obligimet i dyfishohen. Pranë vetes atëherë ka edhe një nefsi, e nefsi anon kah e keqja, e kur janë më shumë, atëherë animi kah e keqja është më i madh. Kjo ndodh në të shumtën e rasteve, dhe për këtë disa kanë heqë dorë nga martesë duke thënë: *“Jam në sprovë me nefsin tim, e si t'ia shtoj atij edhe një?”* Në këtë kuptim, dikush pat thënë:

*Vrima e miut është aq e vogël sa nuk e zë atë,
e miu ka lidhur edhe fshesën për bishti.*

Kështu edhe Ibrahim ibn Ed'hem përmbahej nga martesë duke thënë:

- *Nuk ndiej nevojë për grua, e nuk do të doja ta poshtëroj asnjërin nga to, d.m.th., duhet të kryej obligimet ndaj tyre, t'i mbroj, t'i kënaq, dhe unë këtë nuk mundem.*

Në të njëjtën mënyrë ngurronte edhe Bishri, i cili ka thënë:

- *Vetëm fjalët e Allahut Teala: “Gratë kanë aq të drejta sa kanë edhe detyra..”.(2-Bekare:228) më pengojnë të martohem.”*

Ai gjithashtu ka thënë:

- *Po të isha përgjegjës për një pulë, do të frikësohesha mos bëhem kasap në urë.*

Dikush e pa Sufjan ibn Ujejne para portës së sundimtarit, dhe i tha:

- *Kjo portë nuk ishte vendi yt, si erdhe në këtë portë?* Ai iu përgjigj:

- *A ke parë që njeriu me familje të madhe të ketë gjetur shpëtim?!*

Sufjani shpesh thoshte:

- *Sa e bukur është beqaria, me një çelës të shtëpisë, ku dëgjohet vetëm zëri i erës duke fryrë.*

Kjo është gjithashtu një fatkeqësi e përgjithshme, ani pse është e një vëllimi më të ngushtë se sa e para. Nga kjo gjen shpëtim vetëm personi që posedon urtësi dhe zgjuarsi, me natyrë të mirë, mirë i njoftuar me adetet e grave, i cili me durim përballon gjuhën e tyre, mbahet që të mos përcjellë trillet e tyre, i vendosur të plotësojë obligimet e veta ndaj tyre, i cili shpërfill gabimet e tyre dhe arsyeshëm i bën lajka natyrës së tyre. Ndërsa, njerëzit janë kryesisht pa dituri, kokëzbrazët, të ashpër, të pasjellshëm, të pamatur, me karakter të keq dhe të padrejtë, edhe pse nga të tjerët kërkojnë drejtësi të plotë. Personi i tillë, me martesë

pashmangshëm bën çrregullime edhe më shumë. Prandaj, vetmia për të tillët është shumë më e sigurt dhe është rrugëdalje.

Dëmi i tretë i martesës është më pak i rrezikshëm se sa dy të përmendurat më herët. E kjo është që të mbledh më shumë pasuri që të sigurojë jetë komode për familjen dhe për ta shfaqur (këtë pasuri), si dhe për t'u lavdëruar me shumë me fëmijët, e duke i anuar kësaj bote - largohet nga ibadetet. Familja, fëmijët, prona dhe gjithçka tjetër që e largon njeriun nga ibadetet, janë fatkeqësia e tij. Me këtë nuk e kam fjalën që ata (familja) e thërrasin në të ndaluarën, që bie nën kornizat e mangësisë së parë dhe të dytë, mirëpo që e thërrasin të kënaqet në atë që është e lejuar. Përkushtimi ndaj intimitetit dhe lojës me gra, teprimi në kënaqje me to, e përmes martesës vjen deri te shumë aktivitete të tilla, preokupon zemrën, dhe njeriu kalon ditë dhe natë duke mos menduar për t'u përkushtuar aspak mendimit për ahiretin dhe nuk përgatitet për të.

Për këtë shkak Ibrahim ibn Ed'hem, Allahu e mëshiroftë, ka thënë:

"Nuk ka asgjë nga ai i cili u është përkushtuar kofshëve të grave", deri sa Ebu Sulejman, Allahu e mëshiroftë edhe atë, ka thënë:

"Kush martohet, ai është përkulur kah kjo botë", d.m.th. kjo e thërret në përkulje kësaj bote.

Këto ishin dëmet dhe dobitë kryesore të martesës.

Përfundim: të merret vendim absolut lidhur me atë se a është më mirë për një person të martohet apo të

mos hyj në martesë, do të thotë të mos jesh i njoftuar me të gjitha këto detaje. Më saktë, këto dobi dhe dëme duhet t'i merr parasysh udhëtari i ahiretit, dhe në bazë të tyre të merr vendim. Ai që dëshiron të martohet do të jetë subjekt i kësaj (analize), dhe nëse te ai nuk ekziston rreziku për dëmet e përmendura, kurse ekzistojnë dobitë e martesës, në atë mënyrë që të ketë burim hallall të të ardhurave, sjellje të mirë, angazhim të plotë në fe dhe që martesë nuk do ta largojë nga Allah Teala, dhe bashkë me të gjitha këto është i ri të cilit i nevojitet të qetësojë epshin e vet, i vetmuar i cili ka nevojë për udhëheqjen e shtëpisë dhe mbrojtjen e të afërmeve, nuk ka dilemë se në atë rast është më mirë të martohet, sidomos bashkë me përpjekjet për të pasur fëmijë.

Nëse dobitë e martesës mungojnë, kurse ekzistojnë mangësitë të cilat i kemi përmendur, atëherë e ka më mirë të mos martohet.

Ndërsa, nëse të dy anët janë të barabarta, e që në shumicën e rasteve edhe janë, atëherë është e nevojshme që objektivisht të matet kontributi i atyre dobive në rritjen e besimit të tij, respektivisht kontributi i dëmeve të martesës në zvogëlimin e (besimit të) tij. Dhe me këtë krahasim, cilën anë e preferon - me atë të merret vendimi. Dobitë më evidente të martesës janë fëmija dhe qetësimi i epshit, kurse dëmet më të dukshme të martesës janë tërheqja në fitim haram dhe ngelja mbrapa në ibadete.

Tani, të krahasojmë këto të dy anë:

Për shembull: nëse njeriun nuk e trazojnë epshet dhe qëllimi i martesës është vetëm për të pasur fëmijë, por për këtë detyrohet në fitim haram dhe largim nga ibadetet ndaj Allahut - më mirë është të mbetet beqar. Nga largimi prej adhurimit dhe fitimit haram nuk ka hair. Mangësitë e këtyre të dyjave nuk mund t'i kompensojë fëmija; martesa për shkak të fëmijës është ëndrra për realizimin e jetës së fëmijës. Mbrojtja e jetës së vet dhe ruajtja nga shkatërrimi është më e rëndësishme se ëndërrimi për të pasur fëmijë. Sepse fëmija është pasuri sikur fitimi në tregti, kurse feja është pasuria më e madhe.

Në prishjen e fesë ka prishje të jetës së ahiretit dhe humbje të pasurisë së saj, dhe kjo vlerë nuk mund të matet me asnjërën nga këto dy mangësi të martesës. Por, kur qëllimit për të pasur fëmijë i shtohet edhe nevoja për shuarjen e epshit, atëherë shikohet -nëse frenat e devotshmërisë nuk i ka mjaft të forta për ta ndalur epshin dhe frikësohet se do të bëjë ziná, atëherë preferohet martesa. Kjo sepse ky person është karshi zinásë dhe rrezikut për fitim haram. Për këtë arsye e preferon dëmin më të vogël, që është fitimi i dyshimtë.

Nëse është i sigurt në vete se nuk do të bëjë ziná, por përkundër kësaj nuk mund të ndal shikimin nga harami, më mirë e ka të mos martohet, sepse është e vërtetë që shikimi i tillë është haram, siç është haram edhe fitimi në mënyrë të padrejtë, megjithatë, fitimi është konstant dhe në të është gjynahu i tij dhe i

familjes së tij, derisa shikimi ndodh kohë pas kohe, ka të bëjë vetëm me të dhe shpejt kalon.

Shikimi është ziná e syrit, por nëse zemra e refuzon dhe nuk e pranon, do të jetë më afër faljes, se sa ushqimi haram. Përveç në rastin kur frikësohet që shikimi të mos qojë në ziná, atëherë e preferon martesën.

Pasi që kjo është kuptuar, ta shikojmë mënyrën e tretë; e ajo është ruajtja e shikimit nga e ndalura, por jo domosdo edhe largimi mendimeve të cilat ia pushtojnë zemrën.

Mos-martesa e këtij personi është më e përshtatshme, sepse në këtë çështje falja e gabimit të zemrës është më e lehtë se sa falja e veprimeve haram. Për ibadet nevojitet qetësia e zemrës. Ndërsa me fitimin dhe ushqimin haram, dhe me të ushqyerit e të tjerëve me haram, ibadeti nuk është i kompletuar.

Kështu duhet të maten dëmet dhe në përputhje me këtë të merret vendim. Ai që ka kuptuar këto shpjegime, nuk dyshon në transmetimet e përcjella nga paraardhësit e ndershëm në të cilat në një moment inkurajohet në martesë, e në momentin tjetër frenohet nga ajo, sepse të gjitha transmetimet janë sipas gjendjes së atyre personave.

Nëse ti pyet: *“Çka është më e mirë për atë i cili është i sigurt nga dëmet eventuale të martesës, a t’i*

kushtohet ai ibadeteve apo të martohet?’, do të them që këto dy anë duhet bashkuar, sepse martesë si e tillë nuk është pengesë e ibadeteve, por pengesë është domosdoshmëria për të fituar të ardhura. Prandaj, nëse është në gjendje të fitojë hallall, martesë në atë rast i është më e mirë, sepse natën dhe pjesën e mbetur të ditës mund t’ia kushtojë ibadeteve; zaten, bërja ibadet pandalshëm është e pamundur. Nëse thua që një person, për shkak të martesës tërë kohën e kalon duke punuar, kështu që i mbetet kohë vetëm për kryerjen e ibadeteve farz, fjetje, ngrënie dhe kryerje të nevojave fiziologjike, atëherë shikohet; nëse këtij personi i mungojnë namazet vullnetare (nafile), haxhi dhe ibadetet e ngjashme trupore, përsëri më e vlefshme është të martohet. Kjo për shkak se fitimi hallall, kujdesi për nderin e familjes, edukimi i fëmijëve, si dhe durimi i natyrës së gruas janë lloje të ibadeteve, vlera e të cilave nuk është aspak më e vogël se e ibadeteve vullnetare (nafile). Por nëse ibadeti i tij përbëhet nga nxënia e diturisë, mendimit dhe udhëtimit shpirtëror, dhe nëse këtë e pengon fitimi hallall, atëherë e ka më mirë të mos martohet.

Nëse pyet “*Pasi që martesë ka aq vlera të larta, pse Isa a.s., nuk është martuar, e nëse është më e vlefshme t’i përkushtohemi ibadeteve, pse Pejgamberi jonë, Muhammedi s.a.v.s. ka pasur aq shumë gra?*”, atëherë ta dish se për atë, fuqia e të cilit është e madhe dhe energjia shpirtërore është posaçërisht e shprehur, dhe asgjë nuk mund ta pengojë nga Allah Teala, më me vlerë të lartë është të bëjë të dyja. Pasi që Pejgamberi jonë

s.a.v.s., ishte i fuqishëm në këtë, ai i ka bashkuar vlerat e ibadetit dhe martesës, dhe kështu, me nëntë gra, ka qenë së bashku me Allahun Teala dhe ka vazhduar në ibadet. Atij, përmbushja e nevojave të martesës nuk i ka qenë pengesë në vazhdimin e ibadetit, sikur që ata të cilët merren me planifikimin e punëve të kësaj bote, kryerja e nevojave nuk do t'i pengojë në atë planifikim, kështu që ata në dukje janë të preokupuar me kryerjen e nevojës, por zemrat i kanë të mbushura me mendime, dhe nuk janë ndarë nga detyrat e veta. Resulallahut s.a.v.s., për shkak të lartësisë së pozitës së tij, kjo botë nuk i ka penguar që zemra t'i jetë së bashku me Allahun Teala sa edhe shpalljet do t'i vinin deri sa ishte në shtratin e gruas. Por, nuk është e drejtë të krahasohen të tjerët me Resulallahun s.a.v.s..

Ndërsa Isa a.s., duke treguar modesti ka preferuar anën e kujdesit. Nëse do të martohej, ndoshta do ta preokuponte familja, ose do të mendohej me sigurimin e jetës hallall. Për këtë e preferoi ibadetin. Ata më mirë i dinë gjendjet të veta, kohën që nevojitet për fitim hallall, natyrën e gruas, dobitë e martesës dhe dëmet e martesës. Meqenëse gjendjet janë të ndryshme, ashtu që në kohëra të caktuara është më mirë të jetohet në martesë, e nganjëherë prapë – më e mirë është beqaria, obligimi jonë është që veprimet e Pejgamberëve a.s., sido që të jetë, t'i pranojmë si më të mirat, e Allahu e di më së miri.

Kapitulli i Dytë

GJENDJA E GRUAS DHE KUSHTET E LIDHJES MARTESORE - KURORËZIMIT

LIDHJA MARTESORE-KURORA

Në mënyrë që të bëhet lidhja martesore (*el-akd*) dhe që ajo të jetë e vlefshme, ekzistojnë katër kushte (*sharte*), respektivisht katër pjesët e saj përbërëse (*rukna*):

1. Leja e përfaqësuesit, e nëse nuk ka përfaqësues, atëherë leja nga udhëheqësi i ummetit;⁵¹

2. Pranimi i vajzës nëse është e moshës madhore, qoftë vejushë apo jo, kur e marton dikush tjetër përpos babait ose gjyshit të saj.

3. Prania e dy dëshmitarëve të drejtë;

4. Oferta për martesë dhe pranimi i martesës, me përdorimin e shprehjeve të cilat qartë e theksojnë këtë (p.sh. ana e mashkullit thotë “*e marr për grua*” dhe ana e femrës thotë “*pranoj*”), ose cila do shprehje tjetër adekuate në cilën do gjuhë.

⁵¹ Në medh’hebin Hanefi leja nga përfaqësuesi nuk është kusht për martesë, sepse, sipas tyre, edhe vet gruaja mund të martohet.

Sipas medh'hebit Shafi, përfaqësuesit e asnjërës palë, nuk mund të jenë femra. Sipas hanefive, gruaja mund të bëjë lidhjen e kurorëzimit direkt, pa përfaqësues.

Rregulli kurorëzimit është që asaj t'i paraprijë fejesa e kontraktuar me kujdestarin e vajzës (*hitba*), por jo në kohën e pritjes së saj pas-martësore (*iddet*⁵²), e as në situatën kur vajza është kërkuar nga tjetri, sepse fejesa me personin që është kërkuar nga tjetri është e ndaluar. Një sjellje e tillë nuk është e sinqertë.

Para aktit të kurorëzimit, është e lavdërueshme të fillohet me falënderim Allahut Teala dhe me fjalim të shkurtë (*hutba*), kurse personi që marton vajzën do të thotë: "*Falënderoj Allahun, dhe salavat të Dërguarit të Allahut, ta jap për grua vajzën time* (Emri i saj)", kurse dhëndri, ose përfaqësuesi i tij, do të thotë: "*Falënderoj Allahun, dhe salavat të Dërguarit të Allahut, e pranoj martesën me të përmes kësaj dhurate të martesës*". Dhurata e detyrueshme e martesës (*mehër*) le të jetë e njohur dhe modeste.

Rregull i sjelljes së mirë është gjithashtu që nusja të merr informata për dhëndrin. Kjo është më me vend, dhe më lehtë arrihet afrimi mes tyre. Për këtë është e lavdërueshme që edhe dhëndri ta shoh nusen para martesës, sepse kështu më lehtë vendoset harmonia mes tyre.

⁵²**Iddet:** periudha kohore pas vdekjes së burrit ose shkurorëzimit, gjatë së cilës gruaja nuk mund të martohet. Ajo zgjat 130 ditë pas vdekjes së burrit dhe 100 ditë pas ndarjes-shkurorëzimit.

Gjithashtu është e lavdërueshme që të mblidhet një numër më i madh i njerëzve të mirë, krahas dy dëshmitarëve të cilët janë themeli i vlefshmërisë së martesës, si edhe që me martesë të tregohet qëllimi (nijeti) i përshtatjes sunnetit, ndalja e shikimeve, kërkimi i pasardhësve dhe dobitë tjera të cilat i kemi përmendur, dhe që qëllim të mos i jetë vetëm epshi dhe kënaqësia, e që martesë t'i jetë vetëm aktivitet i kësaj bote. Kjo nuk i pengon qëllimet e tilla, sepse shumica e obligimeve përshtaten me kërkesat.

Omer ibn Abdulaziz, Allahu e mëshiroftë, thoshte:

-- *Kur obligimi përshtatet me kërkesat, kjo është kajmak me hurmë.*

Nuk është kundërshti që dikush të jetë i motivuar në të njëjtën kohë edhe me epsh edhe me plotësimin e obligimeve fetare.

Është mirë që martesë të mbahet në mesxhid dhe në muajin Sheval. Aisha r.a., ka thënë: *“Pejgamberi s.a.v.s. më ka kurorëzuar në Sheval, dhe në këtë muaj më mori në shtëpi.”*⁵³

Te nusja duhet marrë parasysh dy lloje të vetive: njëri lloj janë të rëndësishme për lejim të martesës, e lloji i dytë për jetë në harmoni dhe arritje të qëllimeve.

⁵³ Muslim

Lloji i parë janë ato që kanë të bëjnë me lejimin e martesës, e kjo do të thotë që nuk ekzistojnë pengesa për martesë. Ekzistojnë nëntëmbëdhjetë pengesa për martesë:

1. Të jetë e martuar me tjetrin;
2. Të jetë në pritje pas-martesorë (*iddet*) nga burri tjetër, pa marrë parasysh a është iddeti për shkak të vdekjes së burrit, ndërprerjes së njëanshme të marrëdhënies martesore (*talak*), ose është si skllave në periudhën e pritjes së lirit;
3. Të jetë e larguar nga feja ashtu që thotë ndonjë fjalë të pabesimit;
4. Të jetë adhuresë e zjarrit (këtyre u thuhet *mexhusi*);
5. Të jetë idhujtar ose ateiste, të mos jetë e lidhur me asnjërin nga Pejgamberët, ose Librat e Shpallur. Në mesin e tyre janë edhe ato që nuk kanë kurrfarë ndalesash. Me të tillat nuk është e lejuar martesë. I njëjtë është rasti me secilën që beson në drejtim të tillë që bindjet e saj konsiderohen kufër.
6. Të jetë përcjellëse e Librit që predikon fenë e tyre, pasi që ajo është ndërruar, ose pas dërgimit të Pejgamberit s.a.v.s., e pos kësaj nuk është nga loza e Israilit. Nëse mungojnë të dy veçoritë, nuk është e lejuar martesë me të. E nëse vetëm nuk është nga loza e përmendur, atëherë mendimet janë të ndara.
7. Të jetë skllave, kurse mashkulli është i lirë dhe i aftë të martohet me grua të lirë, dhe nuk frikësohet që do të bjerë në ziná; d.m.th. mashkulli që ka mundësi të

marrë një grua të lirë dhe pas martesës është i sigurt që nuk bën ziná, nuk mund të martohet me skllave.

8. Nuk mund të martohet me skllaven (shërbëtoreshen) që posedon;

9. Të jetë në farefisni-lidhjet me gjak; pra me nënat, gjyshet, vajzat e prindërve, me vajzën e vet, vajzën e fëmijëve, vajzën e motrave dhe vëllezërve, me hallat dhe me tezet, martesë është haram. Por, me vajzat e axhës, dajës, hallës dhe tezës, mund të martohet.

10. Lidhjet e krijuara me gji-dhënie. Çka është haram në lidhjet me gjak, është haram edhe në lidhjet me qumësht. Por, për t'u vendosur lidhja vëllazërore me qumësht, duhet të ekzistojnë së paku pesë gji-dhënie për dy vitet e para të jetës;

11. T'i jetë e ndaluar me miqësi. Nëse ka kurorë me një femër dhe shkurorëzohet pa pasur marrëdhënie, mund të kurorëzohet me vajzën e saj. Por, nëse ka kurorë me një vajzë, dhe shkurorëzohet, edhe nëse nuk ka pasur marrëdhënie, nuk mund të kurorëzojë nënën e saj. Ose në rast se me të zgjedhurën e tij më parë është martuar babai ose djali i tij;

12. T'i jetë gruaja e pestë, pra që përpos saj të jetë i martuar edhe me katër tjera,

13. Që mashkulli të jetë tashmë i martuar dhe dëshiron të merr motrën e gruas. Kjo vlen edhe për tezen dhe hallën e saj, nuk do të mund t'i martojë. Por nëse shkurorëzohet, mund të martohet me motrën ose tezen e saj.

14. Që ma përpara e ka shkurorëzuar me tre talakë. Ajo nuk i është e lejuar deri sa të ketë lidhje martesore me burrë tjetër në martesë me vlefshmëri ligjore.

15. Që dhëndri ta ketë mallkuar pasi që e ka akuzuar për shkelje kurore. Ajo i është e ndaluar atij përgjithmonë pas mallkimit të ndërsjellë (*lian*);

16. Të jetë në ihram për shkak të haxhit ose umres, ose burri të jetë në gjendje të tillë, munden të martohen vetëm pasi të dalin nga ihrami;

17. Të jetë minore e dhunuar. Martesa e saj është ligjore vetëm pasi të ketë arritur moshën madhore.

18. Të jetë jetime. Martesa e saj, gjithashtu, është e vlefshme vetëm pasi që ajo të jetë e moshës madhore;

19. Të jetë njëra nga gratë e Pejgamberit s.a.v.s., që kanë mbetur pas vdekjes së tij dhe me të cilat ai ka pasur marrëdhënie martesore. Ato janë nënat e besimdrejtëve. Zaten, një gjë e tillë nuk mundet të mendohet në kohërat tona.

Këto janë ndalesat për martesë.

Cilësitë që kërkohen te femra

Cilësitë që përmirësojnë jetën dhe në të cilat duhet pasur kujdes se a ekzistojnë te gruaja, në mënyrë që lidhja martesore të jetë e vlefshme dhe të plotësojë qëllimet e veta, janë tetë:

1. Cilësia e parë është të jetë person i mirë dhe besimtar. Kjo është baza, dhe në këtë duhet pasur kujdes. Sepse, po të jetë e besimit të dobët në ruajtjen e vetes dhe organit të vet seksual, ajo do të turpërojë bashkëshortin e vet, do t'ia ulë reputacionin në mesin e njerëzve, do t'ia mbush zemrën me xheloz, dhe me këtë do t'ia vështirësojë jetën. Nëse burri mundohet ta ruajë ndershmërinë, do të jetë në vuajtje dhe sprovë, e nëse ndaj kësaj do të jetë tolerant, me këtë tregon mospërfilljen e vet për fenë dhe nderin, dhe do të njihet si person tradhtar. Nëse bashkë me besimin e dobët, për sherr ajo është edhe e bukur, belaja dyfishohet, sepse për burrin do të jetë e vështirë të ndahet nga ajo, duke qenë se pa të nuk mund të durojë, e nuk mund të durojë as me të. Do të zvarritet nga fatkeqësia në fatkeqësi. Do të jetë sikur ai që kishte shkuar te Pejgamberi s.a.v.s., duke i thënë:

- *O i Dërguari i Allahut, kam një grua e cila nuk refuzon dorë që e prekë.* Pejgamberi s.a.v.s., i tha:

- **Ndaj nga ajo!** Ai, atëherë tha:

- *Por unë e dua!* Pejgamberi s.a.v.s., tha:

- **Atëherë ruaje!**⁵⁴

⁵⁴ Ebu Davud, Nesai dhe Tirmidhiu në transmetim nga Ibn Abbas r.a...

Urdhri që ta ruaj është duke u bazuar në atë që ndoshta më vonë gruaja do të përmirësohet edhe në frikën që, nëse ndahet- do t'i shkojë pas, dhe kështu do të bëjë ziná.

Nëse besimi i saj i dobët pasqyrohet në shkatërrimin e pronës ose në diçka tjetër, përsëri nuk do të ketë qetësi në atë martesë. Nëse hesht dhe nuk e dënon, atëherë është bashkëpunëtor në vepër dhe punon në kundërshtim me fjalët e Allahut Teala:“... **veten dhe familjet tua ruani nga zjarri...**”66-Tahrim:6, e nëse nuk pranon dhe hyn në drejtimin e saj, atëherë me përplasje e mjeron jetën. Pikërisht për këtë Resulallahu s.a.v.s., aq shumë insiston në besimtare kur thotë:

“Vajza martohet për shkak të pasurisë, bukurisë, reputacionit dhe besimit. Merre besimtaren, Allahu të ka dhënë të mirën!”⁵⁵

Resulallahu s.a.v.s. thotë:

“Kush martohet me një vajzë për shkak të pronës dhe bukurisë së saj, do të mbetet pa këtë pronë dhe bukuri (nuk ia sheh hairin), e kush martohet për shkak të fesë, Allahu do ta pajis edhe me pronë edhe bukuri.”⁵⁶

“Mos u marto me një vajzë për shkak të bukurisë së saj, sepse, ndoshta, bukuria e saj do ta dërgojë në shkatërrim, as për pasuri (pronën) e saj, sepse, ka rrezik që pasuria e bën atë mendjemadhe, por martohu me një vajzë për shkak të besimit së saj.”⁵⁷

⁵⁵ Buhar dhe Muslim në transmetim nga Ebu Hurejre r.a.

⁵⁶ E përmend Taberani në **“Evsat”** në transmetim nga Enesi r.a., dhe Ibn Hibban në **‘Duafa’**.

⁵⁷ Ibn Maxhe në transmetim nga Abdullah ibn Omeri r.a.

Posaçërisht ka inkurajuar në besim, sepse gruaja e tillë është ndihmesë në besim, e nëse gruaja nuk është besimtare, atëherë largon nga besimi dhe e pengon atë.

2. *Cilësia e dytë është natyra (ahlak)e mirë.* Kjo është një bazë me rëndësi në lehtësim dhe është ndihmesë në fe, sepse nëse është e pafytyrë, vulgare, me natyrë idhnake, jo-falënderuese për mirësitë, nga ajo dëmi është më i madh se sa dobia. Me fjalët bosh të gruas, evliatë sprovohen në durim.

Arabët nuk preferojnë martesën me këto gra:

a) *Ennane* – ajo që vajton, rënkon pandërprerë, vazhdimisht ankohet, dhe i lidh vetes kokën nga nervozizmi. Ngjashëm kësaj, nga ajo që sëmuret shpesh ose e cila shtiret si e sëmure nuk ka hair.

b) *Mennane* – ajo e cila thotë: “*Unë kështu, unë ashtu...*”, duke ia gërryer kokën burrit. Edhe kjo e pengon dashurinë mes burrit dhe gruas.

c) *Hannane* – ajo e cila digjet për burrin e mëparshëm ose për fëmijën nga ai burrë. Edhe kësaj duhet larguar.

d) *Hadaka* – ajo e cila hedh syrin në gjithçka dhe i dëshiron ato, duke e obliguar burrin që t’ia blejë.

e) *Berrakah* – përfshinë dy kuptime. I pari është që gjithë ditën e kalon në lëmimin dhe zbukurimin e fytyrës së saj, që fytyra t’i ketë shkëlqim që është arritur artificialisht. Kuptimi i dytë është që nuk e do ushqimin dhe han ekskluzivisht vetëm. E ndanë pjesën e saj në gjithçka.

f) *Sheddaka* – ajo e cila flet shumë, që të duket e edukuar; duke folur shtrembëron dhe dredh gjuhën. Nga aty edhe fjalët e Pejgamberit s.a.v.s. i cili thotë:

“Allah Teala, vërtet nuk i do ata që mundohen të flasin duke shtrembëruar dhe dredhur gjuhën.”⁵⁸

Flitet se Saihu’l-Ezdi, në njërin nga udhëtimet e tij ka takuar Ilijasin a.s., i cili e këshilloi të martohet duke thënë: *“Martesa është më mirë se beqaria”*. Pas kësaj i tha: *“Por me katër mos u marto: me muhtelië, me mubarije, me ahire dhe nashize.”*

Muhtelia – ajo e cila pa arsye në secilin moment kërkon shkurorëzim;

Mubarija – ajo e cila ka veten në huj dhe mburret karshi të tjerëve;

Ahira – mëkatarja e cila është e njohur për dashnorët dhe partnerët intimë.

Kjo është ajo për të cilën Allah Teala thotë:

“... dhe kur fshehtas nuk jetojnë me dashnorët..”

4-Nisa:25

Nashiza – ajo e cila me vepra dhe fjalë kundërshton burrin. Edhe këtë grua mos e merr.

Alia r.a., ka thënë:

–“Tri veçori janë që te mashkulli janë të këqija, e te femra të mira: të jetë tamahqar, vetëpëlqimi dhe frika. Kur është tamahqare, ajo ruan pasurinë e vet dhe atë të burrit të vet. Nëse ka vetëpëlqim, refuzon që secilit t’i drejtohet me fjalë të dyshimta dhe lajkatare. E nëse është frikacake, ruhet nga gjërat e rrezikshme dhe nuk hyn në vende të dyshimta.”

⁵⁸Tirmidhiu transmeton nga Xhabiri r.a.

Këto thënie tregojnë për normat etike që janë të dëshiruara në martesë.

3. *Cilësia e tretë është bukuria e fytyrës.* Edhe kjo është një veti e rëndësishme që kërkohet. Atij që e ka gruan e bukur, nuk i mbetet syri jashtë. Në përgjithësi, natyra e njeriut nuk e do të shëmtuarën. E, si ta dojë? Në të shumtën e rasteve, ajo që është me fytyrë të bukur, e ka edhe ahlakun/moralin e bukur. Sa mirë do të ishte të jetë edhe fetare edhe e bukur. Duke thënë: *“Merre besimtarin, mos shiko bukurinë”,* ne nuk po themi *“mos e merr të bukurën”*. Ne deshëm të themi: *“Mos u marto vetëm për bukurinë e saj, nëse është jobesimtare”*. Vetëm bukuria, në të shumtën e rasteve, inkurajon në martesë por fenë e lë pas dore. Edhe një dëshmi që shpjegon rëndësinë e zgjedhjes së bukuroshes, është që në marrëdhënie dhe në afërsi bukuria luan rol të madh. Sheriati ka pranuar shkaqet e afrimit të ndershëm, për këtë shkak është e përshtatshme të shihet e zgjedhura. Resulallahu s.a.v.s., thotë:

“Kur Allah Teala jep që dikush nga ju të fillojë të mendojë për martesë me ndonjë femër, le ta shikojë atë, sepse kjo më lehtë sjellë deri te afërsia mes tyre.”⁵⁹

Resulallahu s.a.v.s. thotë:

“Ka të meta në sytë e disa grave ensare. Prandaj, kur dikush nga ju dëshiron të martohet me to, le t’i shikojë.”⁶⁰

⁵⁹ Ibn Maxhe nga Muhammed ibn Mesleme r.a.

⁶⁰ Muslim në transmetim nga Ebu Hurejre r.a..

Në një transmetim thuhet **“Sytë shohin dobët”** dhe në një tjetër transmetim: **“Mund të jenë me sy të hollë dhe të vegjël. Për këtë arsye, kush dëshiron të martohet me to, le t’i shikon.”**

Disa besimtarë të devotshëm nuk do t’i martonin vajzat e tyre deri sa të zgjedhurit e tyre nuk do t’i shihnin ato, duke u ruajtur nga mashtrimet. A’mesh thotë:

“Secila martesë që është bërë pa u parë nusja, përfundon me brengë dhe pikëllim.”

Dihet se me pamje nuk mund të kuptohet natyra, feja e as gjendja e pasurisë së nuses, por vetëm bukuria i shihet. Do të thotë që në martesë edhe bukuria kërkohet.

Transmetohet se një njeri i cili i lyente flokët dhe mjekrën për t’u dukur më i ri, u martua në kohën e Omerit r.a., dhe iu zbardh pjesa që kishte lyer, dhe familja e nuses e akuzoi te Omeri r.a., duke thënë: *“Ne kemi menduar se është i ri!”* Atëherë Omeri urdhëroi që ai të rrihet me kamxhik duke i thënë: *“Ke mashtruar botën!”*

Transmetohet se Bilali r.a., dhe Suhejbi r.a., erdhën te një familje arabe për të fejuar vajzat e tyre. I pyetën: *“Kush jeni ju?”* Bilali tha: *“Unë jam Bilali, e ky është vëllai im Suhejb. Ishim të humbur, e Allahu na udhëzoi, ishim skllavë, e Allahu na liroi, ishim të varfër, e Allahu na bëri të pasur. Nëse na martoni, themi: El-hamdu lilah*

(falënderimet Allahut), e nëse na refuzoni: Them i "Subhanallah" (lavdi Allahut) dhe largohemi. Ata thanë: "Ne juve ju duam" e Bilali dhe Suhejbi thanë: "El-hamdu lillah." Suhejbi atëherë, i tha Bilalit: "E sikur t'i përmendje luftërat tona përkrah Resulallahut s.a.v.s., dhe pranimin e hershëm të Islamit?" Bilali iu përgjigj: "Hesht! Kam folur të vërtetën dhe e vërteta na ka martuar!"

Mashtrimi ndodh njëjtë, si në kuptim të bukurisë, ashtu edhe në kuptim të moralit. Është e lavdërueshme që të anulohet mashtrimi sa i përket bukurisë me shikimin e të zgjedhurës, e sa i përket moralit, duke pyetur dhe me hetim - mund të mësohet. Kjo është e pëlqyeshme të bëhet para martesës. Duhet të pyetet vetëm personi besnik dhe i drejtë, i cili e di gjendjen e jashtme dhe të brendshme të saj. Ai nuk do të duhej të jetë subjektiv, e ta teprojë me lavdërim, e as t'ia ketë lakmi, e t'i zvogëlojë lavdërimet. Natyra njerëzore anon kah ekstremet në vendosjen e martesës dhe përshkrimin e nuses. Të paktë janë ata që në këtë janë të singertë dhe të matur, sepse mbizotërojnë pretendimet dhe joshjet. Prandaj është e rëndësishme të jemi të rezervuar ndaj atij që frikësohet për veten se do të ketë mall për gra tjera.

Por ai i cili nga martesa pret vetëm kryerjen e sunnetit, fëmijë ose udhëheqjen e shtëpisë e nuk kujdeset për bukurinë, e ka më të lehtë përmbajtjen nga kjo botë (zuhd), sepse megjithatë, bukuria është pjesë e dynjallëkut, ani pse disa personave mund t'i ndihmojë

në fe. Ebu Sulejman Darani ka thënë: *“Përmbajtja nga kjo botë (zuhd) kërkohet në gjithçka; madje edhe në martesë, p.sh. si dëshmi që dikush ia ka kthyer shpinën kësaj bote është edhe martesë me grua më të vjetër.”*

Malik ibn Dinar, Allahu e mëshiroftë, ka thënë:

“Disa nga ju nuk e dëshirojnë martesën me jetimen, e cila me pak mjaftohet, është e kënaqur me atë që ju i jepni dhe do t’ju shërbente; por ju preferoni për gra vajzat e ‘filan zotërisë’; ato që i janë dedikuar kësaj bote, që nuk kënaqen me pak, dhe që do të kërkojnë nga burri t’u plotësojë kërkesa të ndryshme...”

Ahmed ibn Hanbel, prej dy motrave, ka preferuar atë me syrin e dëmtuar. Motra tjetër ishte e bukur. Ibn Hanbeli ka pyetur cila nga to është më e kuptueshme, e kur i thanë që është ajo me syrin e dëmtuar, ai kërkoi ta martojnë me të. Kjo është praktikë e atyre që nuk kanë për qëllim vetëm kënaqësinë.

Ai i cili nuk është i sigurt në fenë e vet, nëse dëshiron të mbrohet nga e ndaluara, le ta kërkojë dhe le ta preferojë bukurinë, sepse kënaqja me të lejuarën është një mbrojtje e fesë.

Dikush ka thënë:

“Nëse gruaja duket bukur, është me moral të mirë, me flokë të zezë, me sy të mëdhenj të zi, me lëkurë të bardhë, nëse e do burrin e vet dhe vetëm atë e shikon, ajo është si një hyri, sepse Allah Teala ka thënë që bukuroshet e xhenetit i kanë këto veçori, me fjalët:

“Aty janë ato (gra) të ndershme e të bukura.”

55-Rahman:70

“Aty janë ato që përqendrojnë shikimin e tyre vetëm në burrat e vet.” 55-Rahman:56

“Dhe ato i kemi bërë virgjëresha.

Të dashuruara (për burrat e vet), të një moshe.”

56-Vakia:36, 37

Hyritë janë gra me bardhësi të jashtëzakonshme, me sy të mëdhenj e të zi, që u përshtaten me flokët e tyre të zezë.

Resulallahu s.a.v.s., thotë:

“Më e mira nga gratë tuaja është ajo e cila, kur ta shikon burri, ajo gëzohet, kur e urdhëron, ajo dëgjon, e kur është larg nga ajo, kujton atë duke e ruajtur veten dhe pronën e tij.”⁶¹

Duke shikuar gruan, burri gëzohet; kjo është e lidhur me dashurinë e gruas ndaj burrit.

4. Cilësia e katërt është që dhurata martesore t'i jetë e vogël. Resulallahu s.a.v.s. thotë:

“Gratë më të mira janë ato me fytyrat më të bukura dhe me dhuratat martesore (mehr ⁶²) më modeste.”⁶³

⁶¹ Nesai nga Ebu Hurejre r.a. dhe Ebu Davud nga Ibn Abbas r.a..

⁶² Mehr: dhurata e detyrueshme e martesës

⁶³ Ibn Hibban nga Ibn Abbasit r.a..

Ai ndaloi teprimin në mehr. Vet Resulallahu s.a.v.s., u martua me njërën nga gratë e tij me dhjetë dërhëmë dhe gjësende të domosdoshme për shtëpi, si: një mulli dore, një ibrik dhe dyshek lëkure mbushur me fije palme.

Hazreti Alia r.a., dha si mehr për njërën nga gratë e tij dy grusht elb, e për tjetrën dy grusht hurme dhe dy grushte kavut (lloj ushqimi, gjelle).

Omeri r.a., ka ndaluar teprimin e mehr-it dhe nuk ka martuar ndonjë rënë nga vajzat e tij me më shumë se 400 dërhëmë.

Sikur teprimi në mehr të ishte vepër e lavdërueshme, i pari do ta bënte Resulallahu s.a.v.s.. Njëri nga as'habët e Resulallahut s.a.v.s., u martua me një kokërr ar për të cilën thonë se ka pasur vlerën e pesë dërhëmëve.

Said ibn Musejjebe e martoi vajzën e vet për Ebu Hurejren r.a., me mehr në total të dy dërhëmëve, pastaj natën ai vet e dërgoi në shtëpinë e Ebu Hurejres, dhe pasi që ia dorëzoi, u largua. Pas shtatë ditësh shkoi në vizitë dhe u përshëndet. Për të shpëtuar nga mosmarrëveshjet në këtë çështje, dijetarët kanë thënë që mehri, edhe dhjetë dërhëmë të jetë, nuk ka dëm. Resulallahu s.a.v.s., thotë:

“Nga bereqeti i gruas është martesë e shpejtë, mehri i vogël dhe mbetja e shpejtë me barrë.”⁶⁴

⁶⁴ Ahmedi dhe Bejheki në transmetim të Aishes r.a.. Zinxhirin e transmetuesve e ka të mirë.

Ashtu siç është mekruh (e papëlqyer) që gruaja të kërkojë shumë mehr, njëjtë është mekruh që burri të kërkojë pasuri nga ajo. Martesa nga lakmia për pasurinë e saj është mekruh.

Sufjan Sevri ka thënë:

- *Kur dikush martohet dhe pyet: 'Çka posedon gruaja?' ta dish se ai është hajn."*

Kur i dhuron diçka familjes së gruas, nuk do të duhej t'i dhurojë me qëllim që t'ia kthejnë me dhuratë më të madhe. Njëjtë në rastin kur ata i dhurojnë atij diçka. Kërkimi i dhuratës më të madhe, ka qëllim të keq; vetëm dhurata e ndërsjellë, pa qëllim të keq, është e lavdërueshme, sepse kjo është shkak për shtimin e dashurisë. Resulallahu s.a.v.s. thotë:

"Dhuroni njëri-tjetrit, do të duheni mes vete!"⁶⁵

Por, një të jepet, e dy të priten është e ndaluar. Atyre që kështu veprojnë në Kur'ani Kerim u është thënë:

"Mos jep gjë, me synimin që të marrësh më shumë!" 74-Mudethir: 6

"Ato që i jepni dhuratë për t'jua shtuar (pasurinë tuaj) përmes pasurisë së njerëzve të tjerë (duke jua kthyer dhuratën me një më të mirë), nuk do të shtohen tek Allahu (s'do të ketë shpërblim)..." 30-Rum:39

⁶⁵ Buhariu në **'Kitabul Edeb'** dhe Bejheki në transmetim të Ebu Hurejres r.a., me zinxhir të mirë të transmetuesve.

Të gjitha këto janë gjëra mekruh në martesë. Këto, duke i ikur qëllimit të martesës, bëjnë që ajo të duket si tregti dhe bixhoz.

5. Cilësia e pestë është të jetë e pëlleshme. Nëse dihet që është shterpë, le të heq dorë nga martesa me të. Resulallahu s.a.v.s. thotë:

“Martohuni me të pëlleshmet besnike”⁶⁶

Nëse nuk dihet se si e ka gjendjen në këtë çështje, le t’i kushtojë vëmendje shëndetit dhe rinisë së saj, sepse nëse ajo i plotëson këto dy kushte, në të shumtën e rasteve, do të jetë e pëlleshme.

6. Cilësia e gjashtë është të preferohet të jetë virgjëreshë.

Resulallahu s.a.v.s., i tha Xhabirit i cili u martua me vejushë:

“Pse nuk u martove me një vajzë të re (virgjëre), që të argëtoheni mes vete?”⁶⁷

Janë tri dobi në martesë me virgjëreshë:

a) Do ta dojë burrin e vet dhe do të mësohet me të, çka do të ndikojë në respektimin e martesës.

Resulallahu s.a.v.s. thotë:

“Martohuni me femër të dashur.”

⁶⁶ Ebu Davud në ‘**Nesai**’ në transmetim të Ma’kil ibn Jesarit, me zinxhir të besueshëm të transmetuesve.

⁶⁷ Buhariu dhe Muslimi nga Xhabiri r.a.

Është në natyrën e njeriut që ajo të jetë e afërt me personin e parë me të cilin është mësuar. Është e mundur që ajo e cila i ka zgjedhur burrat dhe ka qenë në situata të ndryshme martesore nuk do të jetë e kënaqur me karakteristikat të cilat janë ndryshe nga ato me të cilat ajo është mësuar, prandaj do ta përbuzë burrin;

b) Edhe mashkulli e do më shumë virgjëreshën, sepse natyra e mashkullit ndjen urrejtje për atë të cilën e ka prekur tjetri, dhe kjo i vije rëndë atij sa herë që ta kujtojë. Disa natyra mashkullore janë posaçërisht të ndjeshme në këtë çështje;

c) Vejusha, vazhdimisht e përkujton ish-burrin, sepse është dashuria e saj e parë. E kjo mund të bëhet shkak për shqetësime.

7. Cilësia e shtatë është të jetë nga familja e mirë, pra të jetë nga një familje besimtare, e ndershme dhe e mirë, e cila është e edukuar mirë, sepse ajo nesër do të jetë edukatore e fëmijëve. Nëse ajo vet nuk është e edukuar, as ata nuk do t'i edukojë mirë, as t'i rrisë mirë. Prandaj Resulallahu s.a.v.s., ka thënë: **“Largohuni nga trëndafili që mbin në bërllok.”**

Kur e pyetën çka do të thotë kjo, Resulallahu s.a.v.s. tha:

“Femra e bukur që lind nga familja e keqe.”⁶⁸

⁶⁸ Darekutni në ‘El-Ifrad’, nga Ebu Seid Hudri r.a..

Resulallahu s.a.v.s., gjithashtu ka thënë:

“Vendosni farën në enë të pastër; sepse gjaku (edhe i nënës) tërheq.”⁶⁹

8. Cilësia e tetë është të mos jetë akraba shumë e afërt, sepse kjo zvogëlon epshin. Resulallahu s.a.v.s. thotë:

“Mos u martoni me akraba të afërt, sepse fëmija do të jetë i pafuqishëm.”⁷⁰

Afërsia ndikon në epsh. Epshi lind nga emocionet e thella të cilat zhvillohen me shikim dhe prekje, e emocionet bëhen më të forta nëse ndeshen me diçka të këndshme dhe të re. Nëse bëhet fjalë për atë që është shikuar një kohë të gjatë, kjo dobëson emocionet.

Këto janë veçoritë të cilat janë të dëshirueshme të gjinden te femra.

Siç janë këto cilësi të dëshiruara te femra, ato njëjtë kërkohen edhe nga mashkulli. Për këtë arsye, ai që përfaqëson vajzën duhet të zbulojë ahlakun e mashkullit. Duhet të shikojë që vajzën që përfaqëson mos ta martojë për atë që është me natyrë të keqe, me besim të dobët, i cili nuk do t'i kryejë obligimet ndaj saj

⁶⁹ Ibn Maxhe nga Aisha r.a. por shprehja ‘gjak’ nuk ceket. Mensur ed-Dejlemi në **‘Musned-i Firdevs’** nga Enesi r.a.

⁷⁰ Ibrahim el-Harbi në “Garibul-hadith” dhe thotë se ka kuptimin: *Martohuni me të huajat*. Gjithashtu thuhet: *Martohuni me të huajat, nuk do të jeni të dobët!*

ose që për nga prejardhja nuk i është i denjë. Resulallahu s.a.v.s. thotë:

“Martesa është një lloj robërie prandaj secili nga ju le të ketë kujdes kujt po ia dorëzon vajzën e tij!”⁷¹

Më e rëndësishme është të ketë kujdes kur është në pyetje vajza, sepse ajo pashmangshëm, me martesë, në një mënyrë dorëzohet nën urdhrin e burrit. Në cilëndo situatë burri është në situatë që njëanshëm të ndërpresë lidhjen martesore (talak), prandaj nëse e marton të bijën me të dhunshmin, gjynahqarin, bidatxhiun në fe, personin që konsumon alkool, ai i ka bërë dëm fesë së tij dhe i është ekspozuar zemërimit të Allahut, sepse i ka ndërprerë lidhjet familjare dhe ka bërë zgjidhje të gabuar. Një njeri e pyeti Hasan Basriun për kë ta jap vajzën të cilën shumë njerëz ia kërkojnë, e ai iu përgjigj:

“Për atë që i frikësohet Allahut. Nëse e do, do të sillet mirë ndaj saj, e nëse nuk e do – nuk do të jetë i padrejtë ndaj saj.”

Resulallahu s.a.v.s. thotë:

“Kush e jep vajzën e tij për gjynahqarin, i ka ndërprerë lidhjet me vajzën e tij (dhe atë e ka hedhur në zjarr).”⁷²

⁷¹ Ebu Omer et-Tekvani në veprën ‘**Muasheretul-Ehlejn**’ si fjalët e Aishes dhe Esmasë, vajzës së Ebu Bekrit r.a.. Bejheki thekson se kjo përcillet edhe nga Resulallahu s.a.v.s. por që fjalët e as’habëve janë më të besueshme.

⁷² Ibn Hibban në ‘**Duafa**’ në transmetim të Enesit r.a., edhe në ‘**Sikat**’ nga Sha’biu, me zinxhir të besueshëm të transmetuesve.

Kapitulli i Tretë

SHpjegimet për mënyrëne mirësjelljes mes burrit dhe gruas, detyrat që ju takojnëatyre dhe shkaqet për të siguruar vazhdimin e martesës

DETYRAT DHE RREGULLAT E MIRËSJELLJES QË I TAKOJNË BURRIT

Burri është i detyrueshëm që të jetë korrekt dhe të sillet mirë në dymbëdhjetë rastet si vijon:

1. **Velime:** organizimi i gosisë së dasmës, që është e lavdërueshme (mustehab). Enes r.a., ka thënë: *“Resulallahu s.a.v.s. pa Abdurrahman ibn Avfa-n r.a., me fytyrë të zbehur, dhe e pyeti:*

- Çka është kjo? Ai tha:

- U martova me një grua me mehr një kokërr hurme peshë ari. Resulallahu s.a.v.s. i tha:

- Allahu të bekoftë! Gostite, qoftë edhe me një dele.⁷³

Resulallahu s.a.v.s., në martesë me Safijen ka përgatitur gosti të dasmës me një gjellë përgatitur ngjashëm me hallvën dhe me hurme.

Resulallahu s.a.v.s. thotë:

⁷³ Transmetojnë Buhariu dhe Muslimi.

“Të gostitësh një ditë është obligim, dy ditë është sunnet, e tri ditë është pa-sinqeritet, demonstrim dhe hipokrizi, e kush lavdërohet, Allahu e turpëron!”⁷⁴

Është e lavdërueshme të përgëzohet. Kështu, ai që vjen do t’i thotë dhëndrit:

“Allahu të dhuroftë bekimin, qoftë e hairit, mos të ketë ndarje dhe qoftë jetë e lumtur.” Ebu Hurejre r.a., thotë se Resulallahu s.a.v.s., e ka urdhëruar këtë.

Posaçërisht është e lavdërueshme që martesë të shpallet publikisht. Resulallahu s.a.v.s. thotë:

“Ajo që dallon jetën e lejuar martesore nga ajo e palejuar janë defi dhe këndimi!”⁷⁵

Gjithashtu ka thënë:

“Bëjeni publike kurorën, bëjeni në xhami dhe bini për atë rast deficit.”⁷⁶

Transmetohet se Rebi bint Muavviz ka thënë:

“Resulallahu s.a.v.s., erdhi herët te unë pas natës sime të parë të martesës, u ul në shtratin tim, kurse vajzat tona të vogla i binin deficit. Lavdëronin baballarët tanë që ishin vrarë, deri sa njëra nga to këndoi: ‘*Në mesin tonë është i Dërguari, i cili e di çka do të bëhet nesër...*’. Atëherë Resulallahu s.a.v.s. tha:

“Mos thuaj ashtu, por këndo atë që këndojë më parë!”⁷⁷

⁷⁴ Tirmidhiu nga Ibn Mesudi r.a.

⁷⁵ Tirmidhiu, si dhe Ibn Maxhe nga Muhammed ibn Hatib.

⁷⁶ Tirmidhiu nga Aisha r.a. dhe e konsideron të mirë.

⁷⁷ Buhari, i cili thotë që baballarët janë vrarë në Bedr.

2. **Muasheret:** (*Mënyrë mirësjelljeje*) sjellja mirë me bashkëshortet dhe tolerimi i shqetësimit të tyre nga mëshira ndaj tyre, për shkak të mungesës së logjikës së tyre.

Allah Teala thotë:

“Jetoni e silluni mirë me to!”4-Nisa:19

Duke i theksuar të drejtat e tyre, thotë:

“...dhe kur ato kanë marrë nga ju besë të fortë.”

4-Nisa:21

Gjithashtu ka thënë:

“...silluni mirë ndaj të afërmve...”4-Nisa:36

Thuhet se kjo ka të bëjë me bashkëshortet.

E fundit që ka lënë amanet Resulallahu s.a.v.s., janë tri këshilla, deri sa gjuha nuk filloi t'i merret dhe zëri t'i shteret, me fjalët si vijon:

“Namazin, namazin (vazhdoni namazin) dhe ata që janë në posedimin tuaj mos i ngarkoni me atë që nuk janë në gjendje (ta bartin). Frikësojuni Allahut kur janë në pyetje të drejtat e grave, ato në duart e juaja (në një mënyrë) kanë humbur lirinë. Ato i keni marrë me marrëveshje të Allahut dhe me emër të Allahut ato ia keni bërë vetes hallall (Frikësojuni Allahut dhe silluni mirë ndaj tyre).”⁷⁸

Resulallahu s.a.v.s. thotë:

⁷⁸ Nesai në **Sunen-i-Kubra'** dhe Ibn Maxhe nga Ummu Seleme. Është e njohur se porosinë që i përket bashkëshorteve e ka thënë në haxhin Lamtumirës. E përcjell Muslimi në hadith më të gjatë nga Xhabiri.

“Atij që me durim toleron sjelljen e shëmtuar të bashkëshortes së vet, Allahu do t’i jap shpërblim siç i dha Ejubit për sprovat e tij, kurse asaj e cila toleron me durim sjelljen e shëmtuar të burrit të vet, Allahu do t’i japë shpërblim çfarë i dha Asijës, gruas së Faraonit.”⁷⁹

Ta dish se sjellja e mirë ndaj gruas nuk nënkupton që vetëm të mos e shqetësojmë, por edhe të durojmë shqetësimin e saj dhe të jemi të butë kur nxiton dhe kur është e zemëruar, duke përcjellë në këtë Resulallahun s.a.v.s., sepse atë gratë e kundërshtonin, e njëra nga to edhe e kishte injoruar deri në mbrëmje.

Njëherë gruaja e Omerit r.a., e kundërshtoi Omerin, e ai i tha:

-E kush je ti që po më kundërshton, e mjerë?! Ajo iu përgjigj:

-Gratë e Pejgamberit s.a.v.s., e kundërshtojnë atë, e ai është më i mirë se ti! Atëherë Omeri r.a., për vajzën e vet tha:

-Nëse edhe Hafsa bën kështu, ajo është e shkatërruar. Pas kësaj e këshilloi Hafsan:

-Mos të të habis vajza e Ebu Kuhafes (Ebu Bekrit), sepse ajo është më e dashura e Resulallahut s.a.v.s.. Omeri r.a., ia tërhoqi vërejtjen asaj që të mos e kundërshtojë Resulallahun s.a.v.s..⁸⁰

⁷⁹ Nuk është gjetur burimi i hadithit..

⁸⁰ Kjo ka ndodhur në Medine. Burrat e Mekës ishin më dominues ndaj grave. Gratë e Medinës ishin më të lira. Gratë që kishin ardhur nga Meka, duke parë gratë e Medinës, edhe ato filluan të përcjellin të njëjtën rrugë.

Transmetohet se njëra nga to e shtyri në gjoks Resulallahun s.a.v.s., këtë e pa nëna e saj dhe e qortoi. Resulallahu s.a.v.s., nënës së saj i tha:

“Lëre! Ato bëjnë edhe më shumë se kjo.”⁸¹

Muhammedi a.s. dhe Aisha r.a., u zunë me fjalë, dhe e sollën Ebu Bekrin r.a., si arbitër dhe e morën si dëshmitar, dhe Resulallahu s.a.v.s. i tha Aishes r.a.:

- **A po flet ti, apo do të flas unë?** Ajo i tha:

- *Fol ti, por vetëm të vërtetën!* Atëherë Ebu Bekri e goditi shuplakë, ashtu që e mbuloi gjaku, duke i thënë:

- *A nuk e flet ai vetëm të vërtetën?!* Ajo u strehua te Resulallahu s.a.v.s., dhe u ul prapa tij, kurse Resulallahu s.a.v.s., i tha Ebu Bekrit:

- **Nuk të kemi ftuar për këtë, e as që kemi dëshiruar këtë nga ti!**⁸²

Me një rast, kur u hidhërua, Aisha r.a., i kishte thënë:

- *Ti je ai që pohon se je Pejgamber?!*, e Resulallahu s.a.v.s. në këtë vetëm u buzëqesh, dhe tha:⁸³

- **Unë saktë e dalloj kur je e disponuar, e kur nuk je. Unë e di a je ti i zemëruar a po s’je.**

- *E si e di?*, e pyeti Aisha.

- **Kur je e disponuar, thua: “Për hakun e Rabbit të Muhammedit”, e kur je e hidhëruar, thua: “Për hakun e Rabbit të Ibrahimit.”** Në këtë, ajo tha:

⁸¹ Nuk është gjetur burimi i këtij hadithi.

⁸² Taberani në **‘Evsat’** kurse Hatibi në **‘Tarih’** nga Aisha r.a..

⁸³ Ebu Ja’la në veprën e tij **‘Musned’** dhe Ebu Shejh në **‘Kitabul-Emsal’** në transmetim nga Aisha r.a..

-Ke të drejtë, edhe nëse nuk përmendi emrin tënd me gjuhë, e përmendi me zemër.”⁸⁴

Thuhet se dashuria e parë në mes të myslimanëve filloi me dashurinë e Resulallahut s.a.v.s., ndaj Aishes r.a..⁸⁵

Ai do t’i thoshte:

“Unë ndaj teje jam si Ebu Zer ndaj Ummu Zer–por (e vërteta është se) unë ty nuk do të lë.”⁸⁶

Resulallahu s.a.v.s., do t’ju thoshte grave të tij:

“Mos më mundoni për Aishen, sepse Shpallja, Vallahi, nuk më ka ardhur nën jorganin e asnjërës nga ju, përpos të saj!”⁸⁷

Enes r.a., ka thënë: *“Më i mëshirshmi ndaj gruas dhe fëmijëve ishte Muhammedi s.a.v.s.”⁸⁸*

3. Duabe: (bërja shaka) rregulli i tretë i sjelljes është që me atë të argëtohet, bëhet shaka dhe të luhet, duke u munduar kështu për t’ia zbutur asaj dertet. Kjo mënyrë veprimi është që kënaq zemrat e grave.

⁸⁴ Buhariu dhe Muslimi e transmetojnë nga Aisha r.anha.

⁸⁵ Buhari dhe Muslim në transmetim nga Amr ibn As. Pohimin se kjo ishte dashuria e parë e shënon edhe Ibnu’l Xhevzi në **Mevzu’at’**

⁸⁶ Në kohën e Resulallahut s.a.v.s., Ebu Dherr ishte shembull i burrit të kujdesshëm, bujar dhe të vyeshtë, i cili pas një kohe megjithatë u nda nga Ummu Dher. Hadithi është muttefekun alejhi në transmetim të Aishes r.a., nga Buhari dhe Muslim. Gjithashtu e shënojnë edhe Zubejr ibn Bekkar dhe Hatibi me pjesën: *“Unë ty nuk do të të lëshoj”*.

⁸⁷ Buhariu në transmetim të Aishes r.a..

⁸⁸ Transmetimin e Enesit e përmend Muslimi, si edhe Ali ibn Abdulaziz dhe Begavi.

Resulallahu s.a.v.s. bënte shaka me to, lëshohej me veprime dhe me sjellje në nivelin e tyre intelektual. Bile, transmetohet se garonte me Aishen r.a., një herë ajo e kaloi, e herën tjetër për shkak të peshës, Aisha r.a., nuk mundi të fitojë garën, dhe Resulallahu s.a.v.s., që e fitoi garën, i tha:

“Kjo është për shkak që të pengoi trashësia; një herë ti fitove, e njëherë unë!”⁸⁹

Transmetohet se Resulallahu s.a.v.s., më së shumti ua bënte qejfin grave të tij.⁹⁰

Aisha r.a. kështu tregon: *“I dëgjova një herë zërat e Abisinëve dhe të tjerëve të cilët luanin në ditën e Ashures, e Resulallahu s.a.v.s., më tha:*

- A do të doje të shikosh si luajnë? U përgjigja që do të doja, e ai i thirri dhe ata erdhën, kurse Resulallahu s.a.v.s., qëndronte në mes të dy dyerve. E vendosi krahun në njërën derë dhe e zgjati dorën. E mbështeta mjekrën në dorën e tij, e ata filluan të luajnë, e unë shikoja. Dy herë më pyeti:

- A është mjaft?, e unë i thashë: “Prit edhe pak”. Herën e tretë Resulallahu s.a.v.s., më tha:

- Aishe, për ty kaq është mjaft. Dhe kur unë thashë: “Po”, i largoi ata.”⁹¹

⁸⁹ Ebu Davud, Nesai dhe Ibn Maxhe në transmetim të Aishes r.a. me zinxhir të besueshëm të transmetuesve.

⁹⁰ Hasan ibn Sufjan në **‘Musned’**, në transmetim të Enesit r.a..

⁹¹ Buhariu dhe Muslimi, por në vend të ditës së Ashures përmendet dita e Bajramit.

Përsëri, në një hadith të Resulallahut s.a.v.s., thuhet:

“Besimtari me imanin më të përkryer është ai me ahlakun më të mirë dhe më mirëbërës ndaj familjes së vet.”⁹²

Resulallahu s.a.v.s. gjithashtu ka thënë:

“Më i miri nga ju është ai që është më i sjellshmi ndaj grave të tij, e unë jam më i sjellshmi ndaj grave.”⁹³

Edhe pse ishte i përpiktë dhe i sertë, Omeri r.a., thoshte: *“Njeriu në familjen e vet do të duhej të ishte si fëmija, e karshi tjerëve - burrë.”*

Kështu thoshte dhe këshillonte edhe Llukmani, Allahu e mëshiroftë.

“Allahu nuk e do qortuesin dhe atë që nuk gostit.”⁹⁴

Në hadh, me ‘Xha’zari Xhevaz’ mendohet për atë që sillet ashpër ndaj fëmijëve dhe gruas. Ky është edhe një kuptim tjetër i fjalës ‘utull’ (ashpër) në ajetin 13 të sures Kalem.

⁹² Tirmidhiu, Nesai dhe Hakimi, i cili thotë që transmetuesit i ka të besueshëm me kushtet e Buharit dhe Muslimit.

⁹³ Tirmidhiu nga Ebu Hurejre r.a., pa pjesën “... e unë jam më i sjellshmi ndaj grave”. Këtë pjesë, Nesai e transmeton nga Hz. Aisha r.a., me zinxhir të besueshëm të transmetuesve.

⁹⁴ Ebu Bekir b. Lal në ‘Mekarim-i Ahlak’ nga Ebu Hurejres r.a. Gjithashtu Buhariu dhe Muslimi nga Xharij b. Vehbu’l-Huzais r.a., e edhe Ebu Davudi ka transmetuar.

Resulallahu s.a.v.s. i kishte thënë Xhabirit r.a.:

“Sikur të kishe marrë një vajzë virgjëreshë, ajo vetëm ty të njihte, dhe ti vetëm atë, së bashku do të argëtoheshit.”

Një beduine, duke e përshkruar burrin e vet që kishte vdekur, tha:

Pasha Allahun,

Do të buzëqeshte kur të vinte,

Do të heshte kur të shkonte,

Do të hante çka të gjente,

Nuk do të kërkonte atë çka mungonte.

4. **Sijaset:** (politikë) rregulli i katërt i sjelljes është të mos teprohet në argëtim dhe në pajtimin me gruan duke plotësuar kërkesat e saj deri në kufij që do të ndikonte keq në sjelljen e saj, dhe që ajo do ta humbiste plotësisht frikë-respektin ndaj tij, por duhet të ketë kujdes që në këtë të jetë i matur. Ai nuk duhet të heq dorë nga qëndrimi i dinjitetshëm dhe nga krenaria, e as që duhet ta përkrahë dhe lejojë ndonjëherë në atë që është e ndaluar. Gjithmonë, kur vëren atë që është jashtë kornizave të sheriatit, do të shqetësohet dhe zemërohet.

Hasan Basriu ka thënë:

“Burri që i përshtatet dëshirave të gruas që nuk janë të lejuara, futet në xhehenem.”

Omeri r.a., ka thënë:

“Kundërshtoni gratë, sepse në kundërshtim të tyre është bereqeti.”

Është thënë: *“Këshillohuni me to, por atë që e thonë, mos e bëni.”*

Resulallahu s.a.v.s. thotë:

“Shkatërrohet ai cili i robërohet gruas!”⁹⁵

Sepse Allah Teala e ka krijuar mashkullin superior ndaj gruas, dhe gruan ia ka dhënë nën urdhër mashkullit, kurse burri, me hyrjen nën urdhrin e gruas e ka ndryshuar këtë urdhër të Allahut. Me këtë i është përlur shejtanit, e shejtani ka thënë:

“...e pastaj do t’i urdhëroj që të ndryshojnë krijesën e Allahut.” 4-Nisa:119

Sepse është e drejtë e mashkullit që ai të ndiqet pas, e jo që ai të ndjek pas gruan. Allah Teala thotë për meshkujt që ata janë mbrojtës (kavvamun) të grave, dhe burrin e ka quajtur mbikëqyrës (sejjid).

Allah Teala thotë:

“..te dera, ata hasën mbikëqyrësin e saj”

12-Jusuf:25,

e kur mbikëqyrësi të transformohet në skllav, atëherë ai ndryshon krijesën e Allahut.

Gratë janë si nefsi i njeriut. Nëse për një çast ia lëshon frerët, do të të ik larg. Nëse e tërheq nga vetja, dhe e mban fuqishëm, atëherë je mbikëqyrësi i saj.

Imam Shafiu ka thënë: *“Nëse me këta tre persona sillesh butë, ata ty të tradhtojnë, nëse sillesh ashpër, të bëjnë mirësi. E këta janë: grua, shërbëtori dhe punëtori.”*

⁹⁵ Nuk është gjetur hadithit me këtë transmetim. Është i njohur transmetimi *I shkatërruar është ai që i robërohet arit dhe argjendit...* të cilin e shënon Buhariu.

Gratë Arabe, para se t'i martonin vajzat e veta, kështu i këshillonin:

- Testoje burrin tënd para se të dalësh para tij. Hiqi majën nga shigjeta, e nëse këtë ta hesht, atëherë prej mish në mburojën e tij. Nëse edhe këtë ta hesht, atëherë prej eshtra me shpatën e tij. Nëse edhe për këtë nuk thotë asgjë, atëherë nuk ka problem - vëri samarin në shpinë dhe hipi përmbi, sepse ai është gomari yt.

Përmbledhje: qiejt dhe Toka shtrihen mbi drejtësi. Gjithçka që kalon kufijtë e drejtësisë, shndërrohet në kaos.

Prandaj është me rëndësi të jesh i matur edhe në pajtim edhe në kundërshtim të bashkëshortes dhe që në të gjithë këtë të përcjellësh të vërtetën që të shpëtosh nga të këqijat e tyre, sepse intrigat e tyre janë të mëdha, dhe e keqja e tyre mbizotëron. Shumica janë me karakter të keq dhe me mendje të dobët, dhe kjo te ato mund të përmirësohet vetëm me butësi të gërshetuar me diplomaci.

Resulallahu s.a.v.s., thotë:

“Gruaja e mirë në mesin e grave tjera është si sorra me krah të bardhë (asam) në mesin e qindra të tjerave të zeza.”⁹⁶

⁹⁶ Taberani në transmetim nga Ebu Umame r.a., me zinxhir të dobët të transmetuesve dhe Ahmedi nga Omer b. el-As'it me zinxhir të besueshëm të transmetuesve, si dhe gjendet te Nesai në **Sunenul-Kubri'**.

Llukmani a.s., kështu ka këshilluar të birin:

- O biri im, ik nga gruaja e keqe, sepse ajo të plakë ty para kohës. Frikësohu nga sherri i grave, sepse ato nuk thërrasin në mirësi. Bile, mundohu të ruhesh edhe nga gratë e mira."

Resulallahu s.a.v.s., thotë:

"Kërkoni strehim te Allahu nga tri gjëra që thyejnë kurrizin.", dhe ka përmendur edhe gruan e keqe. Sepse, ajo e plakë burrin para kohës.⁹⁷

Në versionin tjetër:

"Kur të afrohet – flet keq, e kur largohet nga ti - të tradhton."

Gjithashtu, Resulallahu s.a.v.s., thotë:

"Nuk do të ketë shpëtim populli mbi të cilin sundon gruaja."⁹⁸

Njëherë kur gruaja e kundërshtoi, Omeri r.a., e qortoi ashpër duke i thënë: *"Ti je vetëm lodër në qosh të dhomës, nëse kam nevojë për ty, luajmë, e nëse jo, qëndron ku je."*

Pra, në to ka të keqe dhe dobësi. Diplomacia dhe rreptësia shërojnë të keqen, deri sa butësia dhe mëshira janë ilaç për dobësinë. Mjek i aftë është ai i cili përcakton ilaçin sipas sëmundjes, prandaj burri

⁹⁷ Ebu Mensur Dejlemi në **'Musnedul-firdevs'** nga Ebu Hurejre r.a., me zinxhir të dobët të transmetuesve. E shënon edhe Taberani nga Fedal ibn Ubejd me zinxhir të mirë të transmetuesve.

⁹⁸ Buhariu transmeton nga Ebu Bekri r.a.

fillimisht, në bazë të përvojës, le të vlerësojë karakterin e saj, e pastaj le të sillet me të ashtu që do ta përmirësojë përshtatshëm me kërkesat e gjendjes së saj.

5. **Xhelozia:** rregulli i pestë i sjelljes është të jetë i matur në xheloz, e kjo do të thotë të mos parashikojë sugjerime, pasojat e të cilës do të mund të jenë të kobshme, e as mos ta teprojë me dyshime, obsesion dhe spiunim të privatësisë. Resulallahu s.a.v.s., ka ndaluar që të përcillet *“intimiteti i gruas”*⁹⁹, e në një version tjetër thuhet: *“... të mos u shkohet befas.”*

Kur Resulallahu s.a.v.s., u kthye nga lufta e Tebukut, para se të hynte në Medine, tha:

“Mos u shkoni grave tuaja pa paralajmërim natën.”¹⁰⁰

Dy persona nuk e dëgjuan dhe u ngutën për në shtëpi, dhe të dytë në shtëpi panë atë që nuk u pëlqeu.

Në transmetimin e njohur thuhet:

“Gruaja është si ashti i brinjës, nëse mundohesh ta drejtosh, do ta thyesh, por lëre dhe kënaqu me të ashtu

⁹⁹ Taberani në **‘Evsat’** nga Xhabiri, si vijon: *“Ka ndaluar të hulumtohen lëshimet e gruas”*, kurse gjendet edhe te Muslimi në versionin si vijon: *“Ka ndaluar që burri befas natën të shkojë te gruaja e tij që të kontrollojë ose të kërkojë lëshimet e saj.”* El-Buhari është limituar vetëm në përmendjen e ardhjes së befasishme në shpi natën.

¹⁰⁰ Ahmedi në transmetim të Ibn Omerit r.a., me zinxhir të mirë të përcjellësve.

si është.”¹⁰¹ Kjo do të thotë se nuk mundesh ta drejtosh ahlakun e gruas ashtu siç dëshiron.

Resulallahu s.a.v.s. gjithashtu thotë:

“Ekziston një lloj xhelozie të cilën Allah Teala e përbuz, e kjo është kur njeriu ndjen xhelozin ndaj gruas kur nuk ka arsytim për dyshim.”¹⁰², dhe kështu e bënë gruan të vuaj pa arsye. Kjo vjen për shkak të mendimit të keq për të, e kjo na është e ndaluar, sepse disa dyshime janë gjynah.

Alia r.a., ka thënë:

- Mos u bëj së tepërmi xheloz në gruan tënde, e që për shkak të kësaj ajo mund të shkojë rrugëve të këqija.

Xhelozia me vend është e domosdoshme dhe ajo lavdërohet. Resulallahu s.a.v.s., thotë:

“Allahu është, vërtet, xheloz, edhe besimtari është xheloz, e xhelozia e Allahut është kur personi bënë atë që është haram.”¹⁰³

Një ditë Sad b. Ubade tha:

- Në qoftë se do ta shihja ndonjë mashkull duke ngacmuar gruan time do ta kisha mbytur me shpatë.

Këtë gjë as’habët ia përcjellën Resulallahut s.a.v.s., dhe Resulallahu s.a.v.s., u thotë:

“A po habiteni me xhelozinë e Sa’adit? Pasha Allahun, unë jam më xheloz se ai, e Allahu është edhe më xheloz se unë!”¹⁰⁴

¹⁰¹ Buhariu dhe Muslimi nga Ebu Hurejre r.a.

¹⁰² Ebu Davud, Nesai dhe Ibn Hibban nga Xhabir ibn Atik r.a..

¹⁰³ Buhariu dhe Muslimi nga Ebu Hurejres r.a.

Resulallahu s.a.v.s. thotë:

“Kam parë në natën e Israsë një kështjellë në xhennet në oborrin e të cilës ishte një vajzë, dhe pyeta: “E kujt është kjo kështjellë?” “E Omerit”, më thanë. Desha ta shikoj, por e kujtova xhelozinë tënde, Omer.”

Kur e dëgjoi këtë, Omeri filloi të qajë dhe në lot tha: *“Vallë, a mund të jem xheloz në ty, o Resulallah (s.a.v.s.)?!?”*¹⁰⁵

Hasani Basriu ka thënë: *“Si bën që t’i lëshoni gratë në rrugë e të përzihen me mushrikët? Allahu ka turpëruar atë që nuk është xheloz!”*

Resulallahu s.a.v.s. thotë:

“Ka xhelozitë të tillë që Allah Teala e do, por edhe të tillë që nuk e do. Gjithashtu ka edhe krenaritë të cilën Allahu e do, dhe të tillë që nuk e do. Xhelozia të cilën Allahu e do është ajo xhelozia kur ka dyshim të justifikuar, e ajo të cilën nuk e do është xhelozia pa kurrfarë dyshimi. Krenaria e cila i është e dashur Allahut është kur njeriu mburret me veten karshi armikut në vijën e parë të frontit, në durim dhe në rezistencë, kurse krenaria të cilën Allahu nuk e do është krenaria që bëhet karshi tjetër kujt.”¹⁰⁶

Resulallahu s.a.v.s. gjithashtu thotë:

¹⁰⁴ Buhariu dhe Muslimi nga Mugire b. Sh’bedi r.a.

¹⁰⁵ Buhariu dhe Muslimi nga Xhabiri r.a..

¹⁰⁶ Ebu Davud, Nisai dhe Ibn Hibban nga Xhabir ibn Atik r.a., përmendur më herët.

“Unë vërtet jam xheloz, dhe secili që nuk është xheloz ka zemër të mbrapshtë.”¹⁰⁷

Masa parandaluese e xhelozisë.

Mënyra e vetme për të mos qenë xheloz është që gruaja të mos ketë kontakt me meshkuj tjerë, dhe që ajo të mos lejohet të dal në rrugë.

Resulallahu s.a.v.s., e pyeti vajzën e tij Fatimanë r.a.:

-Çka është më e hairit për gruan? Ajo i tha:

- Të mos shikojë ndonjë mashkull, e as ai të mos e shikojë atë, përgjigje që i pëlqeu Resulallahut s.a.v.s., pas të cilës ai e tërhoqi Fatimen afër vetes dhe duke shfaqur dashurinë, lexoi ajetin:

“Këta janë pasardhës njëri prej tjetrit.”

3-Ali Imran: 34.¹⁰⁸

As’habët e Resulallahut s.a.v.s., do të mbyllnin dritaret dhe hapjet në mure që gratë të mos mund të shihnin meshkujt. Muadhi r.a., e pa gruan e tij si shikonte në dritare. Herën tjetër e pa si i jep shërbëtorit mollën që ajo vet e kafshoi, dhe atëherë e goditi. Omeri r.a., ka thënë:

¹⁰⁷ Fillimin e hadithit tashmë e kemi përmendur, kurse pjesën e dytë e shënon Ebu Omer et-Tekvani në veprën **‘Kitabu Muasheretul-Ehlejn’** në transmetim mursal të Abdullah ibn Muhammed.

¹⁰⁸ Shënojnë Bezzar dhe Darekutni në **‘El-Ifrad’**, në transmetim të Alisë r.a..

“Nëse doni që gratë tuaja të mos u bredhin rrugëve, mos u blini rroba të bukura, sepse ato me rroba të shtëpisë nuk duan të shihen”.

Gjithashtu ka thënë:

“Mësoni t’i thoni ‘jo’ grave! Nëse për çdo kërkesë të tyre u thoni ‘po’, keni punë.”

Resulallahu s.a.v.s., i ka lejuar gratë të vijnë në xhami, por sot është më mirë që, pos plakave, kjo t’u ndalohet. Edhe as’habët e kanë parë këtë si të përshtatshme, bile edhe Aisha r.a., pas vdekjes së Pejgamberit a.s., ka thënë:

“Sikur Resulallahu s.a.v.s. të dinte gjendjen e grave sot, do t’u ndalonte të dilnin.”

Kur Abdullah b. Omeri ia përmendi njërit prej djemve të tij hadithin e Resulallahut s.a.v.s.:

‘Mos i ndaloni gratë nga mesxhidet (xhamitë) e Allahut,’¹⁰⁹ djali i tij tha: *“Po, do t’ua ndalojmë”*. Në këtë, Abdullahu e goditi duke i thënë: *“Unë tregova se Resulallahu s.a.v.s., ka thënë ‘Mos ua ndaloni’, e si bëhet që ti të thua se do t’ua ndalosh!”*. I biri guxoi të kundërshtojë sepse kishte parë prishjen e kohës, e babai e goditi pa dëgjuar shkakun e kundërshtimit.

Resulallahu s.a.v.s., gjithashtu u lejonte grave të dilnin me lejen e burrave të tyre për ditët e bajramit, por do të dilnin vetëm të shoqëruara.¹¹⁰

¹⁰⁹ Buhariu dhe Muslim, nga ibn Omeri r.a.

¹¹⁰ Buhariu dhe Muslim, nga Ummu Atijje r.a..

Sot, gruas së ndershme i është e lejuar shkuarja në xhami, me pëlqimin e burrit të saj, por qëndrimi në shtëpi është megjithatë më i përshtatshëm. Do të duhej të dilte vetëm për shkak të obligimeve, por jo për qejf. Sepse dalja e panevojshme dhe shëtitja rrugëve ndikon në lumturinë familjare dhe në personalitetin e saj. Bile, mund të bëhet shkak, ose të përzihet, në ndonjë fesat. Kur del jashtë, për gruan është e përshtatshme të mos shikojë askënd, dhe të vazhdojë rrugën e vet me dinjitet dhe edeb (edukatë).

Kjo nuk nënkupton që për femrën fytyra e mashkullit, ose për mashkullin fytyra e femrës, është avret.¹¹¹ Ndoshta, çka është fytyra e një të riu për burrin, njëjtë është edhe fytyra e mashkullit të huaj për gruan - është e ndaluar të shikohet vetëm kur ekziston frika nga fitnet, e nëse kjo frikë nuk ekziston, atëherë nuk është e ndaluar. Kjo sepse meshkujt gjithmonë kanë qenë me fytyrë të zbuluar, kurse gratë kanë dalë nën nikab (mbulesë e fytyrës; peqe). Sikur fytyrat e meshkujve të ishin si fytyrat e grave, edhe ata do të mbulonin fytyrën sikur gratë, dhe do t'u lejohej të dilnin jashtë vetëm kur është e domosdoshme.

6. Nafaka: *(Gjëra të nevojshme për jetesë) rregulli i gjashtë i sjelljes* është që të jetë i matur në harxhime, kështu që nuk do të duhej të jetë dorështrënguar me to, e as nuk duhet ta teprojë, por të jetë i matur. Secili duhet të kënaq nevojat e familjes, sipas mundësive të veta. Allah Teala thotë:

¹¹¹ Pjesë e trupit që duhet mbuluar.

“Hani e pini, por mos e teproni...”7-Araf:31

“Mos e shtrëngo dorën, as mos u bëj dorëshpuar...” 17-Isra:29

Resulallahu s.a.v.s., thotë:

“Më të mirët ndër ju janë ata që janë më të mirët ndaj familjes së vet.”¹¹²

“Paratë harxhohen në rrugën e Allahut, në lirim të skllavit dhe në familje. Nga të gjitha këto, shpërblimin më të madh do ta kesh për atë që ke harxhuar në familjen tënde.”¹¹³

Thuhet se Alia r.a., ka pasur katër gra, dhe secilës prej tyre do t'i blinte çdo katër ditë mish për një dërhëm.

Hasani Basriu ka thënë: *“Të parët ishin të xhymertë ndaj ushqimit, kurse rrobave dhe mobileve nuk i kanë dhënë rëndësi.”*

¹¹² Tirmidhiu në transmetim të Hz. Aishes r.a., dhe e konsideron të besueshëm. Është cekur edhe më herët.

¹¹³ Muslimi nga Ebu Hurejre r.a..

Ibn Sirin tregon: “*Është e lavdërueshme që njeriu çdo xhuma t’i bëjë familjes së vet falluze-palluze.*¹¹⁴ Edhe pse ëmbëlsirat nuk janë ushqim kryesor, lënia e plotë e ëmbëlsirave, konsiderohet si koprraci.”

Mashkulli, për gjellët që teprojnë e që mund të prishen, duhet urdhëruar gruan që t’u japë të varfërve. Kjo është shkalla më e ulët e mirësisë. Gruaja këtë mund ta bëj përshtatshëm me kërkesën e momentit pa leje të qartë nga burri i saj. Burri nuk do të duhej të ndahej nga familja duke ngrënë ushqime të veçanta, e me to mos t’i ushqej edhe ata. Kjo rindez zemërimin dhe vështirëson sjelljen e mirë, e nëse është i detyruar të veprojë kështu, le të fshihet dhe ta hajë atë ushqim, ashtu që familja për këtë të mos dijë.

Nuk do të duhej, gjithashtu, t’ju flasë për ushqimin me të cilin nuk e ka ndërmend t’i ushqejë. Sepse, kur u përkujton atë ushqim, atyre ua do zemra. Kur të hajë, le të ulet edhe e gjithë familja në sofrën e tij për të ngrënë bashkë. Sufjani r.a., ka thënë: “*Kemi marrë vesh se Allahu dhe melaiket e tij bekojnë atë familje e cila ha së bashku në një sofër.*”

Më e rëndësishmja në çka duhet pasur kujdes në çështjen e ushqimit është që familja të ushqehet me hallall, dhe që burri mos të lëshohet në punë haram për shkak të ushqimit, sepse ky është krim, e jo shfaqje e kujdesit ndaj tyre. Më herët, duke folur për anët e

¹¹⁴ Falluz-Palluze (Persian) lloj reçeli i bërë nga qershitë, vishnjat, kajsitë, rrushi e të ngjashme, të cilit i shtohet niseshte e holluar, me çka bëhet më i trashë.

këqija të martesës, kemi përmendur mësimet që flasin për këtë.

7. Talim: (Mësimi) rregulli i shtatë i sjelljes është që burri të mësojë për larjen mujore dhe rregulloren që ka të bëjë me këtë, dhe në të duhet të jetë i kujdesshëm. Do ta mësojë gruan me rregullat e namazit si dhe cilat do t'i falë ajo e cilat jo për shkak të ciklit menstrual, sepse i është urdhëruar që ta ruaj nga xhehenemi me fjalët e Allahut Teala:

“Ruani veten dhe familjet tuaja nga zjarri...”

66-Tahrim:6

Është obligim i tij ta mësojë gruan në besimin e ehli-sunnetit, që nga zemra e saj të largojë çfarëdo risie të cilën ajo do ta adoptonte, që në zemër t'i vendosë devotshmërinë dhe ta mësojë me rregullat që i janë të nevojshme, dhe kanë të bëjnë me menstruacionet dhe rrjedhje të parregullt të gjakut.

Njohuria për rrjedhje të parregullt të gjakut është e gjerë, por ajo për çka është e domosdoshme të udhëzohet gruaja në lidhje me menstruacionin është t'u shpjegohet se cilat namaze kompensohen. Pra, kur t'i ndalet rrjedhja e gjakut mu para akshamit, ashtu që mund të falë së paku një rekat, është e obliguar të fal edhe drekën edhe ikindinë. Nëse i ndalet para lindjes së diellit, ashtu që mund ta falë së paku një rekat, është e obliguar të falë edhe akshamin edhe jacinë.¹¹⁵ Kjo është më së paku në çka grave duhet tërhequr vëmendjen.

¹¹⁵ Sipas medh'hebit Hanefi nëse pastrohet në pjesën e fundit të kohës d.m.th. gjaku ndërpritet dhe pasi që lahet nëse arrin të

Nëse burri e mëson, ajo nuk ka të drejtë të dal për të pyetur myftiun, e nëse dituria e burrit është e mangët, ai do të bëjë pyetje në vend të saj dhe do t'ia tregojë përgjigjen e myftiut, ashtu që ajo nuk ka të drejtë të dalë.

Nëse burri nuk e mëson, ajo ka të drejtë të dalë për të kërkuar përgjigje, aq më shumë – këtë e ka obligim, dhe burri do të ishte gjynahqar nëse do ta pengonte. Kur t'i mësojë obligimet e veta, nuk ka të drejtë të dalë deri te vendet ku përmendet Allahu (mexhliset e dhikrit), e as të mësojë më shumë se kaq, përpos me pëlqimin e burrit. Nëse gruaja do të linte pas dore ndonjë nga rregullat që kanë të bëjnë me menstruacionet ose rrjedhjen e parregullt të gjakut, pakujdesia e burrit është gabim i burrit po aq sa edhe i gruas, dhe ata e bartin gjynahun e njëjtë.

8. **Kasem:** (Betim) rregulli i tetë i sjelljes është që nëse ka më shumë gra, duhet të jetë i drejtë me to, dhe mos të favorizojë asnjërën nga to. Nëse niset për rrugë dhe dëshiron që njëra nga to ta përcjellë, me short do të vendosë se cila nga to do të jetë. Kështu ka vepruar Resulallahu s.a.v.s.. Nëse nuk shkon një natë pranë njërës grua, duhet ta kompensojë, dhe kompensimi i është obligim. Për këtë arsye është obligim (vaxhib) të njohë rregulloren e kësaj çështje, edhe për këtë çështje mund të flitet gjatë. Resulallahu s.a.v.s., thotë:

“Kush i ka dy gra dhe është më i dhënë pas njërës (në transmetimin tjetër thuhet:...nuk është i drejtë ndaj

marrë tekbinin fillestar (iftitah) vetëm atë namaz kadha e bën.
(shënim i përkthyesit)

tyre), në Ditën e Gjykimit do të vijë në vend mahsherit i lakuar në njërën anë.”¹¹⁶

Është i obliguar të jetë i drejtë në dhurata si dhe në qëndrim te to. Përndryshe në dashuri dhe marrëdhënie drejtësia nuk bëhet, sepse këto janë gjendje jashtë vullnetit. Kështu që Allah Teala thotë:

“Ju kurrresi nuk do të mund ta mbani drejtësinë mes grave edhe nëse përpiqeni.” 4-Nisa: 129

d.m.th., ju kurrresi nuk keni fuqi të respektoni të drejtën e dashurisë dhe marrëdhënieve martesore.

Resulallahu s.a.v.s., ishte i drejtë ndaj bashkëshorteve në dhurata dhe në qëndrimin e natës te to, dhe thoshte:

“Allahu im, kjo është përpjekja ime në atë që është në fuqinë time, e unë nuk kam fuqi për atë që Ti mundesh.”¹¹⁷, duke menduar në dashuri.

Aisha r.a. ishte bashkëshortja e tij e preferuar, çka e kanë ditur edhe bashkëshortet tjera. “Gjatë sëmurjes së tij do të qëndronte te secila nga to dhe thoshte: **‘Ku do të jem nesër?’** Njëra nga to e kuptoi këtë dhe tha: *‘Ai po pyet për qëndrimin te Aisha’*, prandaj i thanë: *‘O Resulallah, ne të lejojmë që të qëndrosh në dhomën e Aishes, sepse e ke të mundimshme që për çdo natë të ndërrosh vend.’* Në këtë ai i pyeti:

-A pajtoheni të gjitha për këtë?

-Ato thanë: ‘Po.’

¹¹⁶‘**Ashab-i Sunen**’ dhe Ibn Hibban në transmetim nga Ebu Hurejre r.a..

¹¹⁷ E përmendin përpiluesit e **‘Ahab-i Sunen**’ dhe Ibn Hibban nga Aisha r.a..

E kur u përgjigjën me miratim, tha:
-Më bartni në dhomën e Aishes!¹¹⁸

Kur njëra nga to ia dhuron natën e vet tjetrës, e burri pajtohet me këtë, ajo ka të drejtë në atë natë. Resulallahu s.a.v.s., ka ndarë netët në mënyrë të barabartë në mes të grave të tij. Resulallahu s.a.v.s., kishte dashur të ndahet nga Sevda binti Zema por Sevda e moshuar natën e vet ia dhuroi Aishes r.a., kurse nga Resulallahu s.a.v.s., kërkoi që edhe më tutje të jetë gruaja e tij, kështu që Resulallahu s.a.v.s., pranoi dhe nuk i caktoi natë të veçantë.¹¹⁹ Kështu, Aishes r.a., i caktoi dy net, kurse bashkëshorteve tjera nga një. Megjithatë, Resulallahu s.a.v.s., nga drejtësia e madhe e tij dhe nga fuqia e tij, kur do të dëshironte ndonjëherë nga gratë e cila nuk e kishte rendin dhe do të kishte marrëdhënie martesore me të, në të njëjtën natë ose ditë do t'i vizitonte të gjitha gratë. Për këtë flet edhe transmetimi i Aishes r.a., se Resulallahu s.a.v.s. ka pasur marrëdhënie me të gjitha gratë e tij brenda një nate.¹²⁰ Nga Enesi r.a., transmetohet se Resulallahu s.a.v.s. për një mëngjes do të shkonte te të gjitha gratë e tij!¹²¹

9. Nashize: (Mosmarrëveshje mes burrit dhe gruas)
rregulli i nëntë i sjelljes është përshtatja drejtësisë në

¹¹⁸ Ibn Sa'd në '**Tabekat**', Buhariu dhe Muslimi në transmetim të Muhammed ibn Ali el-Husejn r.a.

¹¹⁹ Ebu Davud në transmetim të Aishes r.a.. E shënojnë edhe Taberani dhe Buhariu.

¹²⁰ Buhariu dhe Muslimi nga Aisha r.a.

¹²¹ Ibn Adijj ka transmetuar në '**El-Kamil**', edhe Buhariu ka transmetim të ngjashëm.

mosmarrëveshje mes burrit dhe gruas. Kurdo që mes bashkëshortëve ndodh mosmarrëveshje dhe kur nuk mund ta tejkalojnë, kurse faji për këtë është i dyanshëm, ose është vetëm i burrit, duke qenë se gruaja nuk ka pushtet mbi burrin, e as ai nuk mund ta përmirësojë atë, është e domosdoshme të caktohen dy arbitër, njëri nga familja e tij, e tjetri nga familja e saj, që të gjykojnë mes tyre dhe ta rregullojnë situatën. Në qoftë se këta janë të singertë dhe kanë për qëllim pajtimin mes burrit dhe gruas, Allahu sjell marrëveshje midis tyre.

Omeri r.a., i dërgoi arbitrin një çifti bashkëshortor, e ky u kthye pa i pajtuar. Omeri e qëllloi me kamxhik, duke i thënë: *“Allah Teala vërtet thotë:*

‘Nëse ata të dy (ndërmjetësuesit) kanë për qëllim pajtimin, Allahu ju mundëson afrimin mes tyre (burrit e gruas).’4-Nisa: 35, personi atëherë u kthye me qëllim krejtësisht të singertë, ishte i sjellshëm me ta dhe i pajtoi. Nëse mosmarrëveshja dhe marrëdhënia jo e mirë është e shprehur vetëm te gruaja, me qenë se burrat kujdesen për gratë, ai duhet ta edukojë dhe të mundohet ta përfitojë besimin e saj/tyre. Nëse ajo lë anash namazin, ai duhet në një mënyrë ta detyrojë të falet. Megjithatë, do të duhej ta edukojë gradualisht, e kjo është që fillimisht ta këshillojë, t’ia tërheq vërejtjen dhe ta frikësojë, e nëse nuk ka sukses, do t’ia kthejë shpinën në shtrat ose do të flejë në shtrojë të veçantë deri në tri net dhe do ta injorojë, duke qëndruar në shtëpinë e njëjtë. Nëse edhe kjo nuk ka sukses, do ta dënojë fizikisht, por jo ashpër që t’i dhemb, t’ia thyej

eshtrat ose që trupi t'i gjakoset. Nuk do ta godas në fytyrë, sepse këtë e ka të ndaluar. Kjo është një zgjedhje që të mos priset martesë dhe të përmirësohen gabimet. Dikush e pyeti Resulallahun s.a.v.s.:

“Cilat janë obligimet e burrit ndaj gruas?” Ai tha:

“Ta ushqejë kur ha edhe vetë, ta veshë kur vishet edhe vet, të mos e godasë në fytyrë, të mos e dënojë ashpër fizikisht, dhe kur hidhërohet vetëm shtratin e ndanë në shtëpi.”¹²²

Ai ka të drejtë që të hidhërohet dhe ta injorojë për shkak të gjërave fetare deri në dhjetë ditë, dymbëdhjetë ditë, e bile edhe një muaj. Ashtu bënte Resulallahu s.a.v.s., kur me një rast i dërgoi dhuratë Zejnebes, e ajo ia ktheu, kurse ajo (bashkëshortja) në dhomën e së cilës gjendej në atë moment, i tha:

“Të ka ofenduar dhe të ka nënçmuar kur ta ka thyer dhuratën.”

Resulallahu s.a.v.s., atëherë tha:

“Nënçmimi i juaj është më i padëmshëm se sa nënçmimi i Allahut.”

Pastaj, duke u hidhëruar në të gjitha gratë, për një muaj nuk iu afrua atyre, e në fund përsëri u kthye te to.¹²³

¹²² Ebu Davud, dhe Nesai në veprën **Kubra'** dhe Ibn Maxhe në transmetim të Muavija ibn Hajde r.a. me zinxhir të mirë të transmetuesve.

¹²³ Ibn Xhevzi në “Vefa”. Edhe Buhariu dhe Muslimi kanë transmetuar nga Omeri r.a.

10. **Vika:** (një send që fshihet në vete -ruajtje) rregulli i dhjetë i sjelljes ka të bëjë me marrëdhëniet seksuale. Është e lavdërueshme që të fillojë me *bismilah* dhe që një herë të recitojë suren *Ihlas*, pastaj *tekbirin* dhe *la ilahe ilallah*, e më pas të thotë:

“Bismilahil-alijil-adhim. Allahummexh’alha dhurrijeten tajjibeten in kunte kadderte en tuhrixhe dhalike min sulbi.”(*Në emër të Allahut, të Lartësuarit, Madhështorit. Allahu im, bëje pasardhës të mirë, nëse ke caktuar ta nxjerrësh nga kurrizi im.*)

Resulallahu s.a.v.s. thotë:

“Nëse dikush nga ju, kur t’i afrohet gruas së vet duke u lutur thotë: “Allahu im, më largo nga shejtani dhe largo këtë fëmijë nga dëshirat e shejtanit.”, dhe nëse nga kjo marrëdhënie lind fëmijë, ai fëmijë sigurohet nga sherri i shejtanit.”¹²⁴

Kur t’i afrohesh ejakulimit, duhet që (të përkujtosh), në vete, pa i lëvizur buzët, të thuash:

El-Hamdu lilahiledhi haleka minel-mai besheren (*Falënderoj vetëm Allahun, i Cili nga uji krijon njerëzit.*)

Disa dijetarë të haditheve kanë bërë tekbirot në atë mënyrë që familjarët u kanë dëgjuar zërin.

Gjatë marrëdhënies seksuale, nuk duhet kthyer kah kibla nga nderi për të, dhe veten e gruan e tij le ta

¹²⁴ Buhariu dhe Muslimi nga Ibn Abbasit r.a.

mbulojë. Resulallahu s.a.v.s., do të mbulohej, do të ulte zërin dhe gruas do t'i thoshte: *“Qetësohu.”*

Në transmetim thuhet:

“Kur dikush nga ju të ketë marrëdhënie me gruan e tij, mos u lakuriqni si shtazë.”¹²⁵

Para kësaj le të jetë i këndshëm përmes bisedës dhe të puthurave. Resulallahu s.a.v.s., thotë:

- Asnjëri nga ju mos të hidhet si kafshë mbi gruan e tij, por mes tyre le të ketë ndërmjetësues.

- Çfarë ndërmjetësuesi, o Resulallah? e pyetën.

- Bisedat dhe puthjet.¹²⁶ u përgjigj Resulallahu s.a.v.s..

Resulallahu s.a.v.s. gjithashtu thotë:

“Tri gjëra konsiderohen paaftësi te mashkulli: të takojë atë që dëshiron ta njoftojë e të ndahet prej tij pa ia kuptuar emrin as prejardhjen, t'i tregoj dikush nder e ai ta refuzojë dhe të tërheq afër vetes gruan e vet dhe të ketë marrëdhënie me të pa biseduar më parë, pa u argëtuar ose pa u shtrirë me të, kështu që ai e kryen nevojën e vet para se ajo ta kryej të sajën.”¹²⁷

Është e papëlqyeshme të ketë marrëdhënie martesore tri net gjatë muajit: natën e parë, natën e mesme dhe natën e fundit të muajit (muaj hënor). Thuhet se shejtani merr pjesë në marrëdhënie seksuale në këto net. Qëndrimi për mospëlqimin e

¹²⁵ Ibn Maxhe në transmetim të Utba ibn Abd r.a..

¹²⁶ Ebu Mensur ed-Dejlemi në *“El-Musnedul-Firdevs”* në transmetim të Enesit r.a..

¹²⁷ Ebu Mensur ed-Dejlemi në version më të shkurtë, që në fakt është hadithi i mëparshëm.

marrëdhënieve në këto net transmetohet nga Alia, Muavija dhe Ebu Hurejre r.a..

Ka dijetarë të cilët e konsiderojnë të pëlqyeshme marrëdhënien seksuale të premtëve dhe para të premtës duke u bazuar në këtë hadith të Resulallahut s.a.v.s.:

“Allahu ka mëshiruar atë i cili për xhuma lahet vet dhe të tjerët i bën të lahen.”¹²⁸

Kur të plotësojë dëshirën e vet, le të rrijë te gruaja, ashtu që edhe ajo të përmbush epshin e vet, sepse orgazma e saj ndoshta vonon, prandaj le t’ia ngacmojë epshin duke qenë që tërheqja do ta lëndonte. Përjetimi i orgazmës në kohëra të ndryshme, respektivisht kurdo që burri të përjetojë orgazëm më herët, çon deri te ftohja. Ajo e ka më së shumti në qejf kur orgazmat përputhen, prandaj mashkulli le të përpiqet rreth orgazmës së saj, sepse ajo, ndoshta, heziton.

Më e përshtatshme është të ketë marrëdhënie me gruan çdo të katërtën natë. Kjo është më e drejtë edhe nëse ka katër gra. Megjithatë, varësisht nevojës (të dy palëve) mund të bashkohen më rrallë ose më shpesh.

Nuk do të ketë marrëdhënie seksuale me të deri sa ajo ka menstruacionet, e as pas përfundimit të tyre para se ajo të lahet. Kjo është e ndaluar në bazë të ajetit të Kur’anit. Disa thonë se kjo shkakton lebroshën te fëmija. Ka të drejtë të kënaqet nga pjesët e trupit të femrës prej kërthizës e sipër deri sa ajo ka menstruacione, përpos që nuk mund të ketë marrëdhënie seksuale me të. Marrëdhënia seksuale me gruan në ciklin menstrual

¹²⁸ Hadith i shënuar në kapitullin e pestë të Librit për Namazin.

është e ndaluar sepse është pisllek dhe mundim, dhe sepse kjo shqetëson. Por marrëdhënia seksuale në hapjen anale është pisllek i vazhdueshëm dhe është haram më i furishëm se sa harami i marrëdhënies seksuale në ciklin menstrual.

Ndërsa Allah Teala thotë:

“Gratë tua janë vend-mbjellja e juaj, afrohuni vend-mbjelljes tuaj si të dëshironi.”2-Bekare: 223

Në ajet, ‘si të dëshironi’ nënkupton në cilën kohë të doni dhe që mundeni të keni marrëdhënie (edhe fara mbillet aty ku jep fryt).

Gjatë kohës së menstruacioneve, ai mund të kënaqet nën pelerinën e saj, por jo edhe të ketë marrëdhënie seksuale me të. Në atë kohë, gruaja duhet të mbështillet me pelerinë nga ijët deri në gjunjë. Kjo është domosdoshmëri e edukimit. Nuk ka kurrfarë pengese që me gruan që ka menstruacione burri bashkë të hajë, të rri, të shtrihet dhe ta puthë. Por e ndaluar është marrëdhënia seksuale, kjo është haram.

Nëse dëshiron që të ketë marrëdhënie për herë të dytë, ose pas ejakulimit në ëndërr, ai duhet ta lajë organin seksual.

Është e papëlqyeshme të ketë marrëdhënie seksuale në fillim të natës (d.m.th. pas jacisë), që të mos flejë i pa-abdes. Nëse do të donte të flinte ose të hajë, një herë le të merr abdes sikur për namaz, sepse ky është sunnet. Abdullah Ibn Omeri tregon që është pyetur Resulallahun s.a.v.s.: *“A mundet dikush nga ne të fle si xhunub?!”*

“Po, nëse fle pasi që të merr abdes.”¹²⁹

Megjithëkëtë, në këtë çështje përmendet edhe lehtësimi. Aisha r.a., tregon se Resulallahu s.a.v.s., do të flinte xhunub, pa e prekur ujin.¹³⁰ Ai që dëshiron të fle xhunub, duhet ta fshijë shtratin me duar, ose ta shkund atë, sepse nuk dihet se çka ndodh pas fjetjes.

Deri sa është xhunub, nuk do të duhej të rruhet, të pres thonjtë, të heq qimet nga vendet e turpshme, të lëshojë gjak, ose të largojë cilën do pjesë të trupit të tij, sepse në Ditën e Gjykimit këto pjesë të trupit do t'i kthehen të papastra (xhunub). Thuhet se këto pjesë ankohen që janë hequr të papastra.

Është mirë që spermën të mos e derdhësh jashtë, por vetëm në vagjinë, sepse kështu thotë Resulallahu s.a.v.s..

“Secili shpirt të cilit Allah Teala i ka caktuar të ekzistojë, patjetër do të ekzistojë!”¹³¹

Për hedhjen e spermës jashtë vagjinës, a është mubah apo kerahet (neveri, e papëlqyer), dijetarët ndahen në katër mendime:

a) Në çfarëdo mënyre të jetë, është mubah¹³².

b) Në çfarëdo mënyre të jetë, është haram (e ndaluar).

¹²⁹ Transmetojnë Buhariu dhe Muslimi.

¹³⁰ Hadithin e përmendin Ebu Davud, Tirmidhiu dhe Ibn Maxhe.

¹³¹ Buhariu dhe Muslimi nga Ebu Said r.a..

¹³² **Mubah:** gjërat që nuk kanë as sevap e as gjynah; bërja e një veprimi që nuk ka as gjynah e as sevap.

c) Ata që mendojnë se është hallall (e lejuar) vetëm me pëlqimin e saj, përndryshe është haram (e ndaluar). Qëllimi i këtij grupi është të mos i shkaktohet mundim gruas.

ç) Me skllaven është mubah, por me gruan jo.

Sipas mendimit tonë, më e drejtë është që kjo të konsiderohet mubah. Siç përdoret shprehja mekruh (e papëlqyer) si tahrimije (afër haramit) dhe tenzihije (afër hallallit), po ashtu përdoret edhe në kuptimin e braktisjes së faziletit (vlerës së lartë). Edhe hedhja e spermës jashtë vaginës është mekruh në kuptimin e braktisjes së faziletit. D.m.th. hedhja jashtë bëhet si ai që ka braktisur atë që është më e vlefshme. Për shembull, siç thuhet i papëlqyeshëm (mekruh) për atë që rri në xhami pa bërë asgjë, të mos bëjë dhikër ose të mos fal namaz, edhe pse qëndrimi kot në xhami nuk është i papëlqyeshëm (mekruh) vetvetiu, por d.m.th. është braktisje e vlerës së lartë (fazilet). Ngjashëm kësaj është kur thuhet mekruh për atë që banon në Mekë e të mos kryej haxhin për çdo vit, d.m.th. ka braktisur të mirën dhe faziletin. Edhe kjo është në lidhje me faziletin e fëmijës, dhe hadithit i cili transmetohet nga Resulallahu s.a.v.s.:

“Ai që gjendet në marrëdhënie martesore me gruan e tij i shkruhet shpërblimi i fëmijës mashkull i cili lufton në rrugën e Allahut dhe vritet (bëhet shehid).”¹³³

¹³³Sipas Zebidit, Ibn Hajjani ka transmetuar një hadith në këtë kuptim në veprën **“Sohbet”**.

Këtë e ka thënë për shkak se, nëse i lind djalë, do të ketë shpërblim sepse ka bërë që djali të rritet dhe të luftojë në rrugën e Allahut Teala, ani pse Allah Teala vet e ka krijuar atë fëmijë, i ka dhënë jetë dhe e ka aftësuar për luftë. Ai ka bërë aq sa ka mundur që të vije deri te kjo. Ai është bërë shkak që të lind fëmija. Por, kjo bëhet vetëm duke hedhur spermën në vagjinë.

Megjithëkëtë, thamë që me hedhje jashtë nuk ka as përbuzje, e as nuk është afër hallallit apo afër haramit. Sepse, që një gjë të ndalohet, duhet të jetë e qartë në Kur'an dhe hadith, ose të bëhet me analogji. Por në këtë çështje nuk ka qartësi, edhe as një burim të vërtetë që mund të krahasohet. E vërteta e kësaj është sikur mos-martesa, ose shmangia e marrëdhënieve seksuale pas martesës ose përmbajtja nga ejakulimi pas futjes së organit. E asnjëra nga këto nuk është haram ose e ndaluar; ndoshta janë gjëra të kategorisë që braktisin vlerat e larta (fazilet). Edhe këtu nuk ka dallim, sepse fëmija krijohet me arritjen e spermës në vagjinë/vendin e shumimit, e për këtë ekzistojnë katër shkaqe: martesa, marrëdhënia seksuale, derdhja dhe arritja e spermës në vagjinë. Këto janë të afërta me njëra-tjetrën dhe që plotësojnë njëra-tjetrën. Përmbajtja nga shkaktari i katërt është sikur përmbajtja nga i treti. Ashtu edhe i treti është si nga i dyti, e i dyti si nga i pari. Kjo nuk është e ngjashme me abortim dhe me varrosjen e fëmijës për së gjalli. Sepse këto, janë krim karshi një qenie ekzistuese, bile edhe kjo ka gradat e veta. Shkalla e parë është gjendja e arritjes së spermës në vagjinë, kur përzihet me lëngun e femrës dhe përgatitet për pranimin e jetës. Ndërprerja e kësaj

gjendje është krim. Nëse bëhet embrion, atëherë krimi është më i pafytyrë. E kur i jepet shpirti dhe përfundon formësimi, atëherë krimi është shumë më i rëndë, e më i madhi dhe krimi më i rëndë është kur fëmija lind i gjallë dhe pastaj mbytet.

Thamë që shkaktari i parë i ekzistimit është hyrja e spermës në vagjinë, e jo dalja e saj nga gypi i uretrës, sepse fëmija nuk krijohet vetëm me spermën e mashkullit, por nga lëngu i të dy prindërve. Disa njohës të anatomisë konsiderojnë se embrioni krijohet me urdhrin e Allahut nga gjaku menstrual dhe se gjaku për embrionin është sikur qumështi për kosin.

Sperma e mashkullit është kusht për mpiksjen dhe bashkimin e gjakut menstrual, siç është tharmi për qumështin sepse me ndihmën e tij mpikset kosi. Sido që të jetë, lëngu i femrës është element i rëndësishëm i bashkimit. Dy likuidet luajnë rolin e ofertës dhe pranimit të të dyja palëve, si një marrëveshje e ligjshme.

Dikush, pasi që jep fjalën, nëse kthehet nga fjala pa e pranuar pala tjetër, nuk akuzohet fajtor i anulimit të marrëveshjes. Por, nëse kthehet nga fjala pasi që të dy palët arrijnë marrëveshjen e ofertës dhe pranimit, kjo është anulim i marrëveshjes dhe ndërprerje e saj.

Siç nuk bëhet fëmija nga uji që gjendet në kurrizin e mashkullit, ai nuk bëhet as vetëm me daljen e spermës jashtë.

Fëmija bëhet vetëm nëse sperma bashkohet me lëngun e femrës ose gjakun e saj në vendin e shumimit; kësaj i thuhet ‘Kijas-i xhel’ (analogji e qartë).

Nëse thua që derdhja jashtë nuk është mekruh, duke marrë parasysh që ndalon formimin e fëmijës, megjithatë nuk është e tepërt të thuhet se është e përbuzur, për shkak të qëllimit që e motivon këtë akt, sepse në këtë nuk mund ta motivojë vetëm qëllimi i keq në të cilin ka elemente të shirkut të fshehtë. Atëherë theksoj se ekzistojnë pesë lloje të qëllimeve të cilat inkurajojnë derdhjen jashtë.

I - Te skllavet (robëreshat), dëshiron që ta ruajë statusin e saj të skllaves, dhe për këtë shkak derdhet jashtë. Kjo për shkak që, nëse skllavja mbetet shtatzënë dhe lind fëmijë, ajo bëhet ‘Ummu veled’, dhe i jep lirinë edhe skllavit që lind, e kështu del nga prona e personit. Për këtë arsye nuk është e ndaluar derdhja jashtë.

II- Me lindje, gruaja plaket. Për të mbrojtur bukurinë dhe rininë e gruas, derdhet jashtë. Edhe kjo është e pranueshme (xhaiz).

III- Frika nga vështirësitë e tepruara për shkak të numrit të madh të fëmijëve dhe që për këtë arsye të mos lëshohet në punë të këqija. Kjo gjithashtu, nuk është e ndaluar. Natyrisht, përkryerja e vërtetë është në mbështetjen e Allah Teala dhe në besimin në garantimin e Tij. Sepse Allah Teala thotë:

“Nuk ka asnjë gjallesë në tokë që Allahu të mos ia ketë garantuar furnizimin e saj.” 11-Hud: 6

Padyshim, ata që kërkojnë këso masa parandaluese, bien prej gradave të përkryerjes pasi që kanë braktisur atë që është më e vlefshme. Kjo në pamje përbën kundërshtimin e mbështetjes, por për të ruajtur pasurinë dhe për të përgatitur pasuri për të ardhmen, nuk mund ta konsiderojmë të ndaluar.

IV- Frika se mos po lind fëmijë femër, sepse mendojnë se në martesën e vajzës ka një lloj turpi, dhe derdhet jashtë. Ndërsa nën ndikimin e këtij mendimi arabët kanë varrosur për së gjalli fëmijët femra. Ky është mendim i prishur. Nëse për këtë nuk do të martohej, ose nuk do të kishte marrëdhënie seksuale, ose derdhet jashtë, do të ishte gjynahqar. Përndryshe, refuzimi i martesës, ose braktisja e marrëdhënies seksuale ose hedhja jashtë e farës, nuk është kundërshtim. Kundërshtim i vërtetë është të besohet se në sunnetin e Resulallahut s.a.v.s., ka të metë. Kjo është një gjendje e gruas ku ajo identifikohet me meshkujt dhe e cila nuk martohet sepse refuzon mundësinë që mashkulli të jetë më lartë se ajo. Nuk është gjynah që femra të mos martohet, por një mendim i këtillë është gabim.

V- Që femra të përmbahet për shkak të arrogancës së saj dhe teprimit në pastërti dhe duke u ruajtur nga dhimbjet e lindjes, gjakderdhjes pas lindjes dhe gjidhënies. Kjo ka qenë praktikë e disa grave të havarixhinjëve (kryengritësve). Këto i jepnin për së tepërmi rëndësi pastërtisë, agjëronin në ditët e menstruacionit, dhe i falnin namazet e pa-falura pastaj (kadha). Teshat që i kishin në trup gjatë

menstruacioneve nuk i vishnin pa i pastruar për ta falur namazin. Hynin në tualet pa rroba me besim se ashtu përlyhen rrobat. Kjo është risi (bidat) që është kundër sunnetit. Bëhet fjalë për qëllim të prishur. Njëra nga to kërkoi leje nga Aisha r.a., që të hyjë te ajo kur kjo mbërriti në Basra, por kjo nuk e pranoi. Ky qëllim dhe qëndrim i tyre është i keq, por jo edhe vet përmbajtja e tyre nga lindja e fëmijës. Sipas të gjitha këtyre shpjegimeve është kuptuar që derdhja jashtë nuk ka pengesë.

Nëse thua që Resulallahu s.a.v.s., tri herë e ka përsëritur:

“Ai që nuk martohet për shkak se frikësohet që lind fëmija, nuk është nga ne!”¹³⁴

– *prandaj, a nuk kanë përgjegjësi të ngjashmit me këtë*”, unë them:

- Po -derdhja jashtë (azl) është si mos-martesa! Por në hadith thuhet *“nuk është nga ne...”* d.m.th. - nuk po vepron mbi sunnetin tonë. Sunneti i Resulallahut s.a.v.s., është veprimi mbi vlera të larta (mbi fazilet). D.m.th. që të ngjashmit i lënë vlerat e larta.

Nëse pyet se çka thuhet për faktin që Resulallahu s.a.v.s., ka thënë për azl (derdhjen jashtë):

“Ajo është vrasje e fshehtë e një fëmije.”¹³⁵
dhe pastaj ka lexuar ajetin:

¹³⁴ Hadithi është përmendur më herët, në fillim të kapitullit për martesën.

¹³⁵ Muslimi në transmetim të Xhuzame bin Vehb.

“Kur foshnja e varrosur për së gjalli të pyetet për çfarë faji ishte vrarë.” 81-Tekvir:8-9, dhe që kjo ekziston në *Sahih hadithe*.¹³⁶ Do të themi që në Sahih transmetime gjithashtu ekziston se azli është mubah.¹³⁷

Fjalët e Resulallahut s.a.v.s.: *...ai (azl) është një vrasje e fshehtë* janë sikur fjalët e tij për disa gjëra: *...shirk i fshehur*...Ndërsa kjo nuk do të thotë që është haram, por nevojitet të pranohet si mekruh.

Nëse thua që Ibn Abbas r.a., ka thënë: *“Qëllimi i azl’it, është mos-bërje fëmijë, ndërsa kjo është një vrasje e vogël.”*, e për këtë çfarë thua, unë them: Ibn Abbasi r.a., ka bërë krahasim mes ikjes dhe përfundimit. D.m.th. ka krahasuar parandalimin e një gjëje ende pa u bërë me asgjësimin e një gjëje pas bërjes, e ky krahasim është i dobët. Për këtë arsye, kur e dëgjoi këtë fjalë Alia r.a., e refuzoi atë; dhe në përkrahje të argumentimit se për t’u bërë fëmija mev’ude (varrosja e vajzës së vogël sa është gjallë) duhet të kalojë shtatë gjendje, lexoi ajetin:

“Me të vërtetë, Ne e kemi krijuar njeriun prej palcës së baltës, e pastaj e bëmë atë pikë fare dhe e

¹³⁶ Muslimi në transmetim të Xhuzame bin Vehb.

¹³⁷ Hadithet për lejimin e ndërprerjes së marrëdhënies i përmendin Muslimi në transmetim të Ebu Seidit r.a., Nesai në transmetim të Ebu Sirmes, si dhe Buhari në transmetim të Xhabirit. Bejheki thekson se transmetuesit e haditheve për lejimin e ndërprerjes së marrëdhënies janë më të shumtë dhe më autoritar.

vumë në një vend të sigurt (mitër), e mandej pikën e farës e bëmë droçkë gjaku, e pastaj e bëmë copëz mishi pa formë, mandej me atë mish bëmë eshtrat, pastaj i veshëm eshtrat me mish, dhe pastaj e bëmë atë (njeriun) krijesë tjetër (duke i futur shpirtin).”²³-Muminun:12-14,dhe pastaj, duke lexuar ajetin:

“kur foshnja e varrosur për së gjalli të pyetet.”

81-Tekvir:8,

ka qartësuar dallimin mes të dyjave. Kur lexon këto ajete, me lehtësi e kupton ndarjen e mendimeve mes Alisë r.a., dhe Abbasit r.a.

Si mund bëhet haram, kur Buhariu dhe Muslimi kanë transmetuar nga Xhabiri r.a., të ketë thënë: *“Ne në kohën e Resulallahut s.a.v.s., hidhnim farën jashtë. Ndërsa Ajetet e Kur’anit ende ishin duke u shpallur.”* Në transmetim tjetër thuhet: *“Ne hidhnim farën jashtë, dhe për këtë dëgjoi Resulallahu s.a.v.s., por nuk na e ndaloi.”*

Për këtë transmetohet gjithashtu nga Xhabiri r.a., të ketë thënë: *“Një njeri erdhi te Resulallahu s.a.v.s., dhe i tha:*

- Kam një skllave e cila na shërben dhe i ujit palmat. Unë fle me të, por nuk do të më vinte mirë të mbetej me barrë. Atëherë Resulallahu s.a.v.s., i tha:

- Nëse do, bëj azl (derdhje jashtë), por do t’i ndodh ajo që i është caktuar.” Pas një kohe erdhi njeriu dhe tha:

- Shërbëtorja vërtet u mbarësua. Atëherë Resulallahu s.a.v.s., i tha:

*- Të kam thënë që do t’i ndodhë ajo që i është caktuar.*¹³⁸

¹³⁸ Muslimi.

11. Viladet: (Lindje) rregulli i njëmbëdhjetë i sjelljes ka të bëjë me respektimin e edebeve¹³⁹ të lindja e fëmijës, e këto janë pesë:

Edebi i parë: të mos gëzohet së tepërmi për fëmijën mashkull, e as mos të dëshpërohet për fëmijën femër, sepse ai nuk e di nga cili ka më shumë hair. Sa prindër janë që kanë djalë, e do të donin të kishin vajzë. Ato japin më shumë rehati, dhe shpërblimi për to është shumë më i madh.

Resulallahu s.a.v.s., thotë:

“Ai që ka një vajzë dhe e edukon dhe e ushqen mirë dhe e pajis me të mirat të cilat Allahu ia ka dhuruar atij, ajo do t’ia sigurojë dhe lehtësojë rrugën nga xhehenemi në xhennet.”¹⁴⁰

Ibn Abbas r.a., përcjellë që Resulallahu s.a.v.s. ka thënë:

“Secilit që i rritë dy vajza të tij deri në adoleshencë dhe u bënë të mira deri sa janë me të, ato do ta sjellin në xhennet atë person.”¹⁴¹

Enesi r.a., përcjellë që Resulallahu s.a.v.s., ka thënë:

¹³⁹ **Adab [sh. Edeb]:** metodë; rrugë; rregullat e sjelljes; edukim; ahlak i bukur; urtësi.

¹⁴⁰ Taberani në ‘**Kebir**’ dhe Haraiti në ‘**Mekarim-i Ahlak**’, transmetuar nga Ibn Mesudi r.a.

¹⁴¹ Transmetimin e Ibn Abbasit e shënojnë Ibn Maxhe dhe Hakimi, i cili thotë se është me zinxhir të besueshëm të transmetuesve.

“Kush i ka dy vajza ose motra dhe iu bën të mira deri sa të jenë me të, unë dhe ai do të jemi në xhennet si këta dy (gishta).”¹⁴²

Enesi r.a., gjithashtu transmeton që Resulallahu s.a.v.s., ka thënë:

“Kush del në njërin nga tregjet myslimane, blen diçka, e dërgon në shtëpi dhe preferon të jep fëmijëve femra, para meshkujve, Allahu e shikon atë me rahmet, e kur Allahu e shikon me rahmet, atë nuk e dënon.”¹⁴³

Përsëri nga Enesi r.a., transmetohet se Resulallahu s.a.v.s., ka thënë:

“Kush i sjell nga çarshia fruta (ndonjë prodhim të parë stinor) familjes së vet, është sikur t’u ketë sjellë sadaka atyre dhe nëse fillon me fëmijët femra para atyre meshkuj, sepse ai që gëzon fëmijën femër është sikur të ketë qarë nga frikë-respekti ndaj Allahut, e atij që qan nga frikë-respekti, Allahu trupin e tij ia ndalon zjarrit.”¹⁴⁴

Ebu Hurejre r.a., transmeton që Resulallahu s.a.v.s., ka thënë:

“Kush t’i ketë tri vajza ose motra dhe me durim i bartë bezditë dhe telashet e tyre, Allahu do ta dërgojë në xhennet për shkak të dhembshurisë së tij ndaj tyre. Dikush pyeti: “E dy?” Resulallah s.a.v.s., u përgjigj: Edhe

¹⁴² Transmetimin e Enesit e citon Haraiti në **‘Mekarimu-i-Ahlak’** Tirmidhiu e transmeton me një tjetër formë.

¹⁴³ Transmeton Harati.

¹⁴⁴ Këtë transmetim të Enesit e përmendin Haraiti, dhe Ibn Adijj në **‘El-Kamil’**.

dy, njëjtë është. Dikush prapë shtoi: *“E një?” Edhe një, përsëri njëjtë është”, u përgjigj Resulallahu, s.a.v.s.”*¹⁴⁵

Edebi i dytë: t’ia këndojë ezanin fëmijës në vesh. Rafi transmeton nga babai i vet të ketë thënë: *“E kam parë Resulallahun s.a.v.s. si ia këndon ezanin në vesh Hasanit r.a., kur e lindi Fatimja r.a.”*¹⁴⁶

Transmetohet se Resulallahu s.a.v.s. ka thënë:

“Kujt i lind fëmijë dhe ky ia këndon në veshin e djathtë ezanin, kurse ikametin në të majtin, e ka ruajtur prej sëmundjes ummu sibjan. (lloj sëmundje tek fëmijët e vegjël).”¹⁴⁷

Është e lavdërueshme që, kur të fillojë të flasë, të mësojë fjalët e tehvidit *“La ilahe ilallah”* bile, këto t’i jenë fjalët e para. Është mustehab që të bëhet sunnet në ditën e shtatë pas lindjes. Edhe për këtë çështje ka transmetime.

Edebi i tretë: ta ketë emrin e bukur, sepse kjo është e drejtë e fëmijës nga babai. Resulallahu s.a.v.s., thotë:

¹⁴⁵ Transmetimin e Ebu Hurejres e citojnë Haraiti dhe Hakimi, i cili thotë se është me zinxhir të besueshëm të transmetuesve. Por, në transmetimin e Hakimit nuk është pjesa *‘ose motra’*.

¹⁴⁶ Ahmedi, Ebu Davud dhe Tirmidhiu, i cili e konsideron të besueshëm. Vetëm se, në transmetimet e Davudit dhe Tirmidhiut në vend të Husejnit është Hasani.

¹⁴⁷ Ebu Ja’la el-Mevsili, Ibnus-Sunni në **‘El-Jevmu Vel-Lejet’** dhe Behejki në **‘Shu’abul-Iman’** në transmetim nga Husejn ibn Ali r.a.

“Kur jepni emra, le të fillojnë me fjalën *abd*.”¹⁴⁸

Resulallahu s.a.v.s., gjithashtu thotë:

“Emrat më të dashur për Allahun janë emrat si *Abdullah* dhe *Abdurrahman*.”¹⁴⁹

Gjithashtu thotë:

“Jepni emrin tim, por jo edhe mbiemrin”¹⁵⁰

Dijetarët thonë se kjo ka qenë e lidhur me kohën e tij, por tani t’i thuhet ndokujt ‘O Ebu Kasim’ nuk ka pengesë. Vetëm se nuk duhet të bashkohet emri dhe mbiemri i tij, sepse Resulallahu s.a.v.s., ka thënë:

“Mos bashkoni emrin tim me mbiemrin tim.”¹⁵¹

Disa thonë se edhe kjo ka qenë e vlefshme vetëm për kohën e tij.

Një njeri kishte emrin Ebu Isa (babai i Isës), e Resulallahu s.a.v.s., tha:

“Isa nuk ka baba!”¹⁵², duke e konsideruar këtë të papëlqyer.

Edhe fëmijës që vdes para lindjes (i parakohshëm) duhet dhënë emër. Abdurrahman ibn Jezid ibn Muavija

¹⁴⁸ Taberani në transmetim nga Abdulmelik ibn Ebu Zuhejr i cili e transmeton nga i ati Muadhi dhe konsideron se zinxhiri i transmetuesve i është i besueshëm, kurse Bejheki e shënon në transmetim të Aishes r.a.

¹⁴⁹ Muslimi në transmetim të Ibn Omerit r.a..

¹⁵⁰ Buhariu dhe Muslimi nga Xhabiri.

¹⁵¹ Ahmedi dhe Ibn Hibban nga Ebu Hurejre r.a. Edhe Ebu Davud dhe Tirmidhiu kanë transmetime me këtë çështje.

¹⁵² Ebu Omer Tevkani në veprën ‘**Muasheretul-Ehliejn**’ nga Ibn Omeri r.a.

ka thënë: *“Kam dëgjuar që fëmija i parakohshëm do të bërtasë në Ditën e Gjykimit pas babait të tij dhe do t’i thotë: ‘Më ke shkatërruar dhe më ke lënë pa emër.’”* Atëherë Omer ibn Abdulaziz tha: *“E si ti jap emër kur nuk e di a është djalë apo vajzë?”* Abdurrahmani iu përgjigj: *“(Le t’i japë) nga emrat që janë të përbashkët (për të dy gjinitë), siç janë: Hamza, Ammara, Talha dhe Utbe.”*

Resulallahu s.a.v.s. në një hadith thotë:

“Në Ditën e Gjykimit ju do të thirreni me emrat e juaj dhe të baballarëve tuaj, prandaj jepni emra të bukur.”¹⁵³

Kush mban emër i cili nuk i pëlqen, do të ishte e lavdërueshme që ta ndërrojë. Resulallahu s.a.v.s., ia ndërroi emrin As’it në Abdullah¹⁵⁴, kurse Zejnebi më parë e kishte emrin ‘Berre’ e Resulallahu s.a.v.s., tha: **“(Ky emër) po e lëvdon vetveten.”** Sepse ‘Berre’ ka kuptimin ‘i mirë’”, pas së cilës ia dha emrin Zejneb.¹⁵⁵ Gjithashtu përmendet ndalimi i emrave: Efleh (I Suksesshmi), Jesar (Mirëqenie), Nafi (I Dobishmi), Bereqet (Bekim), sepse do të thuhet: *“A është aty Bereqeti (Bekimi)?”*, e do të përgjigjen: *“Jo.”*¹⁵⁶

¹⁵³ Ebu Davud në transmetim të Ebu Derda r.a., Nevevi konsideron se zinxhiri i transmetuesve i është i mirë, deri sa Bejheki thotë që ky është transmetim mursal.

¹⁵⁴ Bejheki në transmetim të Abdullah ibn Haris ibn Xhez’ Zubejd, me zinxhir të besueshëm të transmetuesve.

¹⁵⁵ Buhari dhe Muslimi nga Ebu Hurejre r.a..

¹⁵⁶ Muslimi në transmetim të Semure ibn Xhundub r.a., vetëm se në transmetimin e Muslimit në vend të ‘Bereke’ është ‘Ribah’.

Edebi i katërt: akika, kurban i lindjes: për djalë dy kurbane, e për vajzë një, e nuk ka pengesë të jetë kurban dash apo dele. Aisha r.a., transmeton se Resulallahu s.a.v.s., ka urdhëruar që për fëmijën djalë të theren dy dele kurban të moshës së njëjtë, e për vajzë, një.¹⁵⁷ Transmetohet se Resulallahu s.a.v.s., për Hasanin r.a., ka prerë një kurban. Ky është lehtësim, që mund të kufizohet vetëm në një.¹⁵⁸

Resulallahu s.a.v.s., thotë:

“Me çdo lindje të fëmijës, akika (shqetësim që jep) e tij është me të. (Në ditën e shtatë) lëshoni gjakun (thorni kurban) për të dhe largoni nga ai atë që e shqetëson.”¹⁵⁹

Gjithashtu është sunnet që flokët të prehen në ditën e shtatë, dhe të shpërndahet sadaka në ar ose argjend aq sa kanë peshë flokët e prera. Për këtë flet transmetimi ku thuhet që Resulallahu s.a.v.s., urdhëroi Fatimen r.a., kur Husejni i kishte shtatë ditë, që t’ia rruaj kokën dhe të ndajë sadaka në argjend aq sa i ka të rënda flokët e prera.¹⁶⁰ Aisha r.a., thotë: *“Kurbanit akika nuk i thyhen eshtrat”*, e kështu trajtohet edhe sot.

¹⁵⁷ Tirmidhiu nga Aisha r.a. dhe thotë se është Sahih.

¹⁵⁸ Tirmidhiu nga Aliu r.a., Hakimi nga Husejni r.a. dhe Ebu Davudi nga Ibn Abbasi r.a.

¹⁵⁹ Buhari në transmetim të Selman ibn Amir Dabijut.

¹⁶⁰ Hakimi nga Aliu r.a.. dhe thotë që është Sahih. Ekzistojnë edhe transmetime tjera.

Edepi i pestë: ta ushqejë me hurmë ose reçel. Transmetohet se Esmâ, vajza e Ebu Bekrit r.a., ka thënë: *“E linda Abdullah ibn Zubejrin në Kuba. Erdha në Medinë dhe e dërgova te Resulallahu s.a.v.s., e vendosa në krahët e tij, e atëherë ai kërkoi një hurmë, e përtypi dhe pastaj e vuri në gojën e tij. Kështu në barkun e tij së pari ka hyrë pështyma e Resulallahut s.a.v.s., e përzier me hurme. Pastaj bëri dua për këtë fëmijë. Ishte fëmija i parë që lindi në Medinë, prandaj u gëzuan pa masë myslimanët, sepse ishte përhapur se u kishin thënë hebrenjtë: “U kemi bërë magji dhe për këtë nuk do të keni fëmijë.”*

12.Talak (Shkurorëzimi) duhet të dihet që shkurorëzimi është mubah, por tek Allah Teala është vepra më e urryer ndër të lejuarat. Shkurorëzimi është mubah kur me këtë tjetrit nuk i shkaktohet vuajtje dhe mundim. Por, është ashiqare që gruaja vuan me shkurorëzim. Mundimi i bashkëshortes është i lejuar vetëm kur ajo bën ndonjë të keqe të madhe. Kështu që Allah Teala thotë:

“...e nëse ju respektojnë, atëherë mos u sillni keq ndaj tyre.”4-Nisa: 34

Nëse nuk i pëlqen nusja babait, atëherë duhet ta lëshojë. Sepse pëlqimi (rizaja) i babait ka më shumë përparësi se sa marrëdhënia martesore. Abdullah b. Omeri r.a., ka thënë: *“Me mua ishte një grua të cilën e kam dashur, por babai im nuk e pëlqente dhe më urdhëroi ta lëshojë. Iu drejtova Resulallahut s.a.v.s., dhe ai më tha:*

“O i biri i Omerit, lëshoje gruan tënde!”¹⁶¹

Kjo ndodhi tregon se e drejta e prindit është më e rëndësishme. Por edhe prindi, duhet të jetë njëjtë si Omeri r.a., nuk duhet të mos-pëlqejë nusen pa arsye dhe pa bazë. Gruaja që e mundon burrin dhe provokon të afërmit e burrit, konsiderohet si të ketë bërë krim. Njëjtë është rasti nëse është me ahlak (moral) të keq ose me besim të dobët.

Ibn Mesudi r.a., ka thënë për fjalët e Allahut Teala:

“... por edhe ato të mos dalin, me përjashtim të rastit kur shkelin martesën haptazi...”⁶⁵-Talak:1

Se në ajet, me “shkelin martesën” llogaritet mundimi i burrit dhe ofendimi i të afërmeve të burrit. Sado që ky ajet është në lidhje me pritjen iddet është edhe paralajmërim për atë që flasim këtu.

Nëse mundimi vjen nga burri, ajo ka të drejtë të ndahet me të, duke ia paguar atij dëmshpërblimin. Është e papëlqyer që burri të merr nga ajo më shumë se sa që i ka dhënë, sepse kjo do të ishte padrejtësi, rëndim për të dhe tregti me martesë.

Allah Teala thotë:

“...atëherë nuk është gjynah për asnjërin, nëse gruaja paguan.”(për t’u ndarë nga ai) 2-Bekare:229

Kur gruaja në shkurorëzim kthen atë çfarë ka marrë me martesë, kjo quhet ‘hul’ dhe kjo është ndarja

¹⁶¹ Transmetimin e Ibn Omerit e shënojnë përpiluesit e Asabi *Sunen*, kurse Tirmidhiu thotë që është transmetim i besueshëm (hasen-sahih).

reciproke e pasurisë. Nëse gruaja kërkon shkurorëzim pa kurrfarë nevojë, është gjynahqare.

Resulallahu s.a.v.s. thotë:

“Cilado grua që pa kurrfarë nevojë kërkon nga bashkëshorti shkurorëzim, ajo nuk do të ndjejë aromën e xhennetit.”¹⁶²

Në versionin tjetër thuhet:

“...xhennetin e ka të ndaluar.”

Në një transmetim thuhet:

“Ato që vazhdimisht kërkojnë shkurorëzim, ato janë dyfytërësh!”¹⁶³

Te shkurorëzimi, burri duhet të ketë vëmendjen në katër gjëra:

I. Ta shkurorëzojë gruan në ditët e pastra dhe që në atë periudhë të mos ketë marrëdhënie seksuale me të. Nuk duhet ta shkurorëzojë derisa ajo ka menstruacione ose në periudhën e pastër në të cilin ai ka pasur marrëdhënie seksuale me të. Shkurorëzimi derisa ajo ka menstruacione ose në periudhën e pastër në të cilin ai ka pasur marrëdhënie, sado që është i vlefshëm, është bidat dhe haram sepse detyron zgjatjen e iddetit. Bile, nëse ndahet me një talak në këtë gjendje

¹⁶² Ebu Davud dhe Timidhiu, që e konsideron të mirë, si dhe Ibn Maxhe dhe Ibn Hibban në transmetim të Sevbanit r.a..

¹⁶³ Nisai në transmetim të Ebu Hurejres r.a., si dhe Taberani nga Ukba ibn Amir.

me gruan, duhet menjëherë ta kthejë. Kështu, Ibn Omeri r.a., e lëshoi gruan e tij deri sa kishte menstruacione, e Resulallahu s.a.v.s., i tha Omerit r.a.:

“Urdhëroje të birin që ta kthejë deri sa të pastrohet dhe përsëri ta ketë menstruacionin, dhe prapë deri sa të pastrohet, e atëherë nëse do, le ta lëshojë ose le ta mbajë.”¹⁶⁴

Ky urdhër i Resulallahut s.a.v.s., Ibn Omerit r.a., që të durojë për dy pastrime, ishte që të sigurohet që qëllimi i kërkesës së tij të mos jetë talak.

II. Në pastrimin e parë me një talak të ndahet, nuk duhet përnjëherë të përdor tri talakë. Në fakt, pas kryerjes së idetit, edhe një talak e bën punën e tri talakëve. Për më tepër, nëse pendohet gjatë idetit, ka të drejtë ta kthejë gruan. Edhe pas kryerjes së idetit (pas pritjes), nëse dëshiron ta kthejë, mundet ta bëjë këtë, duke ripërtëri kurorën. Por, nëse ndahet me tri talakë, atëherë pendimi nuk jep kurrfarë dobie. Atëherë mundet ta marrë vetëm kur ajo shkurorëzohet dhe pret kryerjen e idetit nga burri tjetër. Ndërkaq, Resulallahu s.a.v.s., e ka bërë të qartë që është e ndaluar të martohet me tjetrin për të mundësuar kthimin te burri i parë. Shkak është lëshimi i gruas me tri talakë. Po të ishte ndarja me një talak, kjo pengesë nuk do të lindte. Nëse nuk do ta marrë gruan, në fakt pasi që ndahet me një talak, gjatë idetit nuk e kthen dhe nëse nuk kthehet nga talaku i shqiptuar, pas kryerjes së idetit gruaja mund të martohet me kë të dëshirojë. Nëse bëhet

¹⁶⁴ Buhariu dhe Muslimi nga Ibn Omerit.

pishman, mund të bashkohet përsëri me gruan. Ne nuk po themi që ndarja me tri talak është haram. Por, karshi të gjitha këtyre rrethanave –është mekruh.

III. Gjatë shkurorëzimit nuk duhet ofenduar. Duhet të sillet mirë dhe të flasë gjëra të mira, të paraqes disa shkaqe të llojit: *“çfarë të bëjmë, kështu qenka përcaktimi ynë”*. Bile, sa ka mundësi ta disponojë me ndonjë dhuratë për dhimbjen që ka pasur gruaja për shkak të ndarjes. Allah Teala thotë:

“..u jepni dhuratë të pëlqyeshme..”2-Bekare: 236

Kjo është obligim nëse nuk i është caktuar dhuratë për martesë (mehri). Hasani r.a., i biri i Alisë r.a., shumë herë është martuar dhe shkurorëzuar. Një ditë e dërgoi një mik të tij që t’iu japë nga 10.000 dërhëmë dy grave të tij dhe t’iu thotë të presin idetin. Miku i tij ashtu edhe veproi. Kur u kthye, Hasani r.a., e pyeti: *“Çfarë bënë?”*. *“Njëra nga to uli kokën dhe mbeti ashtu, e tjetra qau me lot, dhe e dëgjova duke thënë: ‘Kjo dhuratë është shumë pak për ndarjen nga i dashuri’* Hasani uli kokën dhe me keqardhje ndaj saj tha: *“Po të kisha kthyer ndonjërin pasi që e kam lëshuar, do ta ktheja atë!”*

Një ditë Hasani r.a., shkoi te Abdurrahman ibn Haris ibn Hisham r.a., Abdurrahmani r.a., ishte kreu i fakihëve (juristëve të sheriatit) të Medinës, që nuk kishte si ai në Medinë dhe të cilin Aisha r.a., e kishte lavdëruar shumë. Abdurrahmani r.a., i tregoi nder dhe e uli në vendin e vet, duke e pyetur:

-Pse nuk dërgove të më thërrasin, unë do të vija tek ti? Hasani u përgjigj:

-Erdha për një punë personale. Abdurrahmani r.a., tha:

- Trego për çka ke nevojë, e Hasani r.a., tha:

- Kam ardhur të fejojë vajzën tënde. Abdurrahmani r.a., uli kokën, më pas e ngriti dhe tha:

-Pasha Allahun, nuk ka në rruzullin tokësor burrë më të mirë se ti për vajzën time. Por, ti e di që vajza ime është pjesë e imja, më pikëllon ajo që e pikëllon atë dhe më gëzon ajo që e gëzon atë, e ti shumë martohesh dhe shkurorëzohesh. E nëse edhe vajzën time e lëshon, kam frikë që mos ta humb dashurinë ndaj teje. Sepse edhe ti je një pjesë e Resulallahut s.a.v.s. Nëse ma jep fjalën se nuk do ta lëshosh, do të të martoj me të.” Hasani r.a., heshti, u ngrit dhe doli nga shtëpia. Njëri nga të shtëpisë tha: *“E dëgjova se Hasani duke ecur tha:*

-Kërkoj vajzën e tij ta bëj litar në fytin tim.’

Alia r.a., ishte lodhur nga shkurorëzimet e tij të shpeshta, për çka kërkoi falje në minber duke folur në hutbe:

-Biri im Hasani shkurorëzohet shpesh, prandaj mos i jepni çikë! atëherë u ngrit një njeri nga fisi Hemdani dhe tha:

-Pasha Allahun, o Emiri i mu’minëve ne do t’i japim sa të dojë, e cilën e do - do ta mbajë, dhe cilën dëshiron do ta lëshojë. Kjo e gëzoi Alinë r.a., dhe tha:

-Sikur të isha portier në dyert e xhennetit do t’i thosha fisit të Hemdanit: ‘Hyni me selam’.

Nga kjo mësojmë këtë: ndokush që nga mërzia kritikon fëmijën e vet, nuk duhet ta ndajmë të njëjtin mendim me të, por duhet aq sa është e mundur ta kundërshtojmë, duke thënë fjalë si: *‘Jo, nuk është aq i keq, është i mirë’*, sepse kjo do ta gëzojë zemrën e tij dhe do të jetë i kënaqur.

Qëllimi nga këto shpjegimet tona është të tregohet se shkurorëzimi (talak) është mubah.

Allah Teala ka premtuar begati edhe në martesë edhe në shkurorëzim.

“I martoni të pamartuarit dhe të pamartuarat ndër ju, si dhe skllavërit dhe skllavet tuaja që janë besimtarë të ndershëm! Nëse janë të varfër, Allahu, do t’i begatojë ata me dhuntinë e Tij.”24-Nur:32

“E nëse ata ndahen, Allahu me begatinë e Tij, çdonjërin prej tyre e bën të pavarur.”4-Nisa:130

IV. të mos zbulojë fshehtësinë e saj as në shkurorëzim, as në martesë. Kërcënim i rëndë është përmendur në një transmetim të besueshëm për zbulimin e fshehtësive të gruas. Transmetohet nga një njeri i mirë që kishte dashur ta lëshojë gruan e tij, andaj dikush e kishte pyetur:

- *Çfarë të pengon te ajo?*

E ai kishte thënë:

*-Njeriu i kuptueshëm nuk i zbulon të fshehtat e gruas së tij. Kur e kishte lëshuar, e kishin pyetur:
- Pse u ndave nga ajo? Ai kishte thënë:
-Nuk kam të drejtë të flas për gruan e huaj.*

Këto ishin të drejtat e gruas te burri.

SHQYRTIMI I TË DREJTAVE TË BURRIT NDAJ GRUAS

Në këtë çështje para se gjithash dhe për fillim, fjala më e mirë është kjo: martesë është një lloj robërie dhe nënshtrimi. Gruaja është plotësisht nën urdhrin e burrit. Ajo është e obliguar që absolutisht t'i nënshtrohet burrit në gjithçka që ai kërkon nga ajo, e që nuk është gjynah. Nënshtrimi dhe respekti i gruas ndaj burrit janë përmendur në shumë transmetime. Resulallahu s.a.v.s., thotë:

“Gruaja me të cilën burri i saj është i kënaqur, kur të vdes do të hyjë në xhennet.”¹⁶⁵

Një njeri ishte nisur për rrugë dhe kërkoi nga gruaja e tij që të mos zbres nga kati i parë në përdhese.

¹⁶⁵ Tirmidhiu, i cili thotë që është hasen dhe garib edhe Ibn Maxhe në transmetim të Ummu Selemes r.a..

Babai i saj ishte në përdhese dhe u sëmur. Gruaja dërgoi dikë te Resulallahu s.a.v.s., duke kërkuar nga ai leje për të zbritur deri te babai i vet. Resulallahu s.a.v.s., e porositi:

“Nënshtroju burrit tënd.”

Babai i vdiq. Pyeti që të merr pjesë në varrimin e tij. Resulallahu s.a.v.s., përsëri i tha:

“Nënshtroju burrit tënd.”

Babai iu varros. Atëherë Resulallahu s.a.v.s., dërgoi dikë te ajo për ta lajmëruar se Allah Teala e kishte falur babanë e saj për shkak që ajo i ishte nënshtrojuar burrit të vet.¹⁶⁶

Resulallahu s.a.v.s., thotë:

“Kur gruaja falë pesë vakte namaz, agjëron muajin e Ramazanit, kujdeset për dëlirësinë e vet dhe i është nënshtrojuar burrit të saj, do të hyj në xhennetin e Rabbit të vet.”¹⁶⁷

Siç po shihet, Resulallahu s.a.v.s., nënshttrimin e gruas ndaj burrit ka llogaritur në mesin e kushteve të Islamit.

“Ato janë shtatzëna, ato lindin, ushqejnë me gji, janë për së tepërmi të mëshirshme ndaj fëmijëve të tyre dhe në qoftë se i respektojnë burrat, ato prej tyre që falen do të hynin menjëherë në xhennet.”¹⁶⁸

¹⁶⁶ Taberani në ‘Evsat’ në transmetim të Enesit r.a.

¹⁶⁷ Ibn Hibban në transmetim të Ebu Hurejres r.a..

¹⁶⁸ Ibn Maxhe dhe Hakimi, i cili e konsideron të besueshëm, në transmetim të Ebu Umames r.a. Gjendet edhe te Taberani në ‘Evsat’

“Kam parë xhehenemin dhe që shumica e banorëve të tij janë femra.”

Për ata që e pyetën shkakun e kësaj Resulallahu s.a.v.s., dha këtë përgjigje:

“Për shkak se mallkonin shumë dhe nuk respektonin burrat.” ¹⁶⁹

Në një transmetim tjetër thuhet:

“Kam parë xhennetin dhe që gratë ishin më të pakta në numër aty.” Pyeta: *“Ku janë gratë?”*

“Ato janë mashtruar me dy të kuqe: ar dhe shafran, më thanë.” ¹⁷⁰

Aisha r.a., transmeton se një vajzë kishte ardhur te Resulallahu s.a.v.s., dhe i kishte thënë:

-O Resulallah, unë jam vajzë e re dhe po më kërkojnë për martesë, e unë nuk do të doja të martohem, prandaj cilat janë të drejtat e burrit ndaj gruas? Resulallahu s.a.v.s., tha:

-Sikur prej koke e deri te gishti i këmbës të ishte burri në qelb dhe ti ta lëpije me gjuhë, përsëri nuk do të mund t’ia paguaje të drejtën.

-Pra, unë a mos të martohem?, pyeti. Resulallahu s.a.v.s., i tha:

-Gjithsesi, martohu sepse martesa është më mirë! ¹⁷¹

Ibn Abbas r.a., tregon se një grua nga fisi Has’am erdhi te Resulallahu s.a.v.s., dhe i tha: *“Nuk jam e*

¹⁶⁹ Buhariu dhe Muslimi nga Ibn Abbasi r.a.

¹⁷⁰ Ahmedi në transmetim të Ebu Umames r.a.

¹⁷¹ Hakim nga Ebu Hurejre r.a., dhe e konsideron të besueshëm zinxhirin e transmetuesve

martuar, e dua të martohem, prandaj cilat janë të drejtat e burrit ndaj gruas? Resulallahu s.a.v.s., tha:

“Ndër të drejtat e burrit ndaj gruas janë: kur ai e dëshiron marrëdhënie seksuale, qoftë ajo edhe në shpinën e devesë, duhet të pranojë. Ajo të mos jap nga shtëpia e tij pa lejen e tij, e nëse e bën këtë, është gjynah i saj, dhe shpërblim i tij. Ajo të mos agjëroj nafile (vullnetarisht) pa lejen e tij, e nëse e bën këtë, do të ketë uri dhe etje, e kjo nuk do t’i pranohet. Dhe, nëse del nga shtëpia pa lejen e tij, melaiket e mallkojnë deri sa të kthehet në shtëpi ose deri sa nuk pendohet.”¹⁷²

Resulallahu s.a.v.s., thotë:

“Po t’i urdhëroja dikujt t’i bëjë sexhde tjetrit, do t’i urdhëroja gruas t’i bëjë sexhde burrit të vet për shkak të të drejtave të mëdha që ai ka ndaj saj.”¹⁷³

“Gruaja është më së afërti kënaqësisë (rizasë) së Allahut kur është në vend të mbyllur të shtëpisë së saj. Namazi i saj në oborrin e shtëpisë është më i vlefshëm se namazi në xhami, namazi në shtëpi është më i vlefshëm se namazi në oborr, kurse namazi në dhomën e saj më i vlefshëm se namazi në cilën do pjesë tjetër të shtëpisë.”¹⁷⁴

¹⁷² Bejheki, një pjesë nga Ibn Abbasi r.a., kurse të plot e sjell nga Ibn Omeri, r.a.

¹⁷³ Tirmidhiu dhe Ibn Hibbani nga Ebu Hurejre r.a. Gjithashtu e përmendin edhe Ebu Davudin në transmetim të Kajs ibn Sa’d r.a., Ibn Maxhe në transmetim të Aishes r.a. dhe Ibn Hibbanit në transmetim të Ibn Ebi’l Evfa r.a.

¹⁷⁴ Fillimin e hadithit e shënon Ibn Hibban nga Ibn Mesudi r.a. kurse fundin e tij e shënojnë Ebu Davudi në formë të shkurtuar. E përmend edhe Bejhaki në transmetim të Aishes r.a. Zinxhiri i

Për shkak se dhoma e saj është më e mbyllur nga çdo pjesë tjetër e shtëpisë. Për këtë Resulallahu s.a.v.s., ka thënë:

“Gruaja është provokuese, prandaj kur del jashtë, shejtani e përcjell me kujdes.”¹⁷⁵

Gjithashtu ka thënë:

“Gruaja i ka dhjetë provokime, kur të martohet, burri ia mbulon njëren, e kur të vdes, varri i mbulon të dhjetat.”¹⁷⁶

Të drejtat e burrit ndaj gruas janë të shumta, e nga to, më të rëndësishmet janë dy:

a) Mbrojtja dhe strehimi.

b) Mos-kërkimi i asaj që është përtej nevojave, nëse është fitimi i burrit haram, të përdorë vetëm aq sa i duhet.

Kështu ka qenë praktika e grave në gjeneratat e para. Kur burri do të dilte, gruaja dhe vajza e tij do t'i thoshin: *“Ruaju nga fitimi haram, sepse ne mund të durojmë në këtë dynja urinë dhe mjerimin, por nuk mund të durojmë zjarrin e xhehenemit.”* Njëri nga gjeneratat e para vendosi të niset për rrugë, e kjo nuk u pëlqeu fqinjëve të tij, prandaj i thanë gruas së tij: *“Pse pranove që të udhëtojë, e nuk të ka lënë furnizim?”* Në këtë, ajo u përgjigj: *“Unë prej se jam martuar e di që ai*

transmetuesve është i mirë. E përmend edhe Ibn Hibban në transmetim të Ummu Humejdit.

¹⁷⁵ Tirmidhiu, dhe Ibn Hibbani nga Ibn Mesudi r.a.

¹⁷⁶ Hafiz Ebu Bekr Muhammed ibn Omer Xhiabi në **“Tarihu't-Talibin”** nga Alia r.a.

nuk na ka furnizuar, ai di vetëm të ha. Lëreni të shkojë, unë kam Rabbin i Cili jep furnizim."

Në Sham, Rabija vajza e Ismailit e cila ishte një grua që bënte shumë ibadet, i propozoi Ahmed b. Ebu'l-Havariut martesë. Ebu'l-Havariu tha:

-Unë jam zënë me ibadet, nuk kam nevojë për grua, nuk martohem. Rabija i tha:

-Unë më shumë se ti jam e zënë me ibadet, edhe unë nuk kam nevojë për burrë, por unë ty të vlerësova si besimtar i cili i zbaton urdhrat e sheriatit. Kam trashëguar pasuri të madhe nga burri im. Prandaj dua që ti ta harxhosh këtë pasuri me vëllezërit e tu dhe për këtë të propozova martesë.

Ebu'l-Havariu tha:

-Atëherë ta pyes shejhun tim, Ebu Sylejman Daranin! Sepse ai më ndaloi të martohem duke më thënë:

-Gjendja e shokëve tonë u prish me martesë. Shkoi të shejhu Ebu Sylejman Darani dhe i tregoi gjendjen. Ebu Sylejmani i tha:

-Martohu me të, ajo është një nga velitë e Allahut (evlia), dhe Ahmed i u martua me Rabijen.

Tregon tutje Ahmed i, *'Në shtëpinë tonë ishte një sasi e madhe e sapunit dhe u shtjerr nga larja e duarve të atyre që nguteshin për të dalë pas ngrënies te ne. Pas saj, jam martuar edhe me tri gra tjera. Ajo më ushqente me ushqime të shijshme dhe më parfumonte duke më thënë: 'Hajde mirupafshim shko te gratë tua.'* Rabija e Shamit përngjanë në Rabija Adevija nga Basra.

Njëri ndër obligimet e gruas është të mos harxhojë pa nevojë pasurinë e burrit dhe ta ruaj atë. Resulallahu s.a.v.s., thotë:

“Asaj nuk i lejohet që nga shtëpia të ushqejë askënd pa lejen e burrit përpos me ushqimin për të cilin ekziston frika që do të prishet. Nëse e ushqen dikë me lejen e tij, do të ketë shpërblim aq sa edhe ai. E nëse e ushqen dikë pa lejen e tij, ai do të ketë shpërblim, e ajo gjynah.”¹⁷⁷

E drejta e saj te prindërit është që ata ta mësojnë me sjellje të mira dhe rregullat e sjelljes ndaj burrit, siç transmetohet që Esma bint Harixhetu'l-Fezari, i fliste vajzës së vet para martesës:

-O bija ime, po shkon nga një jetë që je mësuar në një jetë që nuk e njeh dhe te dikush që nuk e njeh. Bëhu toka e tij, ai do të jetë qielli yt, ti plotëso dëshirën e tij që edhe ai të të japë atë që kërkon ti, bëhu mbulesa e tij, ai do të jetë mbështetje për ty, bëhu robëresha e tij, e edhe ai do të jetë rob i yt. Mos insisto shumë për ndonjë gjë, e të zemërohet. Mos u largo shumë nga ai, që të të mos harrojë. Nëse të afrohet, edhe ti afrohu, nëse largohet, largohu nga ai. Kur zemërohet, ruaje. Ruaja fytyrën, veshin dhe syrin, nga ti le të merr vetëm erë të këndshme, le të dëgjojë vetëm fjalë të mira dhe le të shikojë vetëm bukurinë tënde.”

¹⁷⁷ Ebu Davud, Tajalisi dhe Behejki nga Ibn Omerit r.a..

Njëri i kishte thënë gruas së vet:

‘Bëhu e mirë ndaj meje, do të të dua edhe më tutje. Mos më fol kur jam i zemëruar që mos ta thyej zemrën me ndonjë fjalë. Nëse fol, mos fol me britmë. Sepse ti nuk e di vazhdimisht në çfarë gjendje jam. Zemrat kthehen, kënaqësitë ndërrojnë. Dashuria dhe vuajtja nuk mbliidhen në një zemër. Nëse këto dyja në një vend bashkohen, dashuria nga zemra largohet.’

Shkurtimisht këto janë sjelljet e mira të cilave gruaja duhet t’u përshtatet. Gruaja duhet t’i përkushtohet shtëpisë. Nuk duhet të shikojë kush hyn e kush del nga fqinjët. Pak të flasë me fqinjët, të shkojë te ata vetëm kur është e nevojshme. Ta ruaj nderin e saj kur ai mungon dhe kur ai është prezent, të kërkojë kënaqësinë e tij në çdo punë, të mos e tradhtojë, mos t’ia harxhojë pa kontroll pasurinë, dhe nga shtëpia të del vetëm me lejen e tij. Nëse del me lejen e tij, atëherë të vesh rroba që të mos theksohet dhe aq as është e mundshme të kërkojë rrugë të zbrazëta, e jo ato të ngarkuara. Duhet të ruhet që i huaji të mos ia dëgjojë zërin dhe të mos e njoftojë. Bile duhet të shmanget nga ata që i njeh dhe të vazhdojë rrugën e vet. Brenga e saj kryesore është që t’i bëjë mirë punët e veta, të udhëheqë shtëpinë, të jetë e dhënë pas namazit dhe agjërimit. Kur ndokush kërkon leje për të hyrë në shtëpi, e burri nuk është aty, duke menduar xhelozinë e burrit, nuk duhet të hap derën. Duhet të jetë e kënaqur me pasurinë e burrit, ti japë përparësi atij ndaj vetes dhe t’i japë përparësi të afërmeve të tij ndaj të afërmeve të vet. Vazhdimisht të jetë e respektueshme ndaj burrit dhe e gatshme për kërkesat e tij. Të mos kundërshtojë burrin.

Duhet të jetë e kujdesshme ndaj fëmijëve, gjithmonë gati që t'i mbrojë dhe të mos flasë fjalë të këqija.

Resulallahu s.a.v.s., thotë:

“Unë dhe gruaja me faqe të kuqe do të jemi si këta dy (gishtërinj) në xhennet. Kjo është gruaja (e re) e cila ka mbetur pa burrin dhe nuk është martuar për të ruajtur vajzat e veta deri sa nuk rriten ose nuk vdesin.”¹⁷⁸

Gjithashtu, Resulallahu s.a.v.s. thotë:

“Allah Teala ua ka ndaluar të gjithë njerëzve të hynë në xhennet para meje. Por do të shikoj nga ana ime e djathtë një grua e cila mundohet mua të më kalojë dhe unë do të pyes: ‘Kush është kjo grua që dëshiron të më kalojë?’ Do të më thonë: ‘O Muhammed, kësaj gruaje i ka vdekur burri në rininë e saj, ka qenë e mirë dhe e bukur, dhe ka pasur jetimë, e ka duruar me ta deri sa nuk kanë arritur atë që kanë arritur. E si shpërblim Allah Teala asaj i dha këtë gradë.”¹⁷⁹

Njëra nga rregullat se si gruaja duhet të sillet është edhe ajo që mos të lavdërohet me bukurinë e saj, e as të mos e nënçmojë burrin për shëmtinë e tij. Transmetohet se Esmat tregon:

¹⁷⁸ E shënon Ebu Davud në transmetim të Ebu Malik el-Eshxhezijj me zinxhir të dobët të transmetuesve.

¹⁷⁹ Haraiti në **“Mekarimul-Ahlak”** nga Ebu Hurejre r.a.

-Hyra në shkretëtirë kur atje ishte një grua shumë e bukur, gruaja e një njeriu tepër të shëmtuar, prandaj e pyeta:

-Vallë, a je e kënaqur të jesh me një të tillë? Ajo atëherë më tha:

-O ti, hesht! Po flet keq. Ndoshta ai është njeriu më i mirë tek Allahu, prandaj Ai më ka dhënë te ai si shpërblim, e ndoshta unë kam një mangësi të madhe, prandaj Ai më ka dhënë këtë burrë ta vuaj si dënim. Vallë, a të mos jem e kënaqur me atë me çka Allahu është i kënaqur!’ Atëherë më mbylli gojën.

Esmail gjithashtu tregon:

-Kam parë në shkretëtirë një grua të mbuluar në të një këmishë e kuqe, duar të ngjyrosura me kanë, dhe në duar tespihet, dhe thashë:

-Sa larg është (këmisha e kuqe, kanë në duar dhe tespihet) njëra prej tjetrës?! Në këtë, ajo tha:

- Unë kam një detyrë ndaj Allahut dhe një ndaj burrit; dhe për këto të dyja jam e kujdesshme. Kuptova se gruaja e mirë është ajo që për burrë vishet mirë dhe zbukurohet me kanë, ndërsa me tespihe është për Allahun.

Një nga rregullat e sjelljes është gjithashtu të jetë e moralshme dhe e ndrojtur kur burri nuk është aty, e t’i kthehet lojës, humorit të mirë dhe gjithë asaj që sjell kënaqësi kur e ka burrin prezent. Assesi nuk duhet ta shqetësojë burrin e vet. Transmetohet nga Muadh b.

Xhebel r.a., që Resulallahu s.a.v.s., ka thënë: **“Kur gruaja në këtë dynja e shqetëson burrin e vet, gruaja e tij nga hyritë e porositë: ‘Mos e shqetëso, Allahu të marrtë shpirtin! Ai te ti është vetëm mysafir dhe shumë shpejtë do të lë që të vijë te ne.’”**¹⁸⁰

Njëra nga obligimet e saj martesore, kur t’i vdes burri, është që të mos mbajë zi për të më shumë se katër muaj e dhjetë ditë, gjatë së cilës kohë do të shmangë parfumet dhe zbukurimet.

Zejneb binti Ebu Selma r.a., tregon:

-Hyra te Ummu Habibe r.a., gruaja e Resulallahut s.a.v.s. kur i vdiq babai – Ebu Sufjan ibn Harb, e ajo kërkoi aromë trëndafili të verdhë, dhe i vendosi atë shërbëtores, e pastaj edhe në faqet e veta, e pastaj tha:

-Pasha Allahun, nuk kam nevojë për aromë, por kam dëgjuar Resulallahun s.a.v.s., të thotë:

“Nuk i është e lejuar gruas që beson në Allahun dhe Ditën e Gjykimit të mbajë zi për të vdekurin më shumë se tri ditë, përpos për burrin, për të cilin mbanë zi katër muaj e dhjetë ditë”¹⁸¹

Duhet të qëndrojnë në shtëpinë ku ka jetuar në martesë deri sa të përfundojë pritja iddeti. Nuk ka të drejtë të kalojë (për të jetuar) te prindërit e saj, e as të dal jashtë pa ndonjë nevojë të madhe.

¹⁸⁰ Tirmidhiu, i cili thotë që është hasen dhe garib, si dhe Ibn Maxhe.

¹⁸¹ Transmetojnë Buhariu dhe Muslimi.

Është rregull që të kryej të gjitha punët e shtëpisë që mundet. Transmetohet nga Esmā bint Ebu Bekr es-Siddik r.a., të ketë thënë:

-U martua Zubejr me mua, e për punë të tokës nuk kishte as mjete materiale, as shërbëtorë, dhe asgjë tjetër përpos një pele dhe deveje në të cilën sillnim ujë. Ia ushqoja pelën, i sillja ushqim dhe kujdesesha për të. I thyeja farat e hurmës dhe ushqoja devenë. Sillja ujin dhe i qepja thesin për nxjerrjen e ujit. Gatujja bukë. Bartja farat në kokë në largësi deri dy të tretat e fersahut,¹⁸² bile babai (Ebu Bekri r.a.) më dërgoi një robëreshë e cila mori përsipër nga unë kujdesin për pelën, dhe si të më kishte liruar nga robëria. Një ditë, deri sa po bartja farat në kokë, takova Resulallahun s.a.v.s., me as'habët e tij, dhe ai tha: 'Ih, ih' që deveja të gjunjëzohej dhe të më ulte pas vetes. Më vinte turp të shkoja me burra, dhe e mendova edhe Zubejrin dhe xhelozinë e tij, e ai ka qenë xheloz. Resulallahu s.a.v.s., kuptoi që isha turpëruar. Erdha te Zubejr dhe i tregova çfarë kishte ndodhur, e ai më tha: 'Pasha Allahun, më rëndë më vije që ti bartë farat në kokë se sa të kishe hipur në deve me të.'¹⁸³

Me falënderim Allahut dhe me ndihmën e Tij përfundoi Libri për rregullat e jetës bashkëshortore. Salavate për secilin rob të zgjedhur të Tij.

¹⁸² Fersah është njësi matëse e gjatësisë, e barabartë me tri milje ose 2250m, e disa thonë që është baras me 7-8 kilometra (shënim i përkthyesit).

¹⁸³ Transmetojnë Buhariu dhe Muslimi.

PËRMBAJTJA

PARATHËNIE.....	3
------------------------	----------

Kapitulli i Parë

MBI INKURAJIMIN NË MARTESE DHE LARGIMINNGA AJO.....	5
INKURAJIMI NË MARTESE.....	5
LARGIMI NGA MARTESA.....	14
DOBITË E MARTESES	16
DËMET E MARTESES.....	47

Kapitulli i Dytë

GJENDJA E GRUAS DHE KUSHTET E LIDHJES MARTESORE - KURORËZIMIT	59
LIDHJA MARTESORE - KURORA.....	59

Kapitulli i Tretë

**SHPJEGIMET PËR MËNYRËN E MIRËSJELLJES MES
BURRIT DHE GRUAS, DETYRAT QË JU TAKOJNË ATYRE
DHE SHKAQET PËR TË SIGURUAR VAZHDIMIN E
MARTESËS.....81**

**DETYRAT DHE RREGULLAT E MIRËSJELLJES QË I TAKOJNË
BURRIT 81**

SHQYRTIMI I TË DREJTAVE TË BURRIT NDAJ GRUAS ... 131